



Performanca Mjedisore dhe Pajtueshmëria Ligjore e Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme



Tirana, Shtator 2010



Projekti PEPSME

Performanca Mjedisore dhe Pajtueshmëria Ligjore e Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme



THIS PROJECT IS FINANCED BY THE EUROPEAN UNION

Përgatitur nga Qemal BALLIU

MA në Menaxhimin e Zhvillimit, Universiteti i Torinos, Itali

Tirana, Shtator 2010

Përmbajtja

- I Përmbledhja ekzekutive**
- II Hyrje**
- III Vështrim mbi zhvillimin e qëndrueshëm në Shqipëri**
- IV Performanca mjedisore e NVM-ve**
- V Kuadri ligjor për NVM-të në lidhje me mjedisin**
- VI Institucionet kombëtare në fushën e mjedisit**
- VII Programet kombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit**
- VIII Programet europiane në fushën e mjedisit për NVM-të**
- IX Rezultatet e anketimit për performancën mjedisore të NVM-ve**
- X Gjetjet kryesore dhe përfundimet**
- XI Rekomandimet kryesore**
- XII Anekset**

Mospretendim: Ky studim u përgatit nga një grup ekspertesh të SBF në kuadër të programit EurpeAid/128265/L/ACT/AL të Bashkimit Europian 2009-2011. Gjetjet, përfundimet dhe interpretimet e shprehura në këtë dokument janë vetëm të stafit të SBF dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin dhe politikën e EU.

I Përmbledhje ekzekutive

Projekti PEPSME bashkëfinancohet nga Programi EU CARDS 2006, i cili synon rritjen e angazhimit të shoqërisë civile në procesin e integritimit evropian dhe në zhvillimin social ekonomik të vendit. Një nga komponentët e këtij programi është mbështetja për organizatat shqiptare të shoqërisë civile për tu angazhuar në mbrojtjen e mjedisit dhe në edukimin mjedisor¹. Vendi ka treguar përmirësime të kufizuara në sektorin e mjedisit dhe kontributi i shoqërisë civile është kritik për të ndihmuar në arritjen e progresit nëpërmjet veprimeve, që synojnë informimin, parandalimin, rritjen e njohurive dhe zbatimin e projekteve të vogla. Nëpërmjet këtij programi synohet që organizatat e shoqërisë civile të familjarizohen me politikat e EU në fushën e mjedisit, të forcohet bashkëpunimi dhe komunikimi midis OSHC dhe autoriteteve mjedisore publike, institucioneve private, bizneseve dhe aktoreve të tjerë mjedisorë.

Ashtu si ndërmarrjet e mëdha, veprimtaria e NVM-ve mund të ushtrojnë presion të konsiderueshëm në mjedis. Megjithatë, shpesh herë menaxheret e NVM-ve kanë njohuri të pakta ndaj ndikimeve mjedisore ose për legjislacionin mjedisor që prek NVM-të; kjo edhe për shkak të konsiderimit të çështjeve mjedisore si periferike në krahasim me çështjet e tjera të rëndësishme menaxhimit brenda kompanisë duke shmangur vëmendjen dhe detyrimet ndaj mjedisit. Në këtë studim rreth 53 përqind e menaxherëve të NVM-ve pretendojnë se biznesi i tyre nuk ushtron asnjë ndikim në mjedis, ndërsa 25 përqind pohojnë se ndikimi në mjedisi është i ulët. Për të ndihmuar NVM-të për të kapërcyer një numër pengesash që ata hasin për të përmirësuar performancën mjedisore dhe për të respektuar legjislacionin mjedisor kombëtar, programe dhe projekte specifike nga qeveria dhe donatorët duhen hartuar dhe zbatuar në bashkëpunim të ngushtë me bashkësinë e NVM-ve dhe shoqatat e tyre të biznesit. NVM-të mund të përfitojnë gjithashtu nga mundësitë ekonomike që lindin si rezultat i adresimit të çështjeve mjedisore dhe krijimit të tregjeve për teknologjitë dhe produktet ekologjike. Në Europë zbatohen aktualisht një numër i konsiderueshëm programesh në lidhje me çështjet dhe ekoteknologjitë dhe përfitimi i NVM-ve shqiptare nga pjesëmarrja në to do të ishte jo vetëm mjedisor por edhe fitimprurës.

Fondacioni i Biznesit të Vogël i nisur nga objektivat e Programit të EU dhe në kuadër të projektit "Nxitja e Performancës Mjedisore të NVM-ve dhe aktorëve rajonale në Shqipëri" përgatiti këtë studim në bashkëpunim me ekspertët përkatës për të identifikuar problemet mjedisore në lidhje me veprimtaritë biznesore, ndikimin e politikave shtetërore dhe të institucioneve përkatëse në performancën mjedisore të NVM-ve, shkallën e njohjes dhe të reagimit ndaj ndikimeve mjedisore të NVM-ve në vend, pengesat që hasin NVM-të për përmirësimin e performancës mjedisore dhe të efikasitetit të energjisë. Pas vlerësimit dhe studimit të informacionit, raporteve të qeverisë dhe të donatoreve dhe legjislacionit specifik mjedisor kombëtar, evropian e ndërkombëtar në lidhje me çështjet që kanë lidhje me NVM-ve dhe kontaktit direkt me grupin e synuar nëpërmjet anketimit dhe intervistimit është arritur në formulimin e përfundimeve dhe të rekomandimeve, të cilat besojmë se do të shërbejnë NVM-ve dhe institucioneve të interesuara qendrore e vendore për të mbështetur bashkësinë e NVM-ve për rritur aftësitë konkurruese të tyre dhe përmirësuar pajtueshmërinë e tyre ligjore mjedisore.

¹ Guidelines for the CARDS 2006 "Support to the Albanian CSOs"

Gjetjet dhe përfundimet kryesore të studimit janë renditur si më poshtë:

- Në vitet e fundit është krijuar një kuadër ligjor i përshtatshëm për ushtrimin e veprimtarisë biznesore të NVM-ve shqiptare në përputhje me detyrimet mjedisore të tyre. Promocioni i informacionit mjedisor për NVM-të, përfshirë këtu edhe promocionin i legjislacionit mjedisor është i pakët dhe njohuritë dhe dijet mjedisore dhe ndikimi mjedisor për pasojë janë pak të njohura për NVM-të.
- Përveç disa programeve specifike për mbështetjen financiare të NVM-ve, nga qeveria shqiptare dhe donatorët nuk ka patur deri tani ndonjë program të veçantë për mbështetjen e NVM-ve për të rritur performancën mjedisore dhe pajtueshmërinë ligjore të tyre. Deri në fund të vitit 2008 nuk ka asnjë NVM shqiptare të certifikuar në ISO14000 gjë që tregon për pavëmendje dhe përgjegjshmëri të ulët të menaxhereve të NVM-ve në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe mungesën e programeve qeveritare e të donatoreve në këtë fushë.
- Realisht ndërmjet Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit nuk ka ndonjë dallim në kompetenca dhe përgjegjësi në qarqe, pavarësisht se në dispozitat ligjore përkatëse ka dallime të dukshme. Në Agjencitë Rajonale të Mjedisit duhet bërë një ndarje e qartë e kompetencave dhe e detyrave ndërmjet ekspertit të mjedisit dhe inspektorit të mjedisit. Ndofta duhet ndjekur shembulli tipik i ndarjes së punëve psh. midis Agjencive Rajonale të Punësimit dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës.
- Një numër i konsiderueshëm i NVM-ve nuk i njohin ndikimet e tyre aktuale dhe potenciale në mjedis të veprimtarive të tyre prodhuese e tregtare. Kjo gjendje vjen edhe si pasojë e politikave të mosshtrëngimit për aplikim për leje mjedisore në organet përkatëse. Personeli i ARM-ve dhe IMM duhet të jetë shumë aktiv në nxitjen e NVM-ve për tu pajisur më leje mjedisore dhe për tu angazhuar kështu në përmirësimin e performancës së tyre ndaj mjedisit.
- Edhe në rastet kur NVM-të janë të pajisura më leje mjedisore, kushtet dhe kriteret në lejen mjedisore përmbushen pjesërisht, për më shumë monitorimi i shkarkimeve të tyre në ajër, ujë dhe tokë dhe menaxhimi i përshtatshëm i mbetjeve industriale nuk është efektiv dhe real. Për një shumicë të NVM-të, kostoja e kryerjes së analizave të monitorimit të shkarkimeve është e lartë.
- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nuk ka aktualisht programe specifike për rritjen e kapaciteteve profesionale të personelit të ARM-ve dhe të IMM. Një numër zyrash të ARM/IMM në qarqe nuk janë të papërshtatshme dhe nuk janë pajisura me mjete dhe pajisje zyre. Mbështetja teknike dhe financiare për inspektimet në biznese është e pamjaftueshme, duke renditur mungesën e automjeteve, mjeteve dhe uniformave të mbrojtjes në punë dhe të kompensimeve për inspektorët e mjedisit.
- Megjithë vlerësimet pozitive në lidhje me disa nga treguesit e Kartës për Bizneset e Vogla nga ana e OECD për Qeverinë Shqiptare, ende nuk ka programe të qarta në lidhje më zbatimin e parimeve të Aktit për Biznesin e Vogël nga Qeveria shqiptare të trupëzuara në politikat për mbështetjen e NVM-ve. Një nga parimet e rëndësishme në mbështetje të NVM-ve është shndërrimi i sfidave mjedisore në mundësi biznesi për NVM-të gjë që kërkon asistencë të kualifikuar e të shumëanshme.

- Politikat shtetërore në lidhje me taksat mjedisore janë të pamjaftueshme. Përdorimi i politikave fiskale për të përmirësuar dhe zbatuar kuadrin ligjor rregullator dhe për rrjedhojë përmirësimin e performancës mjedisore të NVM-ve ende mungon. Mungojnë stimujt e fuqishëm fiskale në përdorimin e gazit të lëngshëm për industrinë, për biokarburantet, për produktet dhe lëndët e para ekologjike, për materialet paketuese ekologjike.
- Qeveria shqiptare së bashku me institucionet përgjegjëse nuk kanë hartuar ndonjë program/projekt për të mbështetur rrjetet rajonale të NVM-ve për të lehtësuar regjistrimin në ISO ose EMAS. Vlera e regjistrimit në ISO ose EMAS si një mjet marketingu e konkurrence duhet të rritet e fuqizohet nëpërmjet fushatave për të rritur ndërgjegjësimin publik dhe të NVM-ve në lidhje me mbrojtjen e mjedisit.
- NVM-të shqiptare në përgjithësi përdorin makineri dhe pajisje të cilat janë të brezave të vjetër dhe të përdorura që do të thotë se ato nuk kanë të integruar në linjat teknologjike pajisje për pakësimin e ndotjeve në ajër, në ujë dhe tokë dhe për riciklimin e mbetjeve të tyre. Po kështu, shumë pak NVM kanë të instaluar pajisje fundore për pakësimin e ndotjeve. Në shumë NVM, përdorimi i lëndëve djegëse të rënda si mazut, solar dhe naftë dhe i automjeteve të vjetër për transport është problematik për mjedisin.
- Pjesëmarrja e NVM-ve shqiptare në programet europiane në fushën e mjedisit është tepër e ulët si psh: në programet Eco-Innovation, FP7, SEE-TCP dhe IPA Adriatic. Kjo për shkak të mungesës së programeve mbështetëse dhe kapacitetit të pamjaftueshme të NVM-ve për t'ju përgjigjur kërkesave dhe kriterëve të pjesëmarrjes në këto programe. Në programe të tjera të EU që kanë përparësi çështjet mjedisore dhe të energjisë institucionet dhe NVM-të shqiptare nuk mund të marrin pjesë për shkak të mosplotësimit të kushteve të pjesëmarrjes nga Qeveria Shqiptare si psh në Intelligent Energy, LIFE+, Green Building, Green Light.
- Shumica absolute e përfaqësuesve të NVM-ve të intervistuar, 97 përqind, e vlerësojnë shumë të rëndësishëm dhe të rëndësishëm mbrojtjen e mjedisit dhe sipas tyre shqetësim i madh për ta është ndotja e ujit, ajrit dhe tokës (17 përqind e të anketuarve), dëmtimi i relievit/peisazhit dhe humbja e biodiversitetit (17 përqind), dëmtimi shëndetit të njeriut (16 përqind) dhe menaxhimi i mangët i mbetjeve urbane e industriale (16 përqind).
- Megjithëse shumica e të anketuarve, 70 përqind e tyre, pohojnë se janë shumë të informuar dhe të informuar për çështjet e mbrojtjes së mjedisit, përsëri ka një masë kritike të përfaqësuesve të biznesit rreth 30 përqind, të cilët shprehen se janë pak të informuar në përgjithësi për çështje të mjedisit, për ndikimet e veprimtarive të tyre biznesore në mjedis si edhe për çështje, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.
- Rreth 94 përqind e bizneseve të anketuar konsiderohen ndërmarrje të vogla më deri në 49 punonjës, por në shumicën e tyre 61 përqind janë shumë të vogla më deri 9 punonjës. Për këtë shkak është shumë vështirë që një ndërmarrje e vogël të përballojë financiarisht punësimin e një eksperti të mjedisit dhe/ose të energjisë. Rreth 38 përqind e ndërmarrjeve pohojnë se kane caktuar një person përgjegjës si për mjedisin ashtu edhe për energjinë, ndërsa 19 përqind e tyre vetëm një person përgjegjës për çështjet mjedisore dhe 28 përqind vetëm për çështjet e energjisë. Rreth 15 përqind e NVM-ve nuk kanë të punësuar asnjë person përgjegjës për çështjet mjedisore dhe/ose të energjisë.

- Megjithëse deri në fund të 2008 nuk kishte asnjë ndërmarrje shqiptare të certifikuar në ISO14000, komponentë dhe praktika, të cilat janë pjesë përbërëse e standardit kanë filluar të zbatohen nga NVM-të. Kështu përfaqësuesit e NVM-ve pohojnë se marrin pjesë në seminare e konferenca, të cilat kanë lidhje me çështjet mjedisore, rreth 43 përqind e të anketuarve, 39 përqind pohojnë se kryejnë monitorime të konsumit të energjisë, 36 përqind e NVM-ve raportojnë se punonjësit e tyre kanë ndjekur trainime specifike për mjedisin dhe 34 përqind monitorojnë performancën mjedisore. Rreth 33 përqind e ndërmarrjeve pretendojnë se kanë politika të shkruara mjedisore.
- Përfaqësuesit e NVM-ve mendojnë se motivet që do ti nxisnin ata të zbatonin një nga standardet për mjedisin ISO14000 ose EMAS do të ishin parandalimi dhe kontrolli i mbetjeve (90 përqind), përmirësimi i imazhit të kompanisë (85 përqind), përmirësimi i pajtueshmërisë ligjore (83 përqind). Motivet e tjera si përmirësimi i marrëdhënieve me inspektoratet, ulja e kostove të menaxhimit të mbetjeve dhe pakësimi i konsumit të energjisë janë në diapazonin nga 77 deri në 79 përqind të NVM-ve.
- Në Shqipëri ende nuk ka programe qeveritare dhe stimuj motivues për ndërmarrjet që të fillojnë të zbatojnë sisteme të ndryshme të menaxhimit. Komponentë të standardeve ndërkombëtare rezultojnë të zbatohen në një diapazon rreth 50 përqind për sigurinë ushqimore; gjë është një shifër shumë e ulët kur bëhet fjalë që shumica e ndërmarrjeve të intervistuarra i përkasin sektorit të agropërpunimit; nga 40 deri në 70 përqind për komponentë të standardeve të ndryshëm si ISO për mjedisin (63 përqind), për cilësinë (63 përqind), të energjisë (75 përqind) dhe të standardeve të ILO-s për punësimin (61 përqind) dhe të standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (41 përqind).
- Shkalla e njohjes së ndikimeve në mjedis për elemente të ndryshëm të mjedisit është e ulët. Përfaqësuesit e biznesit në të tre qarqet mendojnë se gjatë përdorimit të burimeve natyrore si ujë, tokë, pyje, energji, materiale nuk ushtrojnë asnjë ndikim në mjedis mesatarisht rreth 53 përqind e tyre dhe një grup prej 25 përqind mendojnë se ndikimi i tyre në mjedis është i ulët dhe vetëm 13 përqind i lartë.
- Të pyetur për aspektet teknike e teknologjike të investimeve të tyre në mbrojtje të mjedisit dhe për përmirësimin e performancës së tyre mjedisore, 57 përqind e NVM-ve pretendojnë se kanë marrë masa që kanë çuar në përmirësime teknologjike të integruara, 37 përqind kanë marrë masa për përmirësime teknologjike fundore për mbrojtjen e mjedisit përreth objektit të veprimtarisë biznesore dhe 11 përqind kanë ndërhyrë në përmirësime mjedisore të produktit si në projektim, paketim, përdorim të materialeve ndihmese e paketuese e lëndëve të para më pak të dëmshme për mjedisin. Vetëm 7 përqind e NVM-ve pohojnë se nuk kanë marrë asnjë masë.
- Pengesat kryesore që NVM-ve shqiptare ndeshin për të punuar në pajtim me legjislacionin mjedisor kombëtar janë mungesa e burimeve financiare në 54 përqind të NVM-ve të intervistuarra, mungesë dijesh në lidhje me përfitimet që vijnë nga zbatimi i standardeve për mjedisin ISO14001 dhe EMAS në 41 përqind të tyre dhe mungesa e informacionit mjedisor për bizneset në 32 përqind. Çështje të tjera që shqetësojnë NVM-të janë mungesa e njohurive dhe e asistencës teknike për çështjet mjedisore në 29 përqind të tyre.
- Përfaqësuesit e ndërmarrjeve, rreth 22 përqind e tyre, raportojnë se problemet më të mëdha në përdorimin me efikasitet dhe kursim të energjisë e kanë burimin në çmimet monopol në sektorin e energjisë elektrike si edhe të lëndëve djegëse si naftë, solar e

gaz të lëngshëm. Problem paraqesin vështirësitë në financim dhe kreditim për 18 përqind të NVM-ve për përmirësime të teknologjive të prodhimit, kuadri rregullator i papërshtatshëm për këtë çështje për 17 përqind dhe mungesa e informacionit për 14 përqind dhe e ekspertizës për 10 përqind të NVM-ve.

- Rol shumë të rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e praktikave mjedisore sipas pronareve dhe menaxhereve të NVM-ve luajnë qeveria (98 përqind) dhe inspektoratet (97 përqind), duke përfshirë këtu edhe inspektoratin e mjedisit. Ndërkohë sipas të intervistuarve të NVM-ve, ndikim të konsiderueshëm luajnë konsumatorët dhe furnitorët e ndërmarrjeve (80 përqind). Institucionet donatore dhe bankat ndikojnë në masën rreth 70 përqind në grupin e NVM-ve të intervistuar. Nga anketimi rezulton që ndikimi i organizatave të mjedisit, shoqatave dhe organizatave të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare është më i dobët së i aktoreve të tjerë, në përqindje zbritet deri në 60 përqind.
- Përfaqësuesit e kompanive shqiptare të intervistuar shprehen pozitivisht në lidhje me përparësitë që do të ofronte certifikimi i kompanive të tyre në ISO 14001 ose EMAS, sidomos në drejtim të përsheptimit të marrjes së lejes mjedisore (66 përqind), lehtësimit të rregullave mjedisore (58 përqind) dhe pakësimit të inspektimeve mjedisore (52 përqind). Ndërkohë institucionet qeveritare kanë ende mundësi të kufizuara për asistencë teknike dhe mbështetje financiare për kompanitë shqiptare dhe sipas të të intervistuarve kjo mbështetje shkon vetëm për 35 përqind të ndërmarrjeve të marra në anketim. Po kështu avantazhi që mund të siguronte certifikimi në ISO/EMAS në prokurimet publike mbështet deri në masën 38 përqind e totalit të ndërmarrjeve të anketuara.
- Shkalla e njohjes së legjislacionit mjedisor nga NVM-të është e ulët, sidomos ai që lidhet direkt më veprimtarinë specifike të ndërmarrjes. Shumica e NVM-ve ose 2/3 e tyre nuk përmendin asnjë ligj nga fusha e mjedisit, ndërkohë që 1/3 përmend vetëm ligjin kuadër për mbrojtjen e mjedisit duke e konsideruar atë favorizues. Shumica e NVM-ve (86 përqind) shprehen se legjislacioni mjedisor nuk luan aspak rol pengues në veprimtarinë e tyre prodhuese e tregtare. Mqs. një pjesë e kompanive janë të detyruar të pajisjen më leje mjedisore, përfaqësuesit e NVM-ve shprehen se ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis ushtron një farë kufizimi në 13 përqind të tyre.
- Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të intervistuar rezulton se 45 përqind e tyre janë inspektuar më shumë se katër herë në tre vitet fundit. Ndërkohë rregullisht një herë në vit janë inspektuar vetëm 13 përqind e ndërmarrjeve dhe 17 përqind e tyre asnjëherë. Inspektimet mjedisore varen edhe nga lloji i veprimtarive të ndërmarrjeve, përkushtimi i inspektorateve rajonale dhe burimet e mundësitë teknike, financiare e njerëzore të inspektoratit të mbrojtjes së mjedisit.

Rekomandimet për përmirësimin e performancës mjedisore dhe pajtueshmërisë ligjore të NVM-ve

1) Krijimi i kuadrit ligjor të përshtatshëm për ushtrimin e veprimtarisë biznesore të NVM-ve shqiptare në përputhje me detyrimet mjedisore të tyre është një arritje e vlerësueshme për qeverinë dhe institucionet përkatëse. Vazhdimi i transpozimit të legjislacionit europian mjedisor, i ratifikimit të konventave ndërkombëtare për mjedisin dhe përmirësimi i promocionit të informacionit mjedisor dhe i legjislacionit mjedisor nëpërmjet fushatave informuese e edukuese për NVM-të duhet të jetë përparësi e vazhdueshme për Ministrinë e Mjedisit dhe institucionet e saj ekzekutive.

2) Hartimi dhe financimi i programeve specifike nga qeveria shqiptare dhe donatorët për mbështetjen teknike e financiare të NVM-ve për të rritur performancën mjedisore dhe pajtueshmërinë ligjore të tyre duhet të jetë një përparësi tjetër e rëndësishme për institucionet e vendit. Këto programe duhet të përfshinë gjithashtu nxitjen dhe mbështetjen e NVM-ve shqiptare për certifikimin në standardet ndërkombëtare për mjedisin si psh.: ISO14000 dhe EMAS.

3) Në vend operojnë një numër i konsiderueshëm inspektoratesh, të cilët në analizë të fundit janë barrë administrative shqetsuese për NVM-të. Integrimi dhe/ose bashkërendimi i procedurave të inspektimit të disa inspektorateve me mandat të krahasueshëm do të rriste shkallën e efektivitetit të tyre, lehtësonte barrën administrative e financiare të bizneseve, do të pakësonte shkeljet ligjore si dhe do të pakësonte dukurinë e korrupsionit. Integrimi i procedurave të inspektimeve të Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit, të Inspektoratit Shtetëror të Punës, Inspektoratit Shtetëror të Shëndetit dhe Inspektoratit të Sigurisë Ushqimore do të jepte rezultate të larta në mbrojtjen e shëndetit, mbrojtjen e mjedisit dhe respektimin e standardeve të punësimit, të sigurisë dhe të shëndetit në punë.

4) Një numër i konsiderueshëm i NVM-ve nuk i njohin plotësisht ndikimet aktuale dhe potenciale mjedisore të veprimtarive të tyre prodhuese, tregtare, të shërbimit e ndërtimit, ende nuk vlerësohen përfitimet nga sinergjia e çështjeve mjedisore më ato tregtare. Kjo gjendje vjen edhe si pasojë e mosnxitjes dhe mosaplikimit të NVM-ve për pëlqim, autorizim e leje mjedisore në organet përkatëse. Personeli i ARM/IMM duhet të promovojë domosdoshmërinë e pajisjes me leje mjedisore të NVM-ve dhe të kërkojë zbatimin e kushteve dhe kriterëve të lejes mjedisore për të përmirësuar kështu performancën e tyre ndaj mjedisit.

5) Një kontribut të rëndësishëm për përmirësimin e performancës mjedisore të NVM-ve duhet të japin ARM-të dhe IMM. Forcimi i vazhdueshëm institucional dhe rritja e kapaciteteve profesionale të personelit të tyre, krijimi i përvojës pozitive tek ky personel nëpërmjet ngritjes dhe ndjekjes së procedurave profesionale para, gjatë dhe pas inspektimit dhe e programeve e protokolleve të inspektimit, programimi i vazhdueshëm i veprimtarive dhe i inspektimeve, mbështetja e vazhdueshme teknike për këto zyra me burime njerëzore, materiale e teknike si psh. eksperte ekologë e juriste, mjete zyre dhe mjete elektronike komunikimi, rritja e motivimit financiar për kryerjen eficiente të inspektimeve do të ndikonte direkt për rritjen e performances mjedisore dhe të pajtueshmërisë ligjore të NVM. Plotësimi i kriterëve minimale për inspektimet mjedisore duhet të realizohet sa më shpejt mbi bazën e Direktivës Europiane IPPC.

6) Pjesëmarrja e NVM-ve dhe OJF-ve në programet europiane dhe të donatoreve të tjerë është e ulët. Programet qeveritare dhe të donatoreve duhet të hartohen dhe të synojnë ofrimin e asistencës për rritjen e kapaciteteve të NVM-ve dhe të OJF për të marrë pjesë dhe aplikuar në programet europiane si psh: të bashkëpunimit kufitar më vendet

fqinje, në programet SEE-TCP, Eco-Innovation, FP7, Intelligent Energy, EMAS, Eco-Label, Life+.

7) Qeveria duhet të fillojë hartimin dhe zbatimin e politikave, strategjive dhe programeve për të synuar modelet europiane të avancuara të konsumit dhe prodhimit të blertë. Adoptimi i politikave europiane në fushën e teknologjive mjedisore për mbrojtjen e mjedisit, në zbutjen e ndryshimeve klimatike, në pakësimin e shkarkimeve ndotëse, në menaxhimin modern të mbetjeve si psh: të prokurimit të blertë, të ndërtesave të blerta, të energjisë efçente, të ndriçimit të blertë, të eko-projektimit duhet të fillojnë të aplikohen në legjislacionin dhe në praktikatat biznesore të NVM-ve shqiptare .

8) Në mënyrë periodike dhe sistematike duhen bërë vlerësime të efektivitetit të politikave publike mjedisore. Ngritja e një aparati statistikor për mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe studimin në lidhje me performancën mjedisore, treguesit mjedisore, masat dhe investimet për çështjet mjedisore do të ndihmojë për orientimin e drejtë të politikave mjedisore shtetërore. Ngritja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i një sistemi të besueshëm statistikor të mbledhjes e përpunimit të të dhënave, forcimi i institucioneve për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve, për cilësinë e mjedisit dhe për inspektimet, aplikimi i standardeve europiane për treguesit mjedisore (CSIs) duhet të jetë përparësi për institucionet përgjegjëse.

9) Për mbështetjen e teknologjive mjedisore dhe të eko-novacioneve duhet të hartohen programe dhe krijohen fonde të veçanta qeveritare për nxitjen dhe zhvillimin e tyre. Rritja e bashkëpunimit midis institucioneve kërkimore e studimore dhe NVM-ve është domosdoshmëri për transferimin e teknologjive mjedisore, shfrytëzimin e energjive të rinovueshme dhe rritjen e efçencës së energjisë.

10) Rregullorja e re të EMAS 2009 kërkon dhe detyron qeveritë e vendeve anëtare të EU duke filluar nga 2010 për grumbullimin e informacionit dhe të të dhënave për performancën dhe treguesit mjedisore të ndërmarrjeve si psh: normativat në konsumin e lëndëve të para e ndihmese, materialeve, energjisë, prodhimin e trajtimin e mbetjeve për të vlerësuar kostot, konkurueshmërinë e produktivitetin e NVM-ve europiane. Nuk duhet të konsiderohet e parakohshme programimi dhe planifikimi për fillimin e grumbullimit të një informacioni të tillë edhe nga ndërmarrjet shqiptare.

11) Përmirësimi i legjislacionit aktual për efçencën e energjisë është i domosdoshëm. Programet shtetërore për mbështetjen e NVM-ve për rritjen e efçencës së energjisë dhe adoptimi i masave, mjeteve, materialeve, lëndëve djegëse e karburanteve, të cilat janë efçente dhe pakësojnë ndotjen në mjedis duhet të jenë prioritet afatgjatë për institucionet shqiptare, duke përfshirë këtu edhe promovimin për prodhimin dhe përdorimin e energjive të rinovueshme si atë të diellit, të erës, të ujit dhe të biomasës.

12) Përmirësimi i kuadrit ligjor për çështjen e monitorimit të treguesve mjedisore në ndërmarrje është i domosdoshëm. Përcaktimi specifik i çdo treguesi për monitorim në çdo NVM duhet të jetë përgjegjësi e institucioneve të specializuara, të cilat njohin teknologjitë respektive të NVM-ve. Megjithëse në ligj theksohet së është përgjegjësi ligjore e ndërmarrjes për kryerjen e monitorimit të treguesve mjedisore të përcaktuar në lejen mjedisore, përsëri është e nevojshme ende asistencë institucionale për NVM-të për të kryer efektisht këto vetmonitorime periodike.

13) Mbështetja politike për krijimin e gjykatës administrative nuk duhet të vonohet. Zgjidhja e çështjeve ligjore mjedisore me NVM-të dhe zvarritjet për pagesat e gjobave mjedisore nga NVM-të që shkelin ligjet kërkojnë shumë kohë në sistemin e sotëm

gjyqësor duke krijuar një barre të tepërt si për bizneset ashtu edhe për administratën publike.

14) Një pjesë e madhe e kompetencave edhe e autoritetit për mbrojtjen e mjedisit i kanë kaluar qeverisjes vendore dmth: bashkive, komunave dhe qarqeve. Është çështje e rëndësishme së pari: balancimi i kompetencave me mbështetjen financiare sepse perceptimi vendor është që kompetencat janë të mëdha ndërkohë që mbështetja financiare për realizimin e tyre është e pamjaftueshme dhe së dyti, kontrolli i shpenzimeve publike për çështjet mjedisore është joefektiv në nivel qendror dhe vendor. Buxheti vjetor për mbrojtjen e mjedisit është ende i ulët, po kështu granti qeveritar për bashkitë e komunat nuk është i mjaftueshëm dhe shpenzimet për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve janë joeficiente ose shpërdorohen.

15) Suksesi i reformave në fushën e mbrojtjes së mjedisit varet shumë nga shkalla e bashkëpunimit midis institucioneve qendrore dhe aktoreve rajonale e vendore si psh: agjencive rajonale të mjedisit dhe drejtorive mjedisore të bashkive, komunave, qarqeve, përfaqësuesve të biznesit në qark si dhomave të tregtisë e industrisë dhe shoqatave të biznesit dhe OJF mjedisore. Përmirësimi i komunikimit dhe koordinimit midis këtyre institucioneve, rritja e pjesëmarrjes së tyre dhe e publikut në vendimmarrje për çështjet e mjedisit do të ndikojë shumë pozitivisht në zbatimin e legjislacionit mjedisor dhe përmirësimin e performance mjedisore të NVM-ve.

16) Në rivlerësimin dhe rishikimin e afërt të Strategjive Sektorale për Mjedisin 2007-2013 dhe të Strategjisë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2007-2013, të miratuara nga Qeveria Shqiptare, duhet të përfshihen politika të qarta për mbështetjen e përmirësimit të performancës mjedisore dhe pajtueshmërisë ligjore të NVM-ve dhe nxitjes për integrimin e këtyre çështjeve në strategjitë e zhvillimit të NVM-ve. Rritja e bashkëpunimit midis dy institucioneve respektive Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Ekonomisë për hartimin dhe zbatimin e programeve të përbashkëta në këtë fushë është e domosdoshme.

17) Hartimi i programeve dhe mbështetja financiare për kualifikimin e vazhdueshëm brenda dhe jashtë vendit, sigurimi i pjesëmarrjes në veprimtari për çështjet mjedisore dhe për zbatimin e legjislacionit mjedisor është i domosdoshëm për rritjen e performancës së stafeve të ARM/IMM dhe të atyre të institucioneve të tjera përgjegjëse. Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira në fushën e proceduarve dhe protokolleve për inspektimet mjedisore në rrjetin IMPEL, INECE, REPIN, ECENA dhe konsultimi i vazhdueshëm për rritjen e efektivitetit të inspektoratit duhet të konsiderohet i rëndësishëm dhe i domosdoshëm.

18) Industritë e agropërpunimit në rastin tonë të përpunimit të qumështit, të mishit të frutave e perimeve janë konsumatore të mëdhenj të ujit dhe për pasojë prodhojnë sasi të konsiderueshme të ujit të ndotur. Marrja e masave për filtrimin e ujit në hyrje të impianteve të përpunimit dhe trajtimi paraprak i ujit të ndotur nëpërmjet trajtimeve mekanike, biologjike kimike duhet të merret seriozisht në konsideratë nga ky sektor industrial gjë që mund të përballohet financiarisht nga këto biznese. Zgjidhje të tjera për trajtimin e ujit të ndotur përfshinë impiantet e depurifikimit të ujit, trajtimin dytësor dhe tretësor të ujit të ndotur në mënyrë individuale ose kolektive për NVM-të.

19) Në lidhje me shkarkimet atmosferike gjendja rezulton jo e mirë sepse shumica e NVM-ve të sektorit të agrobiznesit përdorin për nevojat e prodhimit lëndë djegëse mazut, solar, më pak naftë dhe shumë më pak gaz të lëngshëm. Në Shqipëri kemi ndeshur me shembuj pozitive të pakësimit të ndotjes atmosferike si nëpërmjet vendosjes së filtrave të

gazit në kaldajat e prodhimit të avullit ose modifikimit të tyre për të punuar më gaz të lëngshëm, i cili është shumë herë më pak ndotës se karburantet dhe ka aktualisht çmim të krahasueshëm më solarin.

20) Në lidhje më trajtimin e mbetjeve mund të pohohet që shumica e NVM-ve nuk bëjnë asnjë lloj trajtimi të tyre që mund të jetë pakësimi, ripërdorimi dhe riciklimi (3R), dhe trajtimi i fundit duhet të jetë depozitimi në vendgroposjen e përcaktuar publike. Mbetjet organike të industrisë së agropërpunimit mund të përdoren për ushqim për kafshët e shpendët ose pleh organik si psh. hirra, kockat, bërsitë, mbetjet e pastrimit dhe seleksionimit të fruta e perimeve. Mbetjet e paketimit (letër, karton, plastmas, metalik, qelq) përsëri mund të shiten në ndërmarrjet e riciklimit të tyre.

21) NVM-të shqiptare kanë një intensitet të lartë të energjisë për njësi prodhimi, dhe kostot e energjisë zënë deri në 20 përqind të kostos së prodhimit. Paraprakisht, ato mund të marrin masa fillestare, të cilat shpesh here janë pa kosto, ndërkohë që marrja e masave për optimizmin e përdorimit të makinerive, pajisjeve, dhomave frigoriferike, automjeteve të transportit mund të pakësojë konsumin e energjisë elektrike dhe të lëndëve djegëse e karburanteve. Në masat e tjera mund të përmenden zëvendësimi i motorëve të vjetër më ato të rinj të blerë në vendet europiane, të cilët konsumojnë deri 25 përqind më pak energji, zëvendësimi i ndriçimit me lampa fluoeshente, përdorimi i stabilizatorëve të energjisë, përdorimi i gazit të lëngshëm në vend të solarit ose naftës në kaldaja, përdorimi i pajisjeve të zyrës të cilët janë të klasifikuar më logon Energy Star, blerja e pajisjeve industriale të koduara sipas shkallës së efikasitetit të energjisë, marrja e masave për termo dhe hidroizolimimin e ndërtesave, pajisjeve, makinerive, tubacioneve, dyerve, dritareve, mureve.

22) Një numër i konsiderueshëm ndërmarrjesh të vogla e të mesme operojnë të grupuara në zonat industriale në periferi të qyteteve kryesore dhe përdorin rrjete të përbashkëta të furnizimit më ujë, energji, të shkarkimeve të ujrave të ndotura dhe të trajtimit të mbetjeve të ngurta. Promovimi i bashkëpunimit të këtyre ndërmarrjeve dhe ofrimi i asistencës teknike e financiare për ngritjen e impianteve të përbashkëta për trajtimin e mbetjeve, ujrave të përdorur dhe shkarkimeve të tjera do të ulte kostot e trajtimit dhe do të përmirësonte dukshëm performancën mjedisore të këtij grupi ndërmarrjesh.

II Hyrje

Studimi "Performanca mjedisore dhe pajtueshmëria ligjore e NVM-ve" është një komponent i rëndësishëm i veprimtarive që zhvillohen në kuadër të projektit të Fondacionit të Biznesit të Vogël "Nxitja e Performances Mjedisore të NVM-ve dhe aktorëve rajonale në Shqipëri (PEPSME)" i bashkëfinancuar nga EU për gjatë viteve 2009-2011.

Studimi ka për qëllim kryesor vlerësimin e shkallës së integritit të çështjeve mjedisore në strategjitë e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme dhe kryesisht në ato të prodhimit. Përfshirja e çështjeve të mjedisit në veprimtarinë ekonomike të shoqërive tregtare në përgjithësi dhe në operacionet e prodhimit në veçanti është e lidhur ngushtë me një sërë faktorësh si psh.: me motivet tregtare të shoqërive, me procedurat në marrjen vendimeve, disponibilitetin e burimeve njerëzore dhe financiare, politikat dhe programet qeveritare, legjisllacionin kombëtar mjedisor dhe performancën e institucioneve zbatuese, si edhe me shkallën e njohjes së përfitimeve nga zbatimi i sistemeve të menaxhimit mjedisor nga vetë përfaqësuesit e bizneseve.

Në vendet e EU është vlerësuar që 70 përqind e ndotjes industriale shkaktohet nga NVM-të, numri të cilave arrin në rreth 23 milion ndërmarrje² dhe përbejnë 99 përqind të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve. Ndikimi i kësaj ndotje është i lartë jo vetëm në mjediset prodhuese e natyrore por edhe në bashkësitë njerëzore që jetojnë pranë zonave industriale. Aktualisht sfidë reale për të gjitha bizneset është adoptimi i proceseve dhe i produkteve ekoeficiente dhe orientimi drejt teknikave e proceseve më të pastra të prodhimit. Sfidat e ndryshimeve klimatike ka nxitur EC që në vitet e fundit ti kushtojë një rëndësi të veçantë rritjes së pajtueshmërisë ligjore dhe të performancës mjedisore të bizneseve nëpërmjet organizimit të fushatave informuese e promovuese, organizimit të programeve për ngritjen e kapaciteteve të NVM-ve dhe institucioneve të tyre mbështetëse dhe zbatimit të programeve të mbështetjes financiare në fushën e mjedisit dhe të efikasitetit të energjisë.

Çështja e rëndësishme e mbrojtjes së mjedisit dhe e përdorimit eficient të energjisë në vendin tonë si nga publiku ashtu edhe nga ndërmarrjet është në fazat e para të njohjes dhe të vlerësimit. Në Shqipëri operojnë rreth 106,477 NVM³, të cilat ashtu si në Europë kontribuojnë shumë në ndotjen e mjedisit dhe në konsumin joeficient të energjisë. Vetëm në pesë vitet e fundit janë krijuar mesatarisht rreth 13,000 ndërmarrje të reja në vit. Ndërmarrjet prodhuese përbejnë rreth 15 përqind të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve ku përfshihen ndërmarrjet e prodhimit industrial, të ndërtimit, të bujqësisë e të peshkimit. Ndërmarrjet shumë të vogla me deri në nëntë punonjës përbëjnë 96 përqind të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve, gjë që ndikon në trajtimin e pamjaftueshëm e të papërshtatshëm të çështjeve mjedisore dhe energjetike për shkak të kapaciteteve financiare dhe njerëzore të kufizuara në këto ndërmarrje. Studimet për vlerësimin e shkallës së njohjes, masat parandaluese, teknologjitë që përdoren dhe për vlerësimin e qëndrimit dhe sjelljes së kompanive ndaj mjedisit mungojnë. Ende nuk bëhen vlerësime të nivelit të investimeve në pajisjet fundore ose në teknologjitë e integruara dhe të shkallës së përfitimit në rastet e realizimit të investimeve.

Shumë pak kompani shqiptare kanë adoptuar standardet ndërkombëtare në fushën e cilësisë, mjedisit, sigurisë ushqimore dhe sigurisë e shëndetit në punë; në fund të 2008 vetëm 47 kompani shqiptare ishin certifikuar në ISO për cilësinë dhe sigurinë ushqimore dhe asnjë për mjedisin⁴. Elementë të këtyre standardeve zbatohen vetëm pjesërisht ose në një nivel shumë të ulët.

² EUROSTAT 2008

³ INSTAT 2010

⁴ ISO Survey 2008

Në Shqipëri është krijuar një kuadër i nevojshëm ligjor në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe efikasitetit të energjisë i lidhur me veprimtaritë ekonomike të shoqërive tregtare. Një pjesë e konsiderueshme e këtij legjislacioni është transpozuar nga Direktivat e EU dhe Konventat Ndërkombëtare të Mjedisit. Në planin për zbatimin e MSA 2009-2013 janë planifikuar transpozime të mëtejshme dhe të plota të legjislacionit evropian dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit dhe të energjisë.

Nëpërmjet këtij studimi SBF synon të bëjë një vlerësim të nivelit të njohjes së aspekteve dhe ndikimeve mjedisore të veprimtarive të kompanive, të kuadrit ligjor ekzistues, të përcaktojë shkallën e ndikimit të tij në veprimtaritë ekonomike të ndërmarrjeve, të vlerësojë nivelin e përpjekjeve të ndërmarrjeve të prodhimit në rajonet e përzgjedhur për të operuar në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi. Studimi synon gjithashtu të vlerësojë nivelin teknologjik të ndërmarrjeve dhe përpjekjet e tyre për të ndërhyrë në proceset dhe produktet e prodhuara në mënyrë që të pakësojnë ndikimet negative në mjedis si psh.: në cilësinë e ajrit dhe të klimës, mbrojtjen burimeve ujore, në menaxhimin e mbetjeve, pakësimin i zhurmave dhe të vibrimeve, në mbrojtjen e tokës dhe të ujrave nëntokësore, mbrojtjen e biodiversitetit dhe të panoramës natyrore. Studimi synon gjithashtu të japë disa rekomandime të rëndësishme të cilat mund të merren në konsideratë nga NVM-të dhe institucionet e interesuara.

III Vështrim mbi zhvillimin e qëndrueshëm

3.1 Politikat për zhvillimin e qëndrueshëm

Politikat e zhvillimit të qëndrueshëm kërkojnë harmonizim sa më të lartë të politikave ekonomike, sociale e mjedisore. Sfidat e ndryshimeve klimatike, prirjet negative drejt dëmtimit të biodiversitetit, prodhimi i tepruar i gazeve serë dhe menaxhimi i mangët i mbetjeve kërkojnë që çdo vend të hartojë dhe zbatojë politika dhe strategji të cilat kombinojnë dhe harmonizojnë të tre komponentët e zhvillimit të qëndrueshëm. Integrimi i komponentit mjedisor në çështjet ekonomike e sociale mbetet një nga sfidat me të vështira për çdo vend dhe veçanërisht për vendet me zhvillim të ulët dhe me burime të kufizuara financiare e njerëzore.

Në dokumentin kombëtar strategjik "Strategjia Kombëtare për Zhvillim e Integrim 2007-2013" janë harmonizuar objektivat kryesore për zhvillim të qëndrueshëm dhe të integritit evropian duke përfshirë anëtarësimin në NATO dhe EU të Shqipërisë. Në strategji janë përcaktuar tre përparësi kryesore të zhvillimit të vendit:

- Integrimi i vendit në NATO (Shqipëria u bë anëtar i NATO-s në Mars 2009) e EU;
- Konsolidimi i shtetit demokratik bazuar në liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe garantimi i shtetit të së drejtës nëpërmjet sundimit të ligjit;
- Realizimi i zhvillimit të shpejtë, të balancuar e të qëndrueshëm.

Bazuar në Përparësinë III, komponentët kryesore të zhvillimit mjedisor krahas komponentëve të zhvillimit ekonomik e social janë përcaktuar si më poshtë:

1) Zhvillimi i sistemit energjetik bazuar në parimet e ekonomisë së tregut, liberalizmi i mëtejshëm dhe integrimi i tij në tregun rajonal energjetik. Rritja e kapaciteteve kombëtare për prodhimin e energjisë së rinovueshme dhe me ndikim të ulët në mjedis;

2) Përmirësimi i mbrojtjes së mjedisit nga ndotja dhe degradimi, kryesisht nëpërmjet përmirësimit të monitorimit, kontrollit dhe pakësimit të shkarkimeve, arritja e standardeve evropiane në cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës dhe në menaxhimin e mbetjeve.

Objektivat strategjike specifike mjedisore janë përcaktuar në Strategjinë Ndërsektorale të Mjedisit (SNM) 2007-2013, i cili është dokumenti kryesor për politikat shtetërore në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Qëllimi i SNM është plotësimi i detyrimit kushtetues ndaj

shtetasve për të siguruar të drejtën e tyre për mjedis të shëndetshëm dhe ekologjik dhe për zhvillim të qëndrueshëm nëpërmjet përdorimit racional të burimeve natyrore, ruajtjes së tyre nga ndotja dhe degradimi si dhe promovimit të vlerave mjedisore.

Strategjia Ndërsektorale e Mjedisit është pjesë përbërëse e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim në të cilën janë integruar parimet e zbatimit të saj në strategjinë e zhvillimit të përgjithshëm të vendit. Kuadri ndërsektoral ligjor garanton trajtimin e përparuar dhe të integruar të sektorit mjedisor dhe të sektorëve të tjerë me ndikim të fortë në cilësinë e mjedisit si psh. transporti, bujqësia, industria dhe ndërtimi. Objektivat e SNM janë hartuar në përputhje me dokumentet e mëposhtëm:

- Programi i Qeverisë Shqiptare;
- Plani Kombëtar për përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të EU;
- Plani i Veprimit për zbatimin e përparësive të partneritetit europian.

Objektivat e Strategjisë Ndërsektorale të Mjedisit 2007-2013 janë si më poshtë:

- Përmirësimi i cilësisë së ajrit në të gjithë territorin e vendit për ta arritur nivelin e standardeve ndërkombëtare;
- Pakësimi i shkarkimit të gazeve të efektit serrë dhe substancave ozonholluese për të kontribuar në parandalimin e ndryshimeve klimatike;
- Përmirësimi i administrimit të mbetjeve me qëllim që të pakësohen rreziqet që i kanosen shëndetit njerëzor dhe mjedisit;
- Sigurimi i ujit të pijshëm për të qënë i shëndetshëm dhe i parrezikshëm;
- Mbrojtja dhe mirëmbajtja e burimeve të ujrave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë për përdorim të sotëm dhe të ardhshëm;
- Mbrojtja dhe përmirësimi i tokës me qëllim që të përmirësohet cilësia e saj, të pakësohet gërryerja dhe të parandalohet ndotja;
- Mbrojtja dhe shtimi i biodiversitetit, zonave dhe specieve të mbrojtura me qëllim që të ruhet trashëgimia natyrore dhe kulturore e mjedisit tonë;
- Krijimi dhe funksionimi i një sistemi të integruar dhe efikas të planifikimit hapësinor zhvillimor, i cili merr në konsideratë në mënyrë të ekuilibruar objektivat ekonomike, sociale dhe mjedisore;
- Riparimi dhe rikthimi në gjendjen e mëparshme të zonave që kanë pësuar dëme mjedisore, me qëllim që të eliminohen kërcënimet ndaj shëndetit publik dhe biodiversitetit;
- Kontrolli i nivelit të zhurmave, rrezatimit, vibrimeve dhe stresit mjedisor dhe vendosja e tyre në nivele të sigurta për shëndetin.

Zbatimi i Strategjisë Ndërsektorale e Mjedisit mbështetet në një plan veprimi ku janë përcaktuar masat, afatet kohore, institucionet përgjegjëse përkatëse dhe parashikimet financiare.

Bazuar në Raportin HDR 2009⁵ Shqipëria renditet në vendin e 70-të midis 182 vendeve anëtare të UNO për vlerat e nxjerra në vitin 2007. Treguesi i Zhvillimit Njerëzor (HDI) për vitin 2007 ka arritur në 0.818 duke u rritur me 0.61 përqind në vit duke nisur nga viti 2000. Sipas klasifikimit të PNUD-it, Shqipëria është në grupin e vendeve me zhvillim të lartë njerëzor. HDI llogaritet mbi bazën e tre dimensioneve njerëzore: jetëgjatësisë, dijeve dhe standardit të jetesës, pra është një tregues që kombinon tregues të zhvillimit social me tregues të zhvillimit ekonomik të çdo vendi. Tre dimensionet maten mbi bazën e treguesve të jetëgjatësisë, arsimimit dhe PBB.

⁵ UNDP, Human Development Report 2009

Përsa i përket tregueseve në fushën e mjedisit të dhënat më të plota dhe më të besueshme janë sintetizuar në Treguesin e Performances Mjedisore (EPI), i cili kuantifikon dhe krahason numerikshitet performancën mjedisore të politikave të çdo vendi. Për vitin 2008 Shqipëria renditej në vendin e 25-të midis 149 vendeve të vrojtuar me treguesin EPI 84 nga EPI 100 që është vlera më e lartë duke lënë mbrapa vende të tilla të zhvilluara si Danimarka, Spanja, Irlanda. Treguesi EPI llogaritet mbi bazën e 25 tregueseve të grupuar sipas 6 kategorive të politikave mjedisore të tilla si: 1) shëndeti mjedisor, 2) ndotja e ajrit, 3) burimet ujore, 4) biodiversiteti dhe habitatit, 5) burimet natyrore prodhuese dhe 6) ndryshimet klimatike.


E lidhur ngushtë me mbrojtjen e mjedisit është prodhimi dhe mënyra e shfrytëzimit të burimeve energjetike të vendit. Në 2007 është përgatitur një dokument strategjik "Strategjia Sektorale e Energjisë 2007-2020"⁶ e cila nuk është miratuar ende nga Qeveria. Domosdoshmëria e përgatitjes së një strategjie për energjinë është e lidhur ngushtë me përcaktimin e drejtimeve të zhvillimit të sektorit energjistik në mënyre që të merren në konsideratë faktorë të tillë të rëndësishëm si: rritja e vazhdueshme e kërkesës vendore për energji, rritja e çmimeve të naftës e gazit në tregun botëror dhe sigurimi i furnizimit me energji. Forcimi i sektorit energjistik të vendit është një komponent i rëndësishëm i mbështetjes së rritjes ekonomike të vendit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Në dokument janë përcaktuar disa objektiva të rëndësishëm të cilat janë aktuale:

- Krijimi i një kuadri efektiv institucional e rregullator;
- Krijimi i sektorit eficient të energjisë si nga ana financiare ashtu edhe teknike;
- Rritja e sigurisë për furnizim me energji në shkallë kombëtare;
- Rritja e efikasitetit në përdorimin e energjisë, shfrytëzimi i burimeve të ripërtritshme të energjisë duke synuar ndotje minimale të mjedisit;
- Optimizimi i sistemit të furnizimit me burime energjie bazuar në parimin e planifikimit me kosto sa më të ulët dhe ndotje mjedisore minimale;
- Përfundimi i procesit të ristrukturimit të shoqërive të energjisë;
- Krijimi i tregut konkurrues të elektricitetit bazuar në kërkesat e EU për reformat në sektorin e elektricitetit.

Vitet e fundit i është kushtuar rëndësi e posaçme nga qeveria nxitjes së investimeve të huaja dhe të vendit në fushën e prodhimit të energjisë nga burimet hidrike, të hidrokarbureve dhe të erës, duke i dhënë përparësi shfrytëzimit të burimeve të rinovueshme.


Në vitin 2008, konsumi i përgjithshëm i energjisë (KPE) arriti në 2.095 Mtoe dhe kryesisht karburantet janë burimi kryesor i energjisë së konsumuar që arrin deri në 62 përqind të KPE, ndërsa energjia elektrike zë 10 përqind dhe drutë e zjarrit 11 përqind, grafiku 3 poshtë. Prirje rritëse në konsum gjatë viteve të fundit ka gazi i lëngshëm i naftës, i cili favorizohet edhe nga heqja e taksës së akcizës për të.

⁶ METE, Strategjia Sektorale e Energjisë 2007-2020 (Draft)



Burimi: METE 2010

Në konsumin e përgjithshëm të energjisë sipas sektorëve, prirje rritëse ka sektori i transportit, i cili në fund të 2008 arriti në 42 përqind, ndërsa konsumi rezidencial i energjisë ka patur prirje rënëse deri në 24 përqind. Industria konsumoi 13 përqind të energjisë, e cila kryesisht është energji elektrike, Grafiku 2 poshtë. Në konsumin përfundimtar të energjisë elektrike vendin e parë e zë sektori i banesave me 47 përqind, industria me 18 përqind, shërbimet me 24 përqind, dhe sektorët e tjerë me 11 përqind.



Burimi: METE 2010

Në shkallë ndërkombëtare përdoren dy tregues për të vlerësuar nivelin e zhvillimit të sektorit energjitik dhe efikasitetin në përdorimin e energjisë: intensiteti energjitik i cili shprehet si raport i konsumit të burimeve parësore të energjisë kundrejt PBB të vitit respektiv. Për vitin 2005 intensiteti energjitik është llogaritur 0.42 toe/milionë USD që është një shifër shumë e ulët në krahasim me vendet e rajonit si Bosnja, Maqedonia, Kroacia. Treguesi i dytë është konsumi i energjisë për frymë i cili është 0.68 toe/frymë për vitin 2005 dhe rezulton rreth dy herë më i vogël se konsumi për banor në Kroaci.

Në bazë të rekomandimeve të IEA 2009⁷, kërkohet që hapi i pari për të rritur sigurinë e furnizimit me energji dhe për trajtimin serioz të qëndrueshmërisë mjedisore të jetë marrja e masave për zbatimin e politikave për rritjen e efikasitetit të energjisë në çdo vend. Të 25 rekomandimet, të cilat mbulojnë çështjet: 1) ndërsektorale, 2) të ndërtesave, 3) të pajisjeve, 4) të ndriçimit, 5) të transportit 6) të industrisë dhe 7) të furnizimit me energji synojnë të kursejnë sasi të mëdha energjie me kosto të ulët, të adresojnë defektet e pengesat në treg, të adresojnë mungesat në politikat ekzistuese dhe të nxisin zbatimin e gjerë të tyre.

⁷ IEA, Energy Efficiency Policy Recommendations

3.2 Vështrim mbi zhvillimin makroekonomik të vendit

Gjatë vitit 2009 duke patur në konsideratë krizën e përgjithshme financiare globale, ecuria e ekonomisë shqiptare është karakterizuar nga zhvillime të pranueshme, megjithë rënien e konsiderueshme të disa treguesve kryesore ekonomike e sociale. Ritmet e rritjes ekonomike kanë qenë të mira gjatë vitit dhe niveli i rritjes është regjistruar 4.9 përqind, duke pasqyruar prirje negative si pasojë e uljes së kreditimit të ekonomisë, pakësimit të dërgesave në para të emigranteve dhe pakësimit të konsumit. Në vend rritja ekonomike u ngadalësua si pasojë e pakësimit të kërkesës së brendshme dhe të jashtme e shoqëruar më masa shtrënguese në ofrimin e likuiditetit dhe në pakësimit e hyrjeve valutore⁸.

Ekonomia shqiptare karakterizohet nga një sektor shërbimi në rritje, një sektor bujqësor në rënie dhe një sektor industrial i fokusuar kryesisht në prodhimin e veshjeve e të këpucëve.⁹ Rritja ekonomike u mbështet nga rritja e kënaqshme e sektorit të shërbimeve dhe të bujqësisë. Veçori tjetër karakteristike, e cila konsiderohet jo pozitive është se ritmi i rritjes së ekonomisë nuk shoqërohet me rritje të punësimit, dhe në tre vitet e fundit niveli i rritjes është vetëm 0.6 përqind. Çmimet e konsumit të përgjithshëm ruajtën një qëndrueshmëri të mirë. Norma mesatare e inflacionit arriti në 3.5 përqind. Ndikim të madh në inflacion pati rritja e çmimeve të produkteve ushqimore dhe naftës në tregjet ndërkombëtare dhe rritja e çmimit të energjisë në vend. Përkeqësimi i treguesve shënohet gjatë viteve 2008 dhe 2009 si në punësim, kursin e këmbimit, të ardhurat tatimore dhe në rritjen borxhit publik. Në Pasqyrën 1 poshtë, jepen të dhënat kryesore makroekonomike të vendit.

Pasqyra 1 - Treguesit makroekonomike				
Treguesit	2007	2008	2009	Ndryshimi % 2007-2009
Norma e rritjes së PBB	6%	7.8%	4.9%	-1.1%
PBB (USD Milionë)	10,693	12,966	12,035	12.6%
PBB për fryme (USD)	3,394	4,073	3,765	10.9%
Norma e papunësisë	13.5%	13.2%	12.8%	-0.7%
Punësimi	966,000	974,000	972,000	0.6%
Norma e inflacionit	3.10%	2.20%	3.50%	0.4%
Volumi i eksporteve (€Milionë)	786	917	751	-4.5%
Volumi i importeve (€Bilionë)	2,890.0	3,349.0	3,054.0	5.7%
Kursi i këmbimit (€/Lek)	123.6	122.8	132	6.8%
Të ardhurat tatimore (Lek Milion)	228,164	264,421	270,600	18.6%
Borxhi publik (% PBB)	53.50%	54.80%	59.50%	6.0%

Burimi: BSH 2010


Në fund të vitit 2009 numri i përgjithshme i NVM-ve në Shqipëri arriti në 106,477¹⁰, dhe pas ritmeve të larta të rritjes në vitet e fundit në rreth 20 përqind, vitin e fundit rritja është ndalur në 2 përqind, më një numër ndërmarrjesh vetëm 1,727 NVM, Grafiku 1, poshtë. Ndër faktorët që kanë ndikuar ndjeshëm në ritmet e larta të krijimit të ndërmarrjeve të reja besohet se kanë qenë reformat rregullatore të favorshme si regjistrimi dhe licencimi i shpejtë, ulja e taksave për biznesin e vogël, rritja e të ardhurave nga dërgesat në para të emigranteve, nga turizmi dhe nga eksporti. Ndërsa rënia e rritjes së NVM-ve në 2009 është pasojë e shumë faktorëve, të cilët lidhen me krizën ekonomike globale më pasojë direkte në pakësimin e eksporteve, të investimeve të huaja direkte dhe të dërgesave në para si edhe në financimet e shtuara e të përqendruara

⁸ BSH, Raporti Vjetor 2010

⁹ WTO, Albania Trade Policy Review 2010


¹⁰ INSTAT, Regjistri i Ndërmarrjeve Ekonomike 2010

në investimet në infrastrukture rrugore. Programet qeveritare për të mbështetur NVM-të gjatë vitit 2009 munguan tërësisht, në kontrast me mbështetjen që japin qeveritë e ndryshme europiane për të mbështetur mbijetesën e NVM-ve në kohë krize.



Burimi: INSTAT 2010

Në Shqipëri sipas të dhënave të fundvitit 2009, shumica e ndërmarrjeve është regjistruar si person fizik 80 përqind dhe si person juridik 20 përqind e tyre. Në grupin e ndërmarrjeve prodhuese janë 16,164 ose 15 përqind, ndërsa në grupin e ndërmarrjeve të shërbimit janë 90,313 ose 85 përqind. Sipas degëve kryesore të fushës së prodhimit dhe të shërbimeve NVM-të janë paraqitur në Grafikon 4 poshtë. Në sektorin e industrisë operojnë 9,939 ndërmarrje ose 9.3 përqind, në sektorin e ndërtimit 4,942 ose 4.6 përqind dhe në atë të bujqësisë e peshkimit 1,283 ose 1.2 përqind të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve.



Burimi: INSTAT 2010

Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve, 2,336 janë në pronësi ose bashkëpronësi shqiptare e të huaj, ndërsa numri i ndërmarrjeve publike është 1,041. Sipas përkufizimit të EU shumica e ndërmarrjeve në Shqipëri janë mikrondërmarrje me punësim deri në nëntë punonjës, të cilat përbejnë 96 përqind të ndërmarrjeve, të vogla me punësim nga 10 deri në 49 punonjës janë 3 përqind dhe ndërmarrje të mesme vetëm 1 përqind, për të cilat numri i punonjësve është nga 50 deri në 249.

Ndërmarrjet e vogla e të mesme janë përqendruar kryesisht në qarqet e Tiranës e të Durrësit ku operojnë rreth 50 përqind e ndërmarrjeve. Në qarqet ku projekti PEPSME zbatohet operojnë gjithsej 2005 ndërmarrje prodhuese, nga të cilat respektivisht 497 ndërmarrje prodhuese në Berat, 938 në Fier dhe 570 në Shkodër.

Pasqyra 2 - Shpërndarja e NVM-ve sipas qarqeve 2009		
Qarku/ NVM	Numri i NVM-ve	Përqindja %
Berati	4,146	3.9%
Dibra	1,945	1.8%
Durrësi	12,609	11.8%
Elbasani	7,095	6.7%
Fieri	9,435	8.9%
Gjirokastra	3,008	2.8%
Korça	7,812	7.3%
Kukësi	981	0.9%
Lezha	2,990	2.8%
Shkodra	6,483	6.1%
Tirana	41,007	38.5%
Vlora	8,966	8.4%
Gjithsej	106,477	100.0%

Burimi: INSTAT 2010

IV Vështrim mbi performancën mjedisore të NVM-ve në Shqipëri

Mbështetur në Raportin e Progresit të EU 2009, në Shqipëri u shënua progres në fushën e zhvillimit të NVM-ve gjatë vitit 2008. Zbatimi i Kartës Europiane për Ndërmarrjet e Vogla ka përmirësuar në përgjithësi klimën e biznesit dhe në veçanti regjistrimin e ndërmarrjeve, reformën rregullatore, lehtësitë për financim dhe nxitjen e eksportit. Megjithatë përpjekje të mëtejshme kërkohen lidhur me zhvillimin e kapitalit njerëzor, të konkureshmërisë dhe të kapaciteteve teknologjike të NVM-ve¹¹.

Në qershor 2008, EC miratoi Aktin për Biznesin e Vogël (SBA), i cili përbën detyrim për të gjithë vendet e EU për ta zbatuar plotësisht dhe shpejt. SBA synon të përmirësojë qëndrimin e përgjithshëm ndaj sipërmarrjes, të lidhë në mënyrë të pakthyeshme parimin "think small first" me politikëbërjen që nga legjislati deri në shërbimin publik dhe të promovojë rritjen e NVM-ve duke ndihmuar në trajtimin e problemeve të mbetura, të cilat pengojnë zhvillimin e tyre. SBA është një paketë legjislative prej dhjetë parimesh, të cilat duhet të drejtojnë konceptimin dhe zbatimin e politikave si në nivel të EU ashtu edhe në nivel kombëtar. Paketa përmban masa të reja ambicioze dhe konkrete duke përfshirë katër propozime legjislative të cilat i shndërrojnë këto parime në mjete për veprim në vendet e EU. SBA përmban një parim të rëndësishëm, i cili lidh veprimtaritë biznesore me çështjet e mjedisit. Në parimin nr. 9, theksohet aftësimi i NVM-ve për ti shndërruar sfidat mjedisore në mundësi biznesi dhe zhvillimi.

Në Shqipëri ndërmarrjet që shkaktojnë më shumë ndotje janë ato të industrisë së rëndë si psh. fabrikat e çimentos, fabrikat e metalurgjisë dhe pasurimit të mineraleve, fabrikat e përpunimit të lëkurës, ndërmarrjet e prodhimit të materialeve të ndërtimit, punishtet e veshjes së gomave dhe ndërmarrjet e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës. Shqetësim paraqesin edhe fabrikat e ndryshme të prodhimit, të cilat përdorin nënprodukte të naftës të cilat janë shumë ndotëse si psh. mazut, solar dhe qymyr. Në ndërmarrjet e agropërpunimit çështje shqetsuese janë trajtimi i pastandardizuar i mbetjeve nga ndërmarrjet e përpunimit të qumështit, të përpunimit të mishit e peshkut, prodhimit të vajit, ndërmarrjeve të prodhimit të vezëve dhe rritjes së shpendëve.

Gjatë viteve të fundit shumë pak përparim është bërë në drejtim të përmirësimit të cilësisë së ajrit. Megjithëse monitorimi i cilësisë së ajrit në qytetet kryesore vazhdon të

¹¹ EU, Albania Progress Report 2009

kryhet, metodologjia dhe pajisjet që përdoren nuk janë moderne. Në vend ka zona me ndotje të lartë të ajrit në veçanti përsa i përket grimcave PM₁₀, ku kontribues kryesor janë NVM-të, dhe aktualisht në vend nuk ka politika specifike për të pakësuar ndotjen e ajrit dhe shkarkimet e gazta nga automjetet dhe industria. Në vend nuk publikohen ende inventarët e shkarkimeve në ajër bazuar në metodologjitë e njohura. Kryesisht monitorimi i ajrit bëhet në vende publike dhe ende nuk ka ndonjë interesim për të kryer monitorime në mjediset private dhe në atë të ndërmarrjeve, të cilat njihet si ndotëse të mëdha. Ministria e Mjedisit së bashku me Ministrinë e Shëndetsisë ende nuk kanë adoptuar dhe zbatuar standarde europiane të cilësisë së ajrit dhe standardet e shkarkimeve në ajër për burimet e palëvizshme¹². Në vitin 2008 janë vendosur pajisje matëse elektronike regjistruese të ajrit në Tiranë dhe Elbasan të cilët rritin saktësinë e matjeve, frekuencën, cilësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të matjes. Monitorimi i cilësisë së ajrit urban kryhet për gjashtë treguesit kryesorë të cilët janë: PM₁₀, LNP, NO₂, SO₂, O₃ dhe Pb. Treguesit mesatare kombëtare të LNP dhe PM₁₀ rezultojnë të lartë jo vetëm ndaj normave shqiptare por edhe ndaj normave standarde të WHO. Në Pasqyrën 3 poshtë jepen treguesit vjetorë të ajrit në pesë qarqe të vendit¹³.

Vendi i Matjes	LNP	PM10	NO ₂	SO ₂	O ₃	Pb
Tirana	138	68	34	18	42	0.06
Elbasani	145	57	22	9	46	0.06
Shkodra	228	108	28	16	68	0.24
Durrësi	234	116	35	18	64	0.27
Fieri	238	112	33	32	70	0.32
Vlera Mesatare	197	92	30	19	58	0.19
Standardi Shqiptar	140	70	60	60	65	1
Standardi WHO	80	50	40	50	65	0.5

Burimi: MMPAU 2010

Legjislacioni aktual i EU kufizon shkarkimet atmosferike dhe vendos rregulla për cilësinë e ajrit. Në të janë vendosur standarde për kufizimin e shkarkimeve në impiantet industriale, për kufizimin ndotjes prej automjeteve, për adoptimin e teknikave më të mira të disponueshme për të kufizuar nivelet e shkarkimeve. Kërkesat europiane për cilësinë e ajrit kufizojnë nivelet e 12 ndotësve të ambientit¹⁴.

Gjendja e tanishme e përdorimit të burimeve ujore në vend është vështirë të vlerësohet për shkak të monitorimit të pamjaftueshëm dhe ndryshimeve të mëdha në veprimtaritë bujqësore, minerare dhe industriale si edhe për shkak të migracionit të brendshëm të popullsisë. Në përgjithësi, bujqësia dhe minierat përdorin ujërat sipërfaqorë ndërsa familjet dhe sektori industrial e ushqimor përdorin ujin e rrjetit të ujësjellësve urbanë. Sidoqoftë për shkak të amortizimit të rrjetit të ujësjellësve në qytetet kryesore siguria dhe cilësia e ujit të pijshëm nuk janë të garantuar. Po kështu gjendja e trajtimit të ujrave të zeza në zonat urbane është kritike. Në këto zona vetëm 40 përqind e banesave dhe ndërtesave është e lidhur me rrjetet e kanalizimeve të ujrave të zeza. Kjo gjendje reflektohet dhe në sektorin e ndërmarrjeve. Asnjë ndërmarrje në vend nuk ka impiant të trajtimit të ujrave të ndotur. Në rastin me të mirë ndërtesat e ndërmarrjeve dhe shtëpitë janë të pajisura me gropa septike. Gjendje kritike është krijuar në disa nga zonat bregdetare të vendit ku ngarkesa e ndërtimeve dhe për pasojë numri i lartë i banorëve

¹² UNECE, Albania Environmental Performance Review 2002

¹³ AMP, Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2008

¹⁴ EEA, Environmental trends and perspectives in the Western Balkan 2010

tejkalon standardet urbane ndërkombëtare sidomos në periudhën e pushimeve të verës. Uji i përdorur në përgjithësi në industri shkarkohet në mënyre të pakontrolluar dhe ndotë ujërat nëntokësore dhe tokën.

Monitorimi i ujrave sipërfaqore dhe nëntokësore realizohet duke matur 18 tregues fiziko kimike si psh: pH, kripësia, O₂ i tretur, NO₂, NH₄, PO₄, Cd, Hg, Pb etj. Monitorimet për matjet e gjendjes së ujrave lumore, liqenore e detare kryhen në rreth 100 vend matjeje. Në Raportin Vjetor 2008 të MM për cilësinë e ujrave nuk jepen të dhëna konkrete për nivelet e ndotjeve të ujrave në zonat që konsiderohen shqetsuese, por theksohet që cilësia e ujrave në vend përafrohet deri në 90 përqind sipas standardeve të WHO dhe UNEP dhe vetëm 10 përqind rezultojn jashtë standardeve. Për ujërat nëntokësore është gjetur së niveli i ndotjeve të tyre është brenda normave të lejuara.

Ndikimi i veprimtarive të ndërmarrjeve industriale në mjedis është i lartë i krahasuar me prodhimtarinë e tyre. Është vlerësuar së shkarkimet e CO₂ për njësi të PBB janë shumë më të larta se të vendeve të industrializuara. Një kontribut të madh në prodhimin e shtuar të gazeve ndotës japin ndërmarrjet e vogla e të mesme të cilat përdorin teknologji të vjetruara, përdorin karburante të cilësisë së ulët, përdorin automjete të vjetruar, nuk kanë instaluar pajisje për pakësim dhe kontrollin e ndotëseve të gazte të lënget e të ngurtë. Në përgjithësi ndërmarrjet shqiptare nuk përcaktojnë normativat e konsumit të lendeve të para dhe të materialeve në mënyre që të marrin masa për përdorimin optimal e eficient të tyre. Shumë pak ndërmarrjet shqiptare zbatojnë procese teknologjike të cilat riciklojnë ose ripërdorin produktet me defekte ose nënproduktet¹⁵.

Në vend, shërbimet e domosdoshme për NVM-të si furnizimi me ujë, shkarkimet e ujrave të përdorura, grumbullimi i mbetjeve varen nga shërbimet që ofrohen nga pushteti vendor dmth. bashkitë dhe komunat. Këto shërbime aktualisht janë joeficiente dhe jociësore dhe realizimi i një partneriteti publik private për këto çështje mbetet një alternative e pashfrytëzuar plotësisht.

Përsa i përket performancës së NVM-ve në lidhje me përdorimin eficient të energjisë ende nuk ka vlerësime të plota të kësaj çështje jo vetëm nga pronaret dhe menaxheret e ndërmarrjeve por edhe nga institucionet përgjegjëse. Është fakt i njohur që NVM-të në Shqipëri si burim kryesor të energjisë përdorin energjinë elektrike, vetëm në rastet e ndërprerjes së saj ata mund të përdorin burime të tjera si gjeneratorët me naftë ose me gaz. Njohja e standardeve dhe normativave në fushën e përdorimit të energjisë për ndërmarrjet e prodhimit është në nivel shumë të ulët dhe është e vështirë të vlerësohet konsumi i energjisë për njësi prodhimi në ndërmarrjet shqiptare. Përdorimi eficient i energjisë ende nuk konsiderohet si komponent i rëndësishëm i aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve shqiptare. Për zbatimin e Ligjit 9379/2005 "Për Efiçencën e Energjisë" është bërë fare pak progres¹⁶, po kështu edhe në rishikimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë. Investime kanë nisur të bëhen në fushën e energjisë së rinovueshme si nga era dhe biomasa si edhe në ndërtimin e hidrocentraleve të mëdhenj e të vegjël.

¹⁵ MM, Strategjia Sektorale e Mjedisit 2007

¹⁶ EU, Albania Progress Report 2009

V Kuadri ligjor për NVM-të në lidhje me mjedisin

Legjislacioni për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri është relativisht i ri. Para viteve 1990 legjislacioni ishte i mangët dhe njohuritë për mbrojtjen e mjedisit ishin të pakta. Pas vendosjes së sistemit demokratik dhe shprehjes së dëshirës së shqiptareve për tu integruar në Europë nisën të hartoheshin dhe të zbatoheshin programe e projekte të shumta nga institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat përveç çështjeve të tjera si forcimi i shtetit demokratik e ligjor, ngritja e institucioneve të reja shqiptare, hartimi i legjislacionit të ri, mbrojtja e të drejtave të njeriut, përmirësimi i klimës së biznesit përfshinin edhe ato të mbrojtjes së mjedisit. Institucione të tilla si Bashkimi Europian, Banka Botërore, PNUD dhe organizatat e zhvillimit dypalësh si USAID, DFID, Cooperazione Italiana, BUZA, CIDA, REC, SIDA, OSFA kanë dhënë një kontribut të çmuar në hartimin e legjislacionit shqiptar të mjedisit dhe ngritjen e forcimit të institucioneve për mbrojtjen e mjedisit. Hapa fillestare janë bërë edhe në fushën e legjislacionit për efikasitetin në përdorimin e energjisë në kodin e energjisë për ndërtesat dhe etiketimin e produkteve elektrike.

Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e mjedisit mbështetet kryesisht në Direktivat e BE dhe në Konventat Ndërkombëtare të Mjedisit. Një pjesë e mirë e këtij legjislacioni mbulon pjesërisht dhe plotësisht veprimtaritë ekonomike të ndërmarrjeve në vend. Mqs. aktet ligjore të fushës së mjedisit datojnë që në vitin 1992 dhe janë të shumta do të mundohemi të diskutojmë vetëm për ato ligje dhe akte të cilat prekin direkt ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në lidhje me sjelljen, qëndrimin dhe detyrimet e tyre ndaj mjedisit.

5.1 Legjislacioni europian për mjedisin i zbatueshëm nga biznesi

Legjislacioni europian i zbatueshëm për NVM-të përmbledhet në disa prej direktivave kryesore të EC. Në Pasqyrën 4, në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur Direktivat kryesore.

Pasqyra 4–Direktivat Europiane për mjedisin dhe energjinë të zbatueshme nga NVM-të

Direktivat	Emërtimi	Qëllimet
I – Direktivat për Ujin		
Direktiva 76/464/EU	Direktiva për ndotjen të shkaktuar nga disa lëndë të rrezikshme të shkarkuara në mjedisin ujor nëntokësor të vendeve të EU.	Direktiva ka për qëllim që vendet anëtare të EU të parandalojnë dhe të kontrollojnë lëndet ndotëse të cilat derdhen në ujërat nëntokësore, të cilat janë përfshirë në dy lista. Kjo Direktivë përcakton vlerat kufitare për shkarkimet dhe objektiva të cilësisë së mjedisit ujor për 18 lëndë. Qëllimi i direktivës është që vendet anëtare të EU të zhdukin ndotjen nga lista I e lëndëve dhe të pakësojnë ndotjen nga lista II e lëndëve ndotëse. Ndotësit janë përzgjedhur mbi bazën e qëndrueshmërisë, toksicitetit dhe bioakumulimit. Në listën e parë përfshihen lëndë halogjenike, fosforike, përbërës të kadmiumit, merkurit, vajrave minerale.
Direktiva 80/68/EU	Direktiva për mbrojtjen e ujrave nëntokësore nga ndotja e shkaktuar nga disa lëndet e rrezikshme	Ky akt ka si qëllim parandalimin e shkarkimeve në ujërat nëntokësore të lëndëve të rrezikshme që përfshihen në të dy listat e përgatitura të lendeve të rrezikshme si edhe kontrolli dhe zhdukja e pasojave në rastet kur ndotja ka ndodhur.
Direktiva 91/271/EU	Direktiva për trajtimin e ujrave të përdorur urbanë	Ky akt ka si qëllim të mbroje mjedisin nga efektet negative të shkarkimeve të lëngëta nga industria dhe ujërat e përdorura urbane si edhe përcaktimin e udhëzimeve për grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin e ujrave të përdorur. Direktiva udhëzon edhe trajtimin e ujrave të përdoren në disa lloje industrish.
II - Direktivat për lëndët dhe produktet kimike		
Direktiva 67/548/EU	Direktiva për përafrimin e legjislacionit në lidhje me	Akti ka për qëllim të udhëzojë vendet anëtare të EU për të përafruar legjislacionin në fushën e klasifikimit,

	Klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e lëndëve të rrezikshme.	paketimit dhe etiketimit të lëndëve të rrezikshme të cilat tregtohen në tregjet e vendeve të EU. Kjo direktivë nuk mbulon ilaçet, lëndet narkotike dhe municionet. Gjithashtu kjo direktivë nuk mbulon çështje të transportit të lëndëve të rrezikshme.
Direktiva 76/769/EU	Direktiva për kufizimin në marketingun dhe përdorimin e disa substancave të rrezikshme.	Ky akt ligjor ka për qëllim përafrimin e legjislacionit kombëtar në lidhje me kufizimin e marketingun dhe përdorimin e disa substancave të rrezikshme dhe preparateve si bojëra, llaqe, solucione tretëse etj
Direktiva 88/379/EU	Direktiva për përafrimin e legjislacionit në lidhje me klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e preparateve të rrezikshme.	Ky akt ligjor ka për qëllim përafrimin e ligjeve në lidhje me marketingun dhe përdorimin e preparateve të rrezikshme.
Direktiva 87/217/EU	Direktiva për parandalimin dhe pakësimin e ndotjeve nga asbesti.	Ky akt ka për qëllim të pakësojë dhe parandalojë ndotjet nga asbesti, i përdorur në disa forma si asbest i bardhe, i kaftë dhe blu. Në këtë rast direktiva përfshin rastet e prodhimit dhe përdorimit të asbestit për qëllime të ndryshme.
III – Direktivat europiane për mbetjet		
Direktiva 75/439/EU	Direktiva për depozitimin e vajrave të përdorur	Akti ligjor ka për qëllim të përcaktojë procedurat që duhen përgatitur për grumbullimin dhe depozitimin e padëmshëm të vajrave të përdorur.
Direktiva 75/442/EU	Direktiva për mbetjet	Akti ligjor ka si qëllim nxitjen për parandalimin, përpunimin dhe riciklimin e mbetjeve, të përcaktojë procedurat për depozitimin e padëmshëm të mbetjeve dhe të sigurojë një sistem për lëshimin e autorizimeve për depozitimin e mbetjeve.
Direktiva 91/689/EU	Direktiva për mbetjet e rrezikshme.	Qëllimi i direktivës është të përafrojë legjislacionin e vendeve të EU në lidhje me menaxhimin e kontrolluar të mbetjeve të rrezikshme. Direktiva kërkon që të gjitha depozitimet e mbetjeve të rrezikshme të regjistrohen dhe identifikohen si edhe mbetjet e rrezikshme të mos përzihen më njëra tjetrën ose me mbetje të parrezikshme.
Direktiva 94/62/EU	Direktiva për materialet ambalazhues dhe paketimin e mbetjeve	Kjo direktivë synon harmonizimin e masave kombëtare të vendeve të EU në lidhje me paketimin, pakësimin e vëllimit të përgjithshëm dhe ndikimit të mbetjeve në mjedis. Direktiva përcakton masat për parandalimin e prodhimit të materialeve për paketimin, ripërdorimin e tyre dhe reduktimin e depozitimit të tyre.
Direktiva 2008/01/EC	Direktiva për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes	Qëllimi i Direktivës është arritja e parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes nga disa veprimtari të përfshira në Aneksin I të Direktivës, të cilat konsiderohen shumë ndotëse. Në Direktivë përcaktohen masat për të parandaluar ose në rastet ku kjo nuk është praktike të pakësohen shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë nga këto veprimtari biznesore. Direktiva kërkon që veprimtari të përcaktuara industriale dhe bujqësore me ndotje të larte të pajisjen me leje mjedisore. Leja mund të lëshohet vetëm nëse disa kushte mjedisore plotësohen, kështu që kompanitë mbajnë përgjegjësi vete për parandalimin dhe pakësimin e çdo ndotjeje që mund të shkaktojë.
IV – Direktivat të përgjithshme		
Direktiva 85/337/EU	Direktiva për vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike e private në mjedis	Kjo direktivë ka për qëllim të krijojë bazën ligjore për vlerësimin e ndikimit në mjedis të disa projekteve private e publike. Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të identifikojë, përshkruajë dhe vlerësojë në mënyrë të përshtatshme në çdo projekt efektet direkte dhe indirekte të projektit në faktorët që vijnë si psh: njerëzit, florën dhe faunën, token, ujin, ajrin, klimën, relievin, vlerat materiale dhe kulturore, ndërveprimin midis faktorëve të mësipërm.

V – Direktivat për energjinë në lidhje me NVM-të		
Direktiva 2006/32/EU	Direktiva për efikasitetin e energjisë në përdoruesit përfundimtarë dhe shërbimet e energjisë	Qëllimi i Direktivës është të zgjerojë përmirësimet me kosto të ulët të efikasitetit të energjisë në përdorim përfundimtar nëpërmjet: (a) përcaktimit të treguesve të nevojshëm si edhe të mekanizmave, stimuljeve, dhe kuadrit institucional, financiar dhe ligjor për të hequr pengesat dhe mangësitë ekzistuese të tregut, të cilat pengojnë përdorimin eficient përfundimtar të energjisë; (b) krijimit të kushteve për zhvillimin dhe promovimin e tregut për shërbimet e energjisë dhe për ofrimin e masave të tjera për përmirësimin e efikasitetit të energjisë tek konsumatorët përfundimtarë.
Direktiva 2010/31/EU	Direktiva për performancën e energjisë në ndërtesa	Objektivi i Direktivës së rishikuar është të promovojë përmirësimin e performancës së energjisë në ndërtesa duke marrë në konsideratë kushtet e jashtme klimatike, si edhe kërkesat klimatike të brendshme dhe efektivitetin e koston. Direktiva përcakton kërkesat në lidhje me: (a) kuadrin e përgjithshëm për metodologjinë e llogaritjes së performancës së integruar të energjisë në ndërtesa; (b) zbatimin e kërkesave minimale për performancën e energjisë në ndërtesat e reja dhe atyre që rinovohen; (c) certifikimin e përdorimit të energjisë në ndërtesa; (d) inspektimet e rregullta të sistemeve të klimatizimit të ajrit dhe ngrohësve të ujit si edhe termoizolimit.
Direktiva 2009/28/EU	Direktiva për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtitshme	Kjo Direktivë ndërton një kuadër të përbashkët për promovimin e energjisë nga burime të rinovueshme. Ajo vendos objektiva të detyrueshëm kombëtare për pjesën e përgjithshme të energjisë nga burime të rinovueshme në konsumin përfundimtar të energjisë dhe për pjesën e energjisë nga burime të rinovueshme në transport. Ajo vendos rregulla për projektet e përbashkëta, për garancitë e origjinës, procedurat administrative, informacionin dhe trainimet, dhe për të drejtën për të shfrytëzuar rrjetet e elektricitetit nga burimet e rinovueshme. Direktiva përcakton kritere të qëndrueshmërisë për biokarburantet.
Direktiva 2010/30/EU	Direktiva për tregimin më anë të etiketimit dhe të informacionit standard të produktit të konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve që konsumojnë energji.	Kjo Direktivë krijon një kuadër ligjor për harmonizimin e masave kombëtare për informimin e përdoruesve të fundit, veçanërisht më anë të etiketimit dhe informacionit standard të produktit në lidhje me konsumin e energjisë. Kjo Direktivë do të zbatohet për produktet që kanë lidhje me konsumin e energjisë të cilat kanë ndikim direkt dhe indirekt të rëndësishëm në konsumin e energjisë.

5.2 Legjislacioni shqiptar për mjedisin i zbatueshëm për biznesin

Legjislacioni shqiptar për mjedisin dhe eficientë energjisë është relativisht i ri. Ligjet e para për mbrojtjen e mjedisit janë hartuar gjatë viteve 1992-1995 dhe rishikuar dhe rivlerësuar mbas vitit 2000. Në përgjithësi kuadri ligjor shqiptar në fushën e mbrojtjes së mjedisit është krijuar duke transpozuar një pjesë ose tërësisht legjislacioni evropian – direktivat ose legjislacionin mjedisor të disa vendeve të Europës në legjislacioni shqiptar. Ky legjislacion mbulon në përgjithësi të katër komponentët e mjedisit si psh.: tokën, ujin, ajrin dhe biodiversitetin. Hapa të mirë janë bërë në legjislacionin për mbetjet, ndërsa legjislacioni për eficientë e energjisë kërkon përmirësime dhe plotësime të domosdoshme. Më poshtë po japim një përmbledhje dhe komentet përkatëse të legjislacionit shqiptar të fushës së mjedisit e të eficientës në përdorimin e energjisë të zbatueshme nga NVM-të.

Pasqyra 5 – Legjislacioni shqiptar për mjedisin i zbatueshëm nga NVM-të

Ligji	Emërtimi	Qëllimet
I – Ligjet për Ujin		
Ligji Nr. 9115 /2003	Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotura	<p>Ky ligj ka për qëllim të mbrojtë mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga ndikimet negative të ujërave të ndotura, duke përcaktuar rregullat e trajtimit mjedisor të tyre si dhe detyrimet e shkarkuesve të ujërave të ndotura. Personat fizikë e juridikë, veprimtaria e të cilëve prodhon e shkarkon ujëra të ndotura, detyrohen të marrin masat që vijnë:</p> <p>a) të ulin në vijimësi sasinë e ujërave të përdorur, që shkarkojnë në mjedisin pritës;</p> <p>b) të pakësojnë shkallën e ndotjes së ujërave që shkarkojnë, sidomos të mbetjeve të rrezikshme;</p> <p>c) të trajtojnë ujërat e ndotura nëpërmjet: 1) ndërtimit dhe funksionimit të sistemit të kanalizimeve të brendshme; 2) ndërtimit dhe funksionimit të impiantit të trajtimit të ujërave të përdorura, sipas degës së industrisë, 3) ndërtimit dhe funksionimit të rrjetit të kanalizimeve për largimin e ujërave industriale deri në kolektor; 4) nxitjes së ripërdorimit të dobishëm të ujërave të trajtuara; 5) trajtimit të llumrave dhe të lëndëve të ngurta, që dalin nga impiantet e trajtimit, sipas kërkesave dhe kushteve të vendosura në lejen mjedisore; 6) zbatimit të normave të lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe të teknologjive bashkëkohore të trajtimit të ujërave të ndotura.</p> <p>Në normat e lejuara të shkarkimeve të lëngshme përfshihen: 1) normat e lejuara të shkarkimeve industriale; 2) normat e lejuara të shkarkimeve të zonave industriale; 3) normat e lejuara të një procesi të çfarëdollojshëm; 4) normat e lejuara të shkarkimeve urbane. Në lejen mjedisore që u jepet NVM-ve të cilat gjatë veprimtarive të tyre prodhojnë ujra të ndotura përcaktohen: 1) kushtet e veçanta për respektimin e normave të shkarkimeve të lëngshme në pajtim me llojin e veprimtarisë ekonomike; 2) kërkesat për ndërtimin dhe funksionimin e rrjetit të brendshëm të kanalizimeve; 3) kërkesat për trajtimin parësor të ujërave të përdorur; 4) masat për parandalimin e ndotjes së mjedisit prej ujërave të ndotur; 5) ndërtimi dhe funksionimi i kolektorit të ujërave të trajtuara 6) mbajtja e regjistrit të shkarkimeve; 7) kryerja e monitorimit dhe publikimi i rezultateve të tij. NVM-të janë të detyruar të kryejnë monitorimin e shkarkimeve të ujërave të ndotur vete ose me anë të një eksperti të licencuar për këtë qëllim.</p>
VKM 177/2005	Për Normat e Lejuara të Shkarkimeve të Lëngshme	<p>Ky Vendim i Këshillit të Ministrave synon të parandalojë, të kufizojë dhe të shmangë ndotjen e mjedisve pritëse nga substancat e rrezikshme që shkarkohen në to nëpërmjet ujërave të ndotur. Substancat e rrezikshme të lëngshme klasifikohen në bazë të toksicitetit, qëndrueshmërisë dhe bioakumulimit të tyre. Në Vendim janë përcaktuar normat e lejuara të shkarkimeve për substancat e rrezikshme të lëngshme sipas industrive si edhe mënyrat e monitorimit të ndotjes. Në vendim përcaktohen disa industri ku në industrinë ushqimore përfshihen: përpunimi i mishit, përpunimi i frutave e perimeve, prodhimi i vajrave bimore, përpunimi i qumështit, prodhimi i pijeve. Disa nga parametrat kryesore që monitorohen në industrinë ushqimore janë: pH, lëndët pezullore, BOD5, COD, nitrati total dhe</p>

		fosfati total.
Ligji Nr. 8905 /2002	Për Mbrojtjen e Mjedisit Detar nga Ndotja e Dëmtimi	<p>Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit detar të Republikës së Shqipërisë nga ndotjet e dëmtimet, parandalimin dhe shmangien e tyre, të shkaktuara nga veprimtaritë njerëzore në det e në zonën bregdetare, të cilat prishin cilësinë e ujit, dëmtojnë burimet e detit e të bregdetit, rrezikojnë faunën dhe florën, kërcënojnë shëndetin e njeriut, si dhe vështirësojnë zhvillimin normal të veprimtarive në këtë mjedis.</p> <p>Janë të detyruar të mbrojnë mjedisin detar dhe të zbatojnë dispozitat e këtij ligji: a) personat juridike e fizikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, që përdorin mjedisin detar ose ushtrojnë veprimtari të ndryshme në të; b) të gjitha veprimtaritë tregtare e industriale të instaluar në bregdet; c) çdo mjet lundrues, që ndodhet ose lundron në mjedisin detar; d) mjetet aeronautike që fluturojnë mbi mjedisin detar. Në bazë të këtij ligji përcaktohen lëndët të cilat ndalohen të depozitohen/hidhen në det si psh: lëndë halogjenike, përzierje të merkurit e kadmiumit, plastikë, karburante e lëndë radioaktive.</p>
II – Ligjet për Ajrin		
Ligji Nr. 8897 /2002	Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja	<p>Ligji synon të garantojë cilësi të mirë të ajrit për njerëzit, faunën, florën dhe ruaje vlerat natyrore e kulturore të mjedisit nga ndotja e ajrit. Në ligj përcaktohen burimet e lëvizshme dhe të palëvizshme të ndotjes dhe behet klasifikimi i tyre në burime të mëdhenj të mesëm dhe të vegjël mbi bazën e prodhimit termik nga 2 deri në 5 MW. Në ligj përcaktohen treguesit kryesore mjedisore të gjendjes së ajrit. Në ligj janë përcaktuar me hollësi detyrimet e operatoreve privatë për ruajtjen e pastërtisë së ajrit. Operatorët e burimeve të mëdha e të mesme të ndotjes janë të detyruar: a) të përdorin burimet vetëm sipas kushteve teknike të shprehura edhe në lejen mjedisore; b) të respektojnë normat e shkarkimeve në ajër, c) të përgatisin rregullore teknike për funksionimin e burimeve të ndotjes, d) të kryejnë monitorimin e shkarkimeve në ajër duke kufizuar vazhdimisht ndotjen.</p>
III - Ligjet për Lëndët dhe Produktet Kimike		
Ligji Nr. 9108 /2003	Për Substancat dhe Preparatet Kimike	<p>Qëllimi i ligjit është të rregullojë administrimin e substancave dhe të preparateve kimike për mbrojtjen e jetës, të shëndetit të njerëzve e të kafshëve si edhe të mbrojtjes së mjedisit. Objekti i ligjit është përcaktimi i të drejtave dhe i detyrimeve të NVM-ve për klasifikimin e substancave dhe të preparateve kimike si edhe të vetive të tyre, përcaktimi i procedurave për regjistrimin, inventarizimin, njoftimin, menaxhimin dhe tregtimin e tyre. Në ligj përcaktohen 15 vetitë më të rrezikshme të substancave kimike. Të gjitha substancat kimike që hidhen në treg do të klasifikohen mbi bazën e vetive të rrezikshme. Testimi i substancave kimike bëhet në laboratorë të akredituar. Të gjitha substancat kimike të prodhuara ose të importuara regjistrohen nga kompania në Ministrinë përkatëse. NVM-të që kryejnë veprimtari tregtare e prodhuese lejohen të menaxhojnë substancat dhe preparatet kimike të klasifikuara të rrezikshme vetëm pasi marrin autorizimin nga Ministria përkatëse. Në lidhje me mbikëqyrjen e substancave kimike detyra të veçanta kanë Inspektorati i Mjedisit, Inspektorati Shëndesor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.</p>
IV - Ligjet për Mbetjet		
Ligji Nr. 9010 /2003	Për Administrimin Mjedisor të Mbetjeve të Ngurta	<p>Ky ligj synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre që nga krijimi, grumbullimi, ndarja, ruajtja, transporti, riciklimi, përpunimi dhe asgjësimi. Të gjitha këto procese synojnë në pakësimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të dëmshme. Objekt i këtij ligji janë: 1) mbetjet urbane, 2) mbetjet industriale, 3) mbetjet spitalore, 4) mbetjet e ndërtimit, 4) mbetjet e kanalizimeve, 5) mbetjet bujqësore e blegtorale. Subjekt i këtij ligji janë të gjithë personat fizikë e juridike që krijojnë mbetje, përpunojnë mbetje dhe organet shtetërore përgjegjëse.</p> <p>Personat fizikë dhe juridikë, veprimtaria e të cilëve krijon mbetje, detyrohen: a) të ndërtojnë linja teknologjike për riciklimin dhe përpunimin e mbetjeve, në përputhje me teknologjinë, me natyrën dhe sasinë e mbetjeve që krijojnë; b) t'i ruajnë dhe t'i trajtojnë mbetjet që të mos vështirësojnë proceset pasuese të administrimit mjedisor të</p>

		<p>tyre; c) të ndajnë që në burim mbetjet në depozita të veçanta të dallueshme.</p> <p>Personat fizikë dhe juridikë, veprimtaritë e të cilëve krijojnë mbetje, si edhe NVM-të të pajisura me leje mjedisore për grumbullimin, transportimin, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve monitorojnë kryerjen e këtyre veprimtarive me shpenzimet e veta dhe publikojnë të dhënat çdo tre muaj.</p> <p>Inspektorati i Mjedisit kontrollon zbatimin e rregullave dhe të kërkesave për trajtimin dhe administrimin e mbetjeve dhe kushtet e vendosura në lejen mjedisore për çdo NVM.</p>
Ligji Nr. 9537 /2006	Për Administrimin e Mbetjeve të Rrezikshme	<p>Ligji synon përcaktimin e proceduarve për administrimin e sigurtë të mbetjeve të rrezikshme, grumbullimin, transportin, magazinimin e përkohshëm, përpunimin, trajtimin, asgjësimin, eksportimin dhe importimin e tyre. Administrimi i mbetjeve të rrezikshme kryhet: a) pa rrezikuar shëndetin e njeriut ose mjedisin, b) pa rrezikuar ndotjen e ujit, ajrit, tokës dhe biodiversitetit, c) pa shkakuar bezdi me anë të aromave dhe zhurmave, d) pa ndikuar negativisht në zonat urbane e rurale. Personat fizikë dhe juridikë të cilët prodhojnë ose menaxhojnë mbetjet e rrezikshme detyrohen të plotësojnë të gjitha kushtet dhe procedurat e paraqitura në këtë ligj. Në asnjë rast nuk lejohet përzierja e mbetjeve të ngurta me ato të rrezikshme.</p>
V - Ligjet e Përgjithshme për Mjedisin		
Ligji Nr. 8934 /2002	Për Mbrojtjen e Mjedisit	<p>Ligji për mbrojtjen mjedisit është ligji themelor në këtë fushë. Ai është një përmirësim i përgjithshëm i ligjit të vitit 1993. Nëpërmjet ligjit synohet të arrihen objektivat e mëposhtëm:</p> <p>a) përdorimi racional i mjedisit dhe kufizimi i shkarkimeve e i ndotjeve, parandalimi i dëmtimit të tij, rehabilitimi dhe shëndoshja e mjedisit të dëmtuar; b) përmirësimi i kushteve mjedisore që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut; c) ruajtja dhe mirëmbajtja e burimeve natyrore, të përtrishme dhe të papërtrishme, administrimi racional dhe i frytshëm i tyre; ç) bashkërendimi i veprimtarive shtetërore për të përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit; d) bashkëveprimi ndërkombëtar në fushën e mjedisit; dh) nxitja dhe pjesëmarrja e publikut në veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit; e) bashkërendimi për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit me kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm.</p> <p>Në ligj theksohet qartë se mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi është përparësi kombëtare dhe detyrim për të gjitha organet shtetërore, personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ligji përcakton parimet kryesore ndërkombëtare të mbrojtjes së mjedisit dhe komponentët kryesore të mbrojtjes së mjedisit. Në ligj përcaktohen përbërësit kryesore të mjedisit që merren në mbrojtje nga ligji si psh: toka, ajri, uji, biodiversiteti dhe administrimi i mbetjeve.</p> <p>Në ligj janë përkufizuar procedurat për dhënien e lejes mjedisore, procedurat e monitorimeve, detyrimet e përgjithshme të NVM-ve ndaj mbrojtjes së mjedisit, vlerësimi i ndikimit në mjedisi, institucionet që merren me kontrollin e mjedisit. Përgjegjësitë specifike të institucioneve më të larta të mbrojtjes së mjedisit, si psh. të Ministrisë së Mjedisit, ARM-ve dhe Inspektoratit i Mjedisit janë përcaktuar në këtë ligj. Detyra dhe detyrime të veçanta kanë qeveritë vendore dhe organizatat mjedisore.</p>
Ligji Nr. 8990/2003	Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis	<p>Ky ligj synon të sigurojë: a) vlerësimin e përgjithshëm, të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore të projekteve biznesore për të parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis; b) procesin e hapur të vlerësimit e të administruar me paanshmëri, nëpërmjet pjesëmarrjes së organeve qendrore e vendore, të publikut, të organizatave jofitimprurëse dhe të propozuesit të projektit.</p> <p>Ky ligj përcakton rregullat, procedurat, afatet, të drejtat dhe detyrat:</p> <p>a) për të identifikuar, saktësuar dhe vlerësuar ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të projektit në mjedisin ku ai do të zbatohet; b) për të krahasuar përparësitë dhe mangësitë e një projekti të propozuar në variante të tjera, të mundshme; c) për të siguruar shqyrtim cilësor</p>

		<p>teknik, profesional, juridik dhe administrativ të kërkesës dhe të marrjes së vendimit nga organet përkatëse. Në ligj janë përcaktuar projektet që do të nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis si edhe procedurat e përgatitjes dhe miratimit. Rol specifik në procedurat për vlerësimin e ndikimit në mjedis kanë ARM-të.</p> <p>Në ligj janë përcaktuar veprimtaritë ekonomike që i nënshtrohen procesit të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe veprimtaritë që i nënshtrohen procesit të përmbledhur të vlerësimit të ndikimit në mjedis.</p>
--	--	--

Në aspektin ligjor Shqipëria ka mangësi të mëdha në lidhje me përdorimin eficient të energjisë. Edhe ato ligje që janë miratuar zbatohen në një shkallë shumë të ulët ose aspak. Me poshtë po japim ligjet kryesore në fuqi të cilat lidhen me përdorimin eficient të energjisë.

Pasqyra 6 – Legjislacioni shqiptar për eficientë e energjisë

I - Ligjet e Përgjithshme për Eficientë e Energjisë		
Ligji	Emërtimi	Qëllimet
Ligji Nr. 8937 /2002	Për Ruajtjen e Nxehtësisë në Ndërtesa	<p>Ky ligj krijon bazën ligjore për vendosjen e rregullave dhe shpall detyrimin ligjor për projektuesit dhe ndërtuesit për marrjen e masave për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa. Projektimi dhe ndërtimi i ndërtesave do të behet duke respektuar parametrat teknike për ruajtjen, kursimin dhe përdorimin me eficientë të energjisë. Në të gjitha ndërtesat që do të ndërtohen do të respektohet koeficienti vëllimor e normativ i humbjeve termike, si dhe do të parashikohet vendosja e sistemit të ngrohjes qendrore ose vendore.</p> <p>Sipas ligjit, sistemet e prodhimit të nxehtësisë për ngrohjen dhe freskimin e ndërtesave projektohen për arritjen e temperaturës së ajrit të brendshëm sipas normave të komfortit njerëzor duke marrë parasysh kushtet klimatike dhe funksionale të ndërtesës. Në zbatim të këtij ligji është miratuar VKM 38/2003 "Për normat, rregullat, kushtet e projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa".</p>
Ligji Nr. 9379 /2005	Për Eficientë e Energjisë	<p>Ligji ka si qëllim nxitjen dhe përmirësimin e eficientës në përdorimin e energjisë që nga prodhimi deri në përdorim e konsumim. Në ligj përcaktohen objektivat kryesore që duhet të përmbajnë politikat publike e private në drejtim të rritjes së eficientës në përdorimin e energjisë. Në vijim ligji shpreh qëllimin për ngritjen e zyrave rajonale të energjisë në varësi të AKBN. Për çdo pajisje e makineri që tregtohet në vend duhet të këtë etiketa, të cilat tregojnë konsumin specifik të energjisë.</p> <p>Një seksion të rëndësishëm të ligjit e përben auditimi i energjisë; ky auditim është i detyrueshëm për NVM-të të cilat aplikojnë për financime nga Fondi për Eficientë e Energjisë. Fondi do të përdoret për qëllime të përcaktuara, të cilat kanë lidhje direkt me rritjen e eficientës në përdorimin e energjisë.</p>
Ligji 10113/2009	Për treguesit e konsumit të energjisë dhe të burimeve të tjera, nga pajisjet për përdorim shtëpiak nëpërmjet etiketimit dhe informacionin standard të produkteve	<p>Ky ligj përcakton detyrimet për publikimin e informacionit të konsumimit të energjisë dhe të burimeve të tjera kryesore, veçanërisht nëpërmjet mënyrave të etiketimit e të informacionit për produktin, si dhe informacionit plotësues, për disa tipa pajisjesh për përdorim shtëpiak, duke i mundësuar konsumatorit zgjedhjen e pajisjeve, për përdorim shtëpiak, më eficiente ndaj energjisë.</p> <p>Konsumatori informohet në lidhje me konsumin e energjisë elektrike, të formave të tjera të energjisë, burimeve të tjera kryesore dhe për informacione të tjera plotësuese, nëpërmjet një skede informative dhe një etikete për pajisjen për përdorim shtëpiak, të ofruar për shitje, dhënie me qira, shitje me këste ose të ekspozuar për përdoruesin e fundit.</p>

Pjesë e legjislacionit për rritjen e efikasitetit në përdorimin e energjisë janë edhe ligjet përkatëse sipas burimeve të energjisë si Ligji 7746/1993 "Për hidrokarburet", Ligji 9072/2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe Ligji 9946/2008 "Për sektorin e gazit natyror".

5.3 Marrëveshjet Ndërkombëtare për Mjedisin dhe Energjinë

Marrëveshjet Shumëpalëshe për Mjedisin (MEAs) ose Konventat Ndërkombëtare të Mjedisit gjatë zbatimit të tyre kanë përparësi ndaj legjislacionit kombëtar të çdo vendi. Shqipëria ka ratifikuar deri në fund të 2009, 20 konventa ndërkombëtare në fushën mjedisit e energjisë. Do të japim një përshkrim të shkurtër të konventave kryesore, të cilat kanë lidhje direkte e të dukshme me veprimtarinë biznesore.

Pasqyra 7 – MEAs të ratifikuara nga Shqipëria në lidhje me biznesin

Marrëveshjet Shumëpalëshe për Mjedisin		
Konventa	Emërtimi	Përshkrimi dhe Qëllimet
1. Konventa e Barcelonës 1976	Për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga Ndotja	Kjo është një konventë rajonale për të parandaluar dhe luftuar ndotjen nga anijet, avionët dhe burimet tokësore në Detin Mesdhe. Kjo përfshin dhe nuk kufizohet vetëm në grumbullimin, shkarkimet dhe rrjedhjet e mbetjeve të ndryshme në det. Qëllimi kryesor i Konventës së Barcelonës është të pakësojë ndotjen në Detin Mesdhe dhe të përmirësojë mjedisin detar në këtë zone duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm. Shqipëria ka ratifikuar këtë konventë në vitin 2000.
2. Konventa e Bazelit 1989	Për Kontrollin e Lëvizjeve Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe të Depozitimit të tyre	Qëllimi i kësaj konvente është të pakësojë lëvizjen e mbetjeve të rrezikshme midis vendeve dhe veçanërisht të parandalojë transferimin e mbetjeve të rrezikshme nga vendet e zhvilluara në vendet më pak të zhvilluara (LDCs). Kjo konventë synon gjithashtu të minimizojë sasinë e toksicitetit të mbetjeve të prodhuara, për të siguruar menaxhimin mjedisor të tyre sa më afër burimit të prodhimit të tyre dhe të ndihmojë LDCs për të realizuar menaxhim mjedisor të sigurtë të mbetjeve të rrezikshme dhe të mbetjeve të tjera. Shqipëria e ka ratifikuar këtë konventë në vitin 1997.
3. Konventa e Helsinkit 1992	Për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Rrjedhave Ujore Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare	E quajtur ndryshe Konventa për Ujin synon forcimin e masave vendore, kombëtare dhe rajonale brenda vendeve të rajonit të UNECE për të mbrojtur dhe siguruar sasinë, cilësinë dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore ndërkufitare. Konventa synon një përjasje të gjithanshme të bazuar në arsyetimin së burimet ujore luajnë një rol integral në ekosistemet si edhe në shoqëritë dhe ekonominë. Shqipëria e ka ratifikuar këtë konventë në vitin 1994.
4. Konventa e Vienës 1985	Për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit	Kjo konventë synon që vendet anëtare të kësaj marrëveshje ndërkombëtare të marrin masa të përshtatshme për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin ndaj efekteve negative të shkaktuara nga veprimtaritë njerëzore të cilat modifikojnë ose ka të ngjarë të modifikojnë shtresën e ozonit. Palët që kanë nënshkruar konventën dhe protokollet përkatëse të saj synojnë pakësimin gradual të prodhimit dhe të përdorimit të lëndëve ozonholluese kryesisht CFC dhe HCFC. Shqipëria ka ratifikuar këtë konventë në vitin 1999 dhe disa nga protokollet e saj.
5. Konventa e Helsinkit 1992	Për Efektet Ndërkufitare të Aksidenteve Industriale	Konventa ka si qëllim të mbrojë njerëzit dhe mjedisin nga aksidentet industriale, synon të parandalojë aksidentet ose të pakësojë frekuencën dhe ashpërsinë e tyre dhe të zbusë efektet e tyre. Konventa promovon bashkëpunimin aktiv ndërkombëtar midis vendeve para, gjatë dhe pas një aksidenti industrial. Konventa ndihmon palët për të parandaluar aksidentet të cilat kanë efekte ndërkufitare dhe për të qenë të përgatitur dhe për tu përgjigjur nëse aksidentet ndodhin. Në proceset dhe operacionet industriale mund të përdoren lëndë, të cilat zakonisht nuk paraqesin kërcënim të madh për shëndetin ose mjedisin por që janë kurrëmëpak potencialisht të rrezikshme. Edhe fabrika më e sigurtë kurrë nuk është totalisht e parrezikshme. Shqipëria ka ratifikuar këtë konventë në vitin 1994.
6. Konventa e Espos 1991	Për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor në Kontekst	Konventa përcakton të drejtat dhe detyrimet e secilës palë kur ndikimi mjedisor i një veprimtarie ka gjasa të dalë tej kufirit kombëtar dhe përcakton procedurat për shqyrtimin e ndikimit kur vendimi për zhvillimin e një projekti është marrë. Vendet normalisht duhet të

	Ndërkufitar	zbatojnë dispozitat e Konventës nëse plotësohen dy kërkesa: veprimtaria e propozuar duhet të jetë e listuar në Shtojcën I të Konventës dhe veprimtaria ka të ngjarë të shkaktojë ndikim të rëndësishëm negativ ndërkufitar. Shqipëria ka ratifikuar këtë konventë në vitin 1991.
7. Konventa e Stokholmit 2001	Për Ndotësit Organike të Qëndrueshëm	Konventa përcakton si qëllim fillestar pakësimin e përdorimit dhe asgjësimin e 12 ndotëseve organike të qëndrueshëm (POPs). Në përgjithësi këto lëndë janë pesticide, të cilat luftojnë dëmtesit e kulturat bujqësore. Konventa ngre një sistem për identifikimin, mosprodhimin dhe mospërdorimin e POPs të tjerë në të ardhmen. Gjithashtu Konventa mbështet nismat dhe masat për pastrimin nga ndotësit organike të qëndrueshëm në të gjitha vendet anëtare. Zëvendësimi i POPs të rrezikshëm me lëndë të tjera të parrezikshme është një nga masat e rëndësishëm që mbështet nga Konventa. Shqipëria ka ratifikuar këtë konventë në vitin 2004.
8. Konventa e Gjenevës 1979	Për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Largësi të Madhe	Konventa vendos një kuadër të gjerë ligjor për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga ndotja e ajrit. Palët në konventë do të përpiqen të kufizojnë sa më shumë dhe të pakësojnë gradualisht dhe parandalojnë ndotjen e ajrit duke përfshirë edhe ndotjen e ajrit në largësi të mëdha tejkuftare. Palët kontraktuese nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, konsultimeve, hulumtimeve, kërkimeve dhe monitorimit do të zhvillojnë politika dhe strategji, të cilat do të shërbejnë si mjete për të luftuar shkarkimin e ndotëseve të ajrit. Në ndotësit ajrit konventa përfshin: SO ₂ , NO _x , amonin CH ₄ , VOCs, POPs, dhe metalet e rënda si psh: Pb, Cd, Hg. Shqipëria ka ratifikuar këtë konventë në vitin 2005
9. Konventa e Arhusit 1998	Për të Drejtën e Publikut për Informacion, pjesëmarrje në Vendimmarrje dhe të Drejtën e për t'iu Drejtuar Gjykatës për Çështje të Mjedisit	Konventa mbron të drejtën e çdo individi të brezit të sotëm e të ardhshëm për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij. Të gjitha palët do të garantojnë të drejtën e publikut për patur informacion mjedisor, për të marrë pjesë në vendimet që prekin mjedisin dhe për tu drejtuar gjykatës në lidhje me çështje të mjedisit. Konventa lidh të drejtat mjedisore me të drejtat e njeriut, njeh detyrimin tone mjedisor për brezat e ardhshëm, promovon zhvillimin e qëndrueshëm nëpërmjet angazhimit të të gjithë aktoreve, lidh përgjegjshmërinë qeveritare me mbrojtjen mjedisit dhe fokusohet në marrëdhëniet midis publikut dhe autoriteteve qeverisëse në një kontekst demokratik. Shqipëria ka ratifikuar këtë konventë në vitin 2000.
10. Konventa e Rios 1992	Për Ndryshimet Klimatike	Konventa Kuadër për Ndryshimet Klimatike kërkon të stabilizojë përqendrimit e gazeve serë (GHGs) në atmosfere në atë nivel që do të parandalonte ndërhyrjet antropogjenike të rrezikshme në sistemin klimatik. Vete Konventa nuk vendos kufij të detyrueshëm për shkarkimet e GHGs për vende të ndryshme dhe nuk përmban mekanizma shtërngues. Mekanizmi detyrues i kësaj Konvente është Protokollin e Kiotos në të cilin përcaktohen detyrime për pakësimin shkarkimeve të gazeve sere. Një nga detyrat parësore të vendeve pjesëmarrëse në Konventën Kuadër është ngritja e inventarëve kombëtare të shkarkimeve të GHGs dhe pakësimi i tyre gradual. Në atmosfere gazet sere më të përhapur janë: avujt e ujit H ₂ O, CO ₂ , NO _x , metani, ozoni, dhe klorflorkarbonet. Shqipëria ka ratifikuar këtë konventë në vitin 2004.

Në marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e energjisë (IAEs) më të rëndësishmet janë Traktati për Kartën e Energjisë (ECT) dhe Traktati për Komunitetin e Energjisë (TEC). Traktati për Kartën e Energjisë së bashku me Protokollin për Efiçencën e Energjisë dhe Aspektet Mjedisore (PEEREA) siguron një kuadër shumëpalësh për bashkëpunimin në fushën e energjisë dhe konsiderohet unik në bazë të ligjit ndërkombëtar. Ky traktat është projektuar për të promovuar sigurinë për energjinë nëpërmjet funksionimit të më shumë tregjeve të hapur e konkurrues të energjisë, ndërsa respekton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe sovranitetin e burimeve të energjisë. Traktati është nënshkruar në 1994 dhe ka hyrë në fuqi në 1998. Deri më sot traktati është nënshkruar nga rreth 60 shtete duke përfshirë edhe Shqipërinë.

Traktati për krijimin e Komunitetit për Energjinë është nënshkruar në 2005 nga EU dhe nëntë shtete si palë kontraktuese nga Europa Juglindore, ku përfshihet edhe Shqipëria. Pas ratifikimit, traktati hyri në fuqi në 2006. Qëllimi i TEC është të krijohet një kuadër i vetëm rregullator për transportin e energjisë në Europën Juglindore në mënyrë që të avancohet pozita e rajonit në hartën botërore të energjisë. Traktati ndihmon për të garantuar që vendet e rajonit të adoptojnë rregullat e një tregu të vetëm të EU për tregjet e naftës, gazit natyror dhe elektricitetit. Krijimi i një mjedisi rregullator të qëndrueshëm do të nxisë investimet në fushën e energjisë në rajon.

Pasqyra 8 – IAEs të ratifikuara nga Shqipëria

Marrëveshjet Shumëpalëshe për Energjinë		
Marrëveshja	Emërtimi	Përshkrimi dhe Qëllimet
1. Traktati për Kartën e Energjisë	Traktati për Kartën e Energjisë (ECT)	<p>Traktati për Kartën e Energjisë është një shprehje koncize e parimeve që duhet të mbështesin bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e energjisë bazuar në interesat e përbashkëta për furnizime të sigurta më energji dhe zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Dispozitat e ECT janë detyruese dhe fokusohen në katër fusha të gjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Mbrojtjen e investimeve të huaja, bazuar në zgjerimin e trajtimit kombëtar dhe mbrojtjen ndaj rreziqeve kryesore jotregtare; ▪ Krijimin e kushteve jodiskriminuese në tregtinë e materialeve energjetike, pajisjeve dhe produkteve të energjisë, bazuar në rregullat e OBT-së, dhe sigurimi i transiteve ndërkufitare të sigurta të energjisë nëpërmjet rrjeteve dhe linjave të gazit e naftës; ▪ Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis shteteve pjesëmarrëse në traktat si edhe midis investitorëve dhe shteteve pritëse; ▪ Promovimin e efikasitetit të energjisë dhe përpjekjet për të pakësuar ndikimin e mjedisit të prodhimit dhe përdorimit të energjisë. <p>Shqipëria e ka ratifikuar këtë Traktat dhe Protokollin përkatës në vitin 1997.</p>
2. Traktati për Komunitetin e Energjisë	Traktati për Komunitetin e Energjisë (TEC)	<p>Misioni i Traktatit për Komunitetin e Energjisë është të zgjerojë tregun e brendshëm të energjisë të EU në drejtim të Europës Juglindore dhe më tej, mbi bazën e një kuadri të detyrueshëm ligjor. Objektivi i përgjithshëm i Komunitetit të Energjisë është të krijojë një kuadër të qëndrueshëm rregullator dhe tregtar më qëllim:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Të tërheqë investime në prodhimin e energjisë dhe në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes për të siguruar furnizim të vazhdueshëm më energji; ▪ Të krijojë një treg të integruar të energjisë për të lejuar tregtinë ndërkufitare të energjisë dhe integrimin më tregun e EU; ▪ Të rrite sigurinë për furnizimin më energji; ▪ Të përmirësojë gjendjen mjedisore në lidhje me prodhimin dhe furnizimin më energji në rajon; ▪ Të nxisë konkurrencën në nivel rajonal dhe të shfrytëzojë ekonominë e shkallës. <p>Shqipëria e ka ratifikuar këtë traktat në vitin 2006.</p>

VI Institucionet kombëtare në fushën e mjedisit e energjisë

Institucionet e para në Shqipëri, të cilat u ngarkuan për të hartuar politikat në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe përdorimit eficient të energjisë u krijuan pas viteve 1990. Ndër institucionet publike kryesore janë Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MM), Agjencia e Mjedisit dhe e Pyjeve, Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM), Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë (METE), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. Detyrimet shtetërore e qeveritare për mbrojtjen e mjedisit rrjedhin nga Kushtetuta e Shqipërisë, konventat dhe detyrimet ndërkombëtare dhe legjislati shqiptar.

6.1 Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave

Institucioni më i lartë shtetëror në fushën e mbrojtjes së mjedisit u krijua në vitin 1993, pavarësisht emërtimeve të ndryshme të cilat kanë ndryshuar gjatë viteve. Në vitin 2002 u rihartua dhe përmirësua ligji për mbrojtjen e mjedisit¹⁷ dhe në këtë kuadër edhe përgjegjësitë dhe detyrat e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MM). Duke u bazuar në nenin 67 të ligjit, Ministria e Mjedisit si institucion qendror i specializuar dhe si një organ për mbështetje teknike kryen këto veprimtari kryesore:

- Harton politikat, strategjitë dhe programet kombëtare në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- Miraton metodat dhe metodologjitë sipas të cilave zhvillohen veprimtaritë kryesore të mbrojtjes së mjedisit;
- Përgatit projektet e marrëveshjeve, të protokolleve e programeve të bashkëpunimit shtetëror me organizata ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit;
- Mbështet projektet kërkimore e shkencore për përmirësimin e gjendjes së mjedisit, për futjen e teknologjive ekologjike të pastra e për nxitjen e veprimtarive të organizatave mjedisore;
- Kërkon pezullimin e miratimit të strategjive e të planeve sektoriale kur ato nuk janë në pajtim me kriteret e kërkesat mjedisore;
- Cakton, në bashkëpunim me ministrat përkatës, fondet për mjedisin në çdo ministri dhe për përdorimin racional të tyre në shkallë vendi;
- Përfaqëson vendin në veprimtaritë ndërkombëtare, në organizatat dhe programet ndërqeveritare dhe ndërshtetërore;
- Bashkëpunon me institucionet qendrore, me organet e qeverisjes vendore, me publikun dhe organizatat mjedisore e profesionale për të rritur shkallën e zbatimit të legjislati mjedisor;
- Studion nevojat e vendit për specialistë për mbrojtjen e mjedisit dhe bashkërendon me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për kualifikimin e specializimin e tyre;
- Ndihmon organet e qeverisjes vendore për mbrojtjen e mjedisit dhe për hartimin e zbatimin e planeve vendore për mjedisin.

Në varësi të Ministrisë së Mjedisit operojnë Agjencitë Rajonale të Mjedisit, Inspektorati për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Agjencia e Mjedisit dhe e Pyjeve të cilat kanë detyra specifike të përcaktuara me ligj. Me poshtë po japim disa nga funksionet kryesore të këtyre institucioneve.

6.2 Agjencitë Rajonale të Mjedisit

Në vend janë ngritur 12 Agjenci Rajonale të Mjedisit, të cilat janë institucione të specializuara për zbatimin e politikave kombëtare të mbrojtjes së mjedisit në nivel qarku. Detyrat kryesore të ARM-ve janë si me poshtë:

- Zbatojnë programet dhe projektet qeveritare në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- Realizojnë zbatimin e ligjit për mbrojtjen e mjedisit në nivel vendor;

¹⁷ Ligji 8934/2002 "Për Mbrojtjen e Mjedisit"

- Ndhimojnë organet e pushtetit vendor për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit në territorin që kanë në juridiksion; bashkëpunojnë për hartimin dhe zbatimin e planeve vendore të veprimit për mjedisin;
- Bashkëpunojnë me programe dhe projektet të vendit e të huaja për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit në nivel qarku;
- Marrin pjesë në procesin e miratimit të lejes mjedisore dhe japin pëlqimin dhe autorizimin mjedisor për veprimtaritë biznesore;
- Nxisin përdorimin e teknologjive të pastra dhe futjen e sistemeve të menaxhimit mjedisor;
- Hartojnë dhe paraqesin për miratim në këshillin e qarkut raportin dyvjeçar të gjendjes së mjedisit të qarkut. Ky raport i bëhet i ditur publikut nëpërmjet mediave të shkruara dhe elektronike;
- Ndërmarrin veprimtari ndërgjegjsuese për mjedisin, bashkëpunojnë me bashkësitë me organizatat jofitimprurëse mjedisore dhe profesionale të biznesit.

6.3 Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit

Inspektorati për Mbrojtjen e Mjedisit (IMM) është strukturë institucionale në varësi të Ministrisë së Mjedisit me detyre kryesore kryerjen e inspektimeve dhe kontrolleve mjedisore. IMM menaxhohet nga kryeinspektori dhe inspektorët mjedisore në qarqet përkatëse. Disa nga detyrat kryesore të Inspektoratit janë si më poshtë:

- Ushtron kontroll sistematik mbi mjedisin dhe ndaj veprimtarive ndotëse për të siguruar mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet zbatimit të legjislacionit mjedisor dhe kërkesave të hartuara në lejen dhe në deklaratën mjedisore;
- Kërkon pjesëmarrjen e organeve të qeverisjes vendore, të organizatave mjedisore dhe të mediave në kontrollet mbi veprimtaritë ndotëse;
- Krijon dosjen mjedisore për çdo veprimtari të pajisur me leje mjedisore, bazuar në rregulloret e përgatitura nga Ministria e Mjedisit;
- Ndhmon personat fizikë e juridikë për të realizuar vetëmonitorimin, verifikimin dhe zbatimin e sistemeve të integruara të menaxhimit mjedisor;
- Urdhëron masa të detyrueshme për zbatim për përmirësimin e gjendjes së mjedisit, për pakësimin e ndotjes dhe të dëmtimit të mjedisit;
- Informon rregullisht pushtetin vendor për gjendjen e mjedisit, për veprimtaritë, projektet dhe instalimet e miratuara sipas kërkesave të ligjit;
- Kontrollon regjistrat e ndotësve, rregulloret teknike e teknologjike dhe dokumentet e tjera që lidhen me veprimtarinë dhe rrezikun e ndotjes;
- Vendos sanksione, sipas ligjit dhe akteve të tjera ligjore që mbrojnë përbërës të veçantë të mjedisit;
- Bën publike rezultatet për çdo kontroll të ushtruar.

6.4 Agjencia e Mjedisit dhe e Pyjeve

Agjencia e Mjedisit dhe e Pyjeve (AMP) është krijuar në vitin 2002 dhe është në varësi institucionale nga Ministria e Mjedisit. Detyra kryesore e AMP është kryerja e studime dhe kërkimeve në fushën e mjedisit. AMP është gjithashtu institucion konsultativ kombëtar në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Disa nga detyrat kryesore të AMP janë si më poshtë:

- Harton projekt propozime dhe zbaton projekte në fushën e mbrojtjes të mjedisit;
- Merr pjese në zbatimin e programeve kombëtare të monitorimit të mjedisit;
- Kontribuon në përgatitjen e metodologjive për monitorimin dhe auditimin mjedisor;
- Bashkëpunon me organizata vendore dhe të huaja për zbatimin e projekteve dhe programeve në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- Kryen analiza laboratorike të fushës së mjedisit.

6.5 Ministria e Ekonomisë, Tregtisë e Energjisë

METE harton dhe zbaton politika që nxisin rritjen dhe stabilitetin ekonomik, që mundësojnë zhvillimin e biznesit vendas dhe tërheqjen e investimeve të huaja, që garantojnë konkurrencën dhe një treg të sigurtë, që sigurojnë një zhvillim të qëndrueshëm e perspektiv të burimeve energjetike të vendit, që nxisin bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar, që realizojnë mireadministrimin e pronës publike në sektorët strategjike dhe të ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

Përveç përgjegjësive për hartimin dhe zbatimin e programeve të zhvillimit ekonomik dhe shkëmbimeve tregtare, një nga përparësitë kryesore të METE është edhe zhvillimi e sektorit energjistik në vend. Qëllimi i politikës shtetërore në sektorin kryesor energjistik, është zhvillimi i një tregu të sigurtë dhe konkurrues të energjisë elektrike për të garantuar furnizimin me energji elektrike të të gjithë konsumatoreve, me çmime të arsyeshme, në një mënyre të shëndetshme ekonomike dhe mjedisore dhe në përputhje me parimet e tregut të lirë.

Objektivat qeveritare në drejtim të energjisë janë pasqyruar në "Strategjinë Kombëtare të Energjisë" (draft) ku janë përcaktuar drejtimet kryesore të zhvillimit të një sistemi të sigurtë energjistik, mbështetur në parimet e tregut, për plotësimin e kërkesave për energji të konsumatoreve me kosto minimale, duke patur në konsideratë sigurinë e furnizimit, mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e mirëqenies së popullsisë. Disa nga objektivat kryesore të strategjisë janë:

- Ristrukturimi i sektorit energjistik shqiptar bazuar në parimet e ekonomisë së tregut dhe në zhvillimin e një politike bashkëkohore energjetike;
- Krijimi i një kuadri efektiv institucional dhe rregullator si dhe restrukturimi i plotë i shoqërive publike energjetike me synim privatizimin e shpejte të tyre;
- Nxitja e përdorimit eficient dhe ekologjik të energjisë në mënyrë të tillë që sektori energjistik të jetë një sektor mbështetës për një zhvillim të qëndrueshëm të të gjithë sektorëve të tjerë ekonomike;
- Optimizimi i sistemit të furnizimit me burime energjetike duke u mbështetur në konceptin e planifikimit me kosto më të ulët dhe ndikim minimal në mjedis;
- Nxitja e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë si psh: të diellit, ujit, erës dhe biomasës për mundësuat shfrytëzimin racional të burimeve të ripërtrishme vendore;
- Organizimi i fushatave sensibilizuese për përdorimin eficient të energjisë elektrike.

Ndër synimet kryesore të METE-s në sektorin e energjisë për vitin 2010 janë:

- Miratimi i Strategjisë Kombëtare të Energjisë;
- Hartimi i ligjit për promovimin e energjive të rinovueshme;
- Përmirësimi i ligjit ekzistues për eficientësinë e energjisë;
- Planifikimi dhe përgatitja e programeve për shfrytëzimin e energjisë bërthamore në Shqipëri.

6.6 Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

AKBN është një institucion në varësi të METE, që ofron konsulencë për qeverinë për studime dhe projekte në fushat e veprimtarisë së saj, si dhe promovon pasuritë natyrore të vendit në ato fusha. Veprimtaritë e AKBN në fushën e energjisë kanë si objektiva kryesore:

- Konsultimi, propozimi dhe bashkëpunimi me strukturat përkatëse të qeverisë për hartimin politikave të saj në fushën e minierave, të hidrokarbureve dhe të hidroenergjetikës;
- Zbatimi i politikave të qeverisë në fushën e minierave, të hidrokarbureve dhe të hidroenergjetikës;

- Sigurimi i konsulencës për studimet dhe për projektet në fushën e veprimtarive minerare, hidrokarbure dhe hidroenergjetike të paraqitura nga subjektet e ndryshme vendore e të huaj;
- Mbikëqyrja e veprimtarisë minerare, hidrokarbure dhe hidroenergjetike;
- Përgatitja e dokumentacionit dhe e praktikave të nevojshme për dhënien e lejeve e licencave në përputhje me ligjin.

VII Programet kombëtare në fushën e mjedisit e energjisë

Programet kombëtare në fushën e mjedisit dhe të efikasitetit të energjisë janë pjesë përbërëse e strategjisë kombëtare për integrim dhe zhvillim dhe marrëveshjes së Shqipërisë me EU të nënshkruar në vitin 2006 ku janë përcaktuar detyrimet e vendit në procesin e përafrimit dhe integritit evropian. Marrëveshja e Stabilizimit e Asociimit¹⁸ midis EU dhe Shqipërisë përmban dispozita të cilat janë detyruesisht për tu zbatuar në lidhje me forcimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit në fushat jetësore për të luftuar degradimin e mjedisit me qëllim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Ky bashkëpunim do të fokusohet kryesisht në fushat përparëse të përcaktuara në legjislacionin evropian për fushën e mjedisit.

7.1 Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA 2009-2014

Në vitin 2009, Marrëveshja për Stabilizim e Asociimit (MSA) midis Shqipërisë dhe EU hyri në fuqi pas ratifikimit të saj nga vendet anëtare të EU. Marrëveshja përmban dispozita specifike për bashkëpunimin në fushën e mbështetjes së NVM-ve (Neni 93), mjedisit (Neni 108) dhe energjisë (Neni 107). Në mënyrë të përmbledhur palët në marrëveshje shprehin dëshirën për bashkëpunim për të forcuar NVM-të bazuar në përparësitë europiane të përcaktuara në legjislacionin e EU si edhe në Kartën Europiane për NVM-të; palët gjithashtu do të forcojnë bashkëpunimin në luftën kundër degradimit mjedisor, me synim promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu bashkëpunimi do të përqendrohet në fushat parësore që lidhen me legjislacionin e EU në fushën e energjisë. Ky bashkëpunim do të pasqyrojë parimet e ekonomisë së tregut dhe bazohet në traktatin rajonal të EU për energjinë me synim integrimin gradual të Shqipërisë në tregjet europiane të energjisë.

Në lidhje me mjedisin në kuadër të kërkesave të MSA, Ministria e Mjedisit po kryen përafrimin gradual të legjislacionit mjedisor shqiptar me atë të vendeve të EU si psh: në fushën e vlerësimit të ndikimit në mjedis, menaxhimit të mbetjeve, reformës rregullatore mjedisore, inspektimin mjedisor. Hartimi dhe zbatimi i legjislacionit horizontal për të siguruar mbrojtjen e integruar të mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, përbën një ndër detyrimet themelore të MSA¹⁹. Në kuadër të zbatimit të MSA-së kërkohet forcimi i bashkëpunimit midis institucioneve qendrore dhe vendore të përfshira në administrimin e mjedisit, burimeve natyrore dhe territorit me qëllim integrimin e çështjeve të mjedisit në të gjitha hallkat e vendimmarrjes dhe realizimin e një vendimmarrje mjedisore gjithëpërfshirëse.

Për periudhën afatshkurtër 2009-2010, prioritetet në fushën e mjedisit do të jenë:

- Forcimi i kapaciteteve administrative e bashkërendimi në nivel kombëtar dhe vendor për çështjet mjedisore;
- Zbatimi i legjislacionit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe vlerësimin strategjik mjedisor;
- Miratimi i strategjisë për harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar të mjedisit me atë të EU dhe monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të saj;

¹⁸ SAA between the EC and Albania 2006

¹⁹ PKZMSA 2009-2014

- Zbatimi i konventave ndërkombëtare të mjedisit në të cilat Shqipëria është palë në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe natyrës.

Për periudhën afatmesme dhe afatgjatë 2011–2014, prioritetet në fushën e mjedisit janë:

- Forcimi i zbatimit të legjislacionit të VNM dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore;
- Pjesëmarrja aktive dhe kontributi në angazhimet rajonale dhe ndërkombëtare për mjedisin.
- Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me ministritë dhe institucionet e interesit;
- Përmirësimi i monitorimit të mjedisit dhe i përpunimit të të dhënave të monitorimit për të orientuar politikat mjedisore;
- Rritja e bashkëpunimit me qeverisjen vendore dhe ARM-të për forcimin e procesit të pjesëmarrjes së publikut në procesin e VNM.

Politikat në fushën e energjisë synojnë zhvillimin e një tregu të sigurtë dhe konkurrues të energjisë elektrike për të garantuar furnizimin me energji të të gjithë konsumatoreve me çmime të arsyeshme, në mënyrë miqësore me mjedisin dhe në përputhje me parimet e tregut të lire, në pajtim me direktivat e EU dhe të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Në Planin për zbatimin e MSA-së për vitet 2009-2013, disa nga prioritetet strategjike të sektorit energjetik janë:

- Krijimi i një kuadri efektiv institucional e ligjor në sektorin e energjisë;
- Rritja e kapaciteteve gjeneruese të energjisë dhe diversifikimi i tyre;
- Përmirësimi i sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë;
- Përmirësimi i standardeve për furnizimin me burime energjetike e hidrokarbure;
- Nxitja e përdorimit eficient të burimeve të energjisë;
- Nxitja e përdorimit të gjithanshëm të burimeve të rinovueshme të energjisë,
- Forcimi dhe përmirësimi i tregut të brendshëm dhe integrimi i tij në tregun rajonal të energjisë.

Në fushën e efikasitetit të energjisë do të përmirësohet ligji me qëllim harmonizimin e plotë të tij bazuar në Direktivën 2006/32/EC si dhe plotësimin e kuadrit ligjor të nevojshëm që i shërben përdorimit eficient të energjisë dhe pakësimit të humbjeve të energjisë në të gjithë ciklin e jetës së saj.

Miratimi i ligjit për energjinë e rinovueshme, që do të bazohet në Direktivën 2001/77/EC, ka synim promovimin e burimeve të rinovueshme për prodhimin e energjisë elektrike. Ligji do të ketë për qëllim të krijojë lehtësira në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme dhe të vendosë në baza preferenciale energjinë e prodhuar nga këto burime.

7.2 Programet në fushën e mbrojtjes së mjedisit

Që prej ndryshimeve politike duke filluar nga viti 1990, Shqipëria i ka forcuar marrëdhëniet dhe lidhjet ndërkombëtare për çështjet e mjedisit jo vetëm në nivel rajonal por edhe në atë global. Këto përpjekje janë rezultat i interesit të vendit për tu integruar në Europë dhe në bashkësinë ndërkombëtare në mënyrë që të përfitojë nga përvoja dhe mbështetja financiare dhe teknike për të zgjidhur problemet e mprehta mjedisore të vendit si edhe të sigurojë përfshirjen në mekanizmat e bashkëpunimit për këto çështje. Ndërkohë vetë institucionet përgjegjëse hartojnë dhe zbatojnë programe kombëtare dhe vendore për çështje të mbrojtjes së mjedisit. Programet kombëtare për mbrojtjen mjedisit për periudhën 2007-2013²⁰ do të mbështeten në disa përparësi të cilat lidhen me marrjen e masave të gjithanshme në komponentët e mëposhtëm. Në programet e financuar nga donatorët mund të përmendim:

²⁰ Strategjia Ndërsektorale e Mjedisit 2007-2013

1) Projekti “Për Ndërtimin e Kapaciteteve për Financimin e Karbonit në Shqipëri” i financuar nga PNUD, ADA dhe Qeveria Shqiptare. Periudha zbatimit të projektit është 2006-2010. Ky projekt synon të ndihmojë Qeverinë Shqiptare për të zhvilluar kapacitetet e sektorit publik dhe privat për të patur akses në financimin e karbonit në Shqipëri nëpërmjet (i) krijimit të një kuadri ligjor dhe institucional për financimin e karbonit dhe (ii) ndërtimin e kapaciteteve të vendit për identifikimin, zbatimin dhe mobilizimin e burimeve për projektet e pakësimit të GHG, të pranueshëm për CDM dhe mekanizmat e tjerë të tregut të karbonit.

2) Projekti “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor (INPAEL)” i financuar nga EU në të cilin si përfitues kryesor është Ministria e Mjedisit. Objektivat specifike të projektit janë: (i) rritjen e aftësive për kontrollin efektiv të ndotjes së ajrit dhe të ujit dhe menaxhimin e mbetjeve të ngurta në pajtim me legjislacionin respektiv kombëtar si edhe të parashikuar në MSA dhe në SNM dhe (ii) zhvillimin e ndërtimin e kapaciteteve institucionale të MM dhe institucioneve të tjera qeveritare për përmirësimin e mekanizmave të koordinimit, forcimin e mjeteve rregullatore ekzistues dhe konsolidimin e përdorimit të instrumenteve ekonomike. Në këtë projekt rëndësi e posaçme i është dhënë hartimit të strategjisë kombëtare për menaxhimin e mbetjeve dhe zbatimit të Planeve të Veprimit Kombëtar e Rajonal.

7.2.1 Përforcimi i zbatimit të legjislacionit mjedisor

Në këtë komponent emergjente është përforcimi institucional me burime njerëzore dhe financiare i ARM-ve dhe i IMM. Përmirësimi i metodikave dhe procedurave të inspektimit dhe licencimit është i domosdoshëm për vetë ndërmarrjet në parandalimin e kontrollin e ndotjeve. Ndarja e autoritetit licencues nga ai inspektues do të jetë një hap i rëndësishëm në drejtim të përforcimit të të dy autoriteteve dhe përmirësimit të bashkëpunimit me NVM-të. Rritja e numrit të inspektoreve të mjedisit ose dhe krijimi i inspektorateve të integruar mund të jetë një alternative efektive për uljen e kostove, rritjen e efikasitetit të inspektorateve dhe uljen e ngarkesave të panevojshme burokratike për bizneset. Përmirësimet e statistikave të inspektimeve dhe të monitorimeve në mjediset e bizneseve janë një komponent i rëndësishëm për të analizuar prirjet dhe natyrën e ndotjeve mjedisore të shkaktuara nga bizneset. Kombinimi i metodikave ose masave me nxitjen e shmangieve në shkeljet mjedisore si edhe me sanksionet ligjore është një praktikë e mirë për të rritur ndërgjegjësimin ndaj mbrojtjes së mjedisit dhe pakësuar ndotjet e mjedisit.

7.2.2 Transpozimi i legjislacionit ndërkombëtar mjedisor

Adoptimi i legjislacionit ndërkombëtar vazhdon të kryhet në dy drejtime: ratifikimin e Konventave Ndërkombëtare të Mjedisit dhe transpozimin e përafrimit tërësor ose pjesor të Direktivave të EU në legjislacionin shqiptar. Në këtë kuadër Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje në nivel dy palësh edhe rajonal për çështjet mjedisore. Shqipëria ka ratifikuar 17 konventa ndërkombëtare disa prej të cilave janë këto si më poshtë:

- ❖ Konventa e Vienës (Për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit, 1985)
- ❖ Konventa e Bazelit (Për Kontrollin e Transportit Ndërkufitar të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Depozitimin e Tyre, 1989)
- ❖ Konventa e Rios (Konventa Kuadër për Ndryshimet Klimatike, 1992)
- ❖ Konventa e Stokholmit (Për Lendet e Ngurta Organike, 2002)
- ❖ Konventa e Barcelonës (Për Mbrojtjen e Detit Mesdhe ndaj Ndotjes, 1976)
- ❖ Konventa e Bernës (Për Ruajtjen e Kafshëve të Egra e Habitave Natyrore, 1979)
- ❖ Konventa e Espos (Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitar, 1991)
- ❖ Konventa e Helsinkit (Për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Ujrave Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare, 1992)

- ❖ Konventa e Arhusit (Për të Drejtën e Publikut për Informacion, Pjesëmarrje në Vendime dhe për t'ju Drejtuar Gjykatës për Çështjet Mjedisore, 1998)

Në bazë të Kushtetutës së Shqipërisë, konventat ndërkombëtare hynë në fuqi kur ato ratifikohen nga Kuvendi, kështu këto bëhen pjesë e legjislacionit shqiptar. Pas ratifikimit këto konventa kanë përparësi ndaj legjislacionit kombëtar. Konventat ndërkombëtare në fushën e mjedisit administrohen nga Ministria e Mjedisit.

Siç kemi përmendur edhe më parë, legjislacioni shqiptar në fushën e mjedisit është tërësisht i ri dhe i mbështetur në Direktivat e EU dhe të disa për legjislacione më të mira në Europë. Ligjet kryesore, të cilët lidhen edhe me veprimtarinë biznesore i kemi përmendur në seksionet e mëparshme. Në vazhdim të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të vendeve të EU kërkohet adoptimi i standardeve evropiane si për shkarkimet ashtu edhe për rritjen e cilësisë së mjedisit. Në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA²¹ janë përcaktuar në mënyrë të detajuar masat që do të merren në fushën e mjedisit në lidhje me komponentët si psh: legjislacionin horizontal, cilësinë e ajrit, menaxhimin e mbetjeve, menaxhimin e ujit, mbrojtjen e natyrës, ndotjet dhe rreziqet industriale, kimikatet, organizmat e modifikuar gjenetikisht, zhurmat, sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimet dhe ndryshimet klimatike.

Direktivat kryesore të EU në të cilat është përqendruar puna e transpozimit në fushën e mjedisit janë:

- Direktiva 97/11/EC "Për vlerësimin e efekteve që shkaktohen nga veprimtaritë private dhe publike në mjedis";
- Direktiva 90/313/EC "Për të drejtën e informimit për mjedisin"
- Direktiva 91/692/EC "Për standardizimin dhe racionalizimin e raporteve për zbatimin e direktivave që lidhen me mjedisin"
- Direktiva 96/62/EC "Për cilësinë e ajrit"
- Direktiva 2008/01/EC "Për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes"
- Direktiva 75/442/EC "Për mbetjet"
- Direktiva 91/689/EC "Për mbetjet e rrezikshme"
- Direktiva 92/43/EC "Për mbrojtjen e habitateve natyrore, florës dhe faunës"

7.2.3 Menaxhimi i burimeve natyrore

Programi qeveritar e konsideron shumë të rëndësishëm shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore të vendit si psh: minierat, pyjet, kullotat, ujin, token, florën e faunën e tokës e të ujit. Për çdo element të mjedisit të përmendur më lart vazhdojnë të zbatohen programe qeveritare dhe të donatoreve të huaj të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e mjedisit në çdo aspekt dhe për çdo komponent të tij. Veçanërisht përparësi i janë kushtuar shfrytëzimit racional të burimeve ujore, të erës, pyjore dhe atyre peshkore.

7.2.4 Mbështetja financiare dhe investimet për mjedisin

Niveli i investimeve në fushën e mbrojtjes së mjedisit në vend është i ulët. Arritja e standardeve evropiane në fushën e mjedisit kërkon investime dhe mbështetje financiare të vazhdueshme. Programimi i investimeve në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe të burimeve natyrore duhet të fokusohet në drejtimitet e mëposhtme:

- Grumbullimi dhe trajtimi i ujerave të mbetura
- Menaxhimi modern i mbetjeve urbane e industriale
- Përmirësimi i menaxhimit të tokës
- Promovimi dhe përmirësimi i teknologjive të industrive të vendit

²¹ Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA, 2009-2014

Krijimi i Fondit për Mjedisin dhe mbështetja e mjaftueshme financiare për të do të ishte një zgjidhje e përshtatshme për të financuar programet kombëtare në fushën e mjedisit dhe të mbrojtjes së burimeve natyrore.

7.2.5 Promovimi i komunikimit dhe ndërgjegjësimit mjedisor

Një nga elementet më të pazhvilluar të qytetërimit në vendin tonë është qëndrimi dhe sjellja ndaj mjedisit. Dëmtimi dhe ndotja e mjedisit janë dukuritë që merren në konsideratë të fundit ose nuk merren fare nga institucionet, bizneset dhe qytetaret. Shumë pak veprimtari promovuese dhe ndërgjegjësuese ndërmerren nga qeveria qendrore dhe qeveritë vendore. Mungesa e programeve kombëtare dhe vendore ndikon shumë në nivelin e ndotjes së mjedisit. Në SNM është planifikuar të merren disa masa dhe nisma të cilat janë:

- Sigurimi i informacionit mjedisor e ligjor për publikun në nivel kombëtar dhe vendor;
- Rritja e ndërgjegjësimit qytetar për mbrojtjen e mjedisit;
- Promovimi i sjelljeve dhe qëndrimeve miqësore ndaj mjedisit.

7.3 Programet në fushën e efikasitetit të energjisë

Deri më sot nuk kemi ende të dhëna statistikore për pjesën e konsumit të përgjithshëm të energjisë që konsumojnë ndërmarrjet shqiptare të sektorëve të ndryshëm. Nga statistikat shqiptare rezulton se në fund të 2008, industria konsumoi 18 përqind të sasisë së energjisë elektrike dhe 12 përqind të karburanteve. Aktualisht në Shqipëri programet në fushën e efikasitetit të energjisë zbatohen nga donatore të huaj në bashkëpunim me METE-n dhe AKBN. Disa prej programeve që janë në zbatim janë:

- Në kuadër të bashkëpunimit financiar gjerman, KfW po mbështet sektorin e energjisë në disa projekte si psh.: ndërtimin e rrjetit të transmetimit 400 kV Tiranë Podgoricë, ndërtimin e hidrocentraleve, rritjen e kapaciteteve të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë në jug të vendit, ndërtimin e stacioneve të transformatorëve dhe krijimin e një fondi të garantimit të investimeve për hidrocentralet e vegjël;
- USAID dhe Hellenic Aid në kuadër të Komunitetit të Energjisë po zbaton programin rajonal SYNENERGY "Veprimtari për shfrytëzimin e energjie diellore në ndërtesa" për vlerësimin dhe ngritjen e kapaciteteve dhe sigurimin e asistencës financiare për shfrytëzimin e energjisë së diellit në disa qarqe të Shqipërisë, nëpërmjet zbatimit të projekteve pilot në ndërtesat publike dhe në ngrohësit e ujit me energji diellore nëpërmjet skemave të bashkëfinancimit për ndërtesat publike dhe të banimit.

VIII Programet europiane në fushën e mjedisit e energjisë për NVM-të

Programet europiane për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit nga ndërmarrjet e vogla e të mesme menaxhohen nga DG Environment në bashkëpunim me DG Enterprise. Programet që synojnë përmirësimin e efikasitetit të energjisë menaxhohen nga DG Energy në bashkëpunim me dy drejtoritë e mësipërme, atë të mjedisit dhe të ndërmarrjeve. Programet aktuale synojnë ofrimin e asistencës teknike, mbështetjen financiare dhe promovimin e praktikave e projekteve më të mira në këtë fushë. Më poshtë po paraqesim disa nga programet aktuale të EC, të cilat synojnë përmirësimin e performancës mjedisore të ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

8.1 Programi ECAP

Ndërmarrjet e vogla e të mesme tradicionalisht e kanë më të vështirë të operojnë në përputhje me legjislacionin mjedisor së sa ndërmarrjet e mëdha. EC duke kuptuar këto vështirësi ka ndërmarrë hapa konkrete për të ndihmuar NVM-të. Programi i Asistencës për Pajtueshmërinë Mjedisore (ECAP) i propozuar nga EC në 2007 është një komplet masash, të cilat synojnë të ndihmojnë NVM-të për të minimizuar ndikimin në mjedis të veprimtarive të tyre dhe të lehtësojnë pajtueshmërinë me legjislacionin ekzistues. Programi ndihmon në pakësimin e barrës së pajtueshmërisë duke ndërtuar instrumente dhe hartuar politika, të cilat integrojnë çështjet mjedisore në veprimtaritë kryesore të ndërmarrjeve. Programi ECAP përmban plane veprimi në fushat si psh: a) kuadër rregullator më i mirë në projektimin dhe zbatimin e politikave për të minimizuar barrën administrative të pajtueshmërisë për NVM-të, b) zhvillimin e skemave më të përshtatshme për menaxhimin mjedisor, c) asistencë financiare të fokusuar për të nxitur dhe mbështetur nismat nga autoritetet publike, rrjetet e mbështetjes për NVM-të për të përmirësuar performancën mjedisore të NVM-ve, d) ndërtimin e kapaciteteve dhe ekspertizave vendore për NVM-të për të kapërcyer mungesën e dijeve në nivel ndërmarrjeje dhe e) përmirësimin e komunikimit dhe të informimit mjedisor.

8.2 Programi ETAP

Plani i Veprimit për Teknologjitë Mjedisore (ETAP) është një nismë e përbashkët e EC, shteteve anëtare dhe bizneseve industriale i miratuar në 2004 me qëllim kapërcimin e pengesave, të cilat ngadalësojnë zhvillimin e teknologjive mjedisore. Ai është instrumenti kryesor i EU për të tërhequr më shumë investime private e publike për zhvillimin dhe demonstrimin e teknologjive mjedisore. Kjo planifikohet të arrihet nëpërmjet masave për të nxitur eko-novacionet dhe zbatimin e teknologjive mjedisore. Teknologjitë mjedisore janë ato lloje teknologjish, përdorimi i të cilave është me pak i dëmshëm se teknologjitë alternative përkatëse. Nëpërmjet këtij programi synohet që nëpërmjet eko-novacionit të rritet konkurrueshmëria e ndërmarrjeve europiane dhe mirëqenia e popullsisë. Teknologjitë miqësore ndaj mjedisit pakësojnë presionin ndaj mjedisit, ndihmojnë në krijimin e vendeve të reja të punës dhe nxisin novacionet dhe pakësojnë kostot për bizneset. Përparësitë kryesore të ETAP janë: 1) tregtimi i shpikjeve e novacioneve duke i kaluar ato nga qendrat kërkimore në treg, 2) përmirësimi i kushteve të tregut, veçanërisht nëpërmjet ofrimit të stimuljeve pozitive të tillë si kuadër rregullator mbështetës dhe lehtësim për mbështetje financiare, 3) organizimi i nismave globale me anë të veprimtarive që mbështesin vendet në zhvillim dhe nxisin FDI. Veprimtaritë kryesore që kryhen në kuadër të ETAP përfshijnë: a) përhapjen e teknologjive e praktikave më të mira në Europë e botë, b) ndërtimin e objektivave të performancës në bashkëpunim me aktorët përkatës; c) ngritjen e mekanizmave për të verifikuar vlershmërinë e teknologjive mjedisore. Veprimtaritë e ETAP financohen në varësi të natyrës së tyre nga programet e financimit si psh: FP7 e CIP.

8.3 Programet për financimin e projekteve mjedisore të NVM-ve

Në EU ekzistojnë aktualisht disa programe financimi për NVM-të, të cilat mund të paraqesin projekte në lidhje me integrimin e çështjeve mjedisore në veprimtarinë e tyre mjedisore, projekte kërkimore të qendrave të ndryshme studimore, projekte për financimin e novacioneve në fushën e teknologjive mjedisore dhe të energjive të rinovueshme. Disa prej programeve me të rëndësishme që ofrojnë financime për NVM-të janë paraqitur më poshtë.

Programi LIFE+

LIFE+ është mekanizmi kryesor i financimit të EU për të siguruar që politikat mjedisore europiane vihen në jetë. Çdo person juridik në EU mund të paraqesë një projekt propozim për tu financuar të tilla si: autoritetet publike, bizneset, institucionet private dhe OJQ-të. Edhe projektet e ECAP financohen nga ky program financimi. NVM-të janë përfitues të rëndësishëm të programeve LIFE për zhvillimin e teknikave novatore në biznes. Programi i fundit LIFE+2009 pati tre komponentë: 1) natyra dhe biodiversiteti, 2) politika dhe qeverisja mjedisore, 3) informimi dhe komunikimi mjedisor. Çdo komponent ka paketën e vet të aplikimit.

Programet për Politikat Rajonale

Programet europiane të financimit për mbështetjen e rajoneve më pak të zhvilluara janë përqendruar në dy fusha operimi: 1) në fondet të cilat emërtohen Fonde Strukturore dhe në fondet për integrimin e infrastrukturës europiane, të cilat emërtohen Fonde Kohezioni. Të dy mekanizmat në veçanti, Fondet Strukturore lejojnë më shumë për investime në projektet për mbrojtjen e mjedisit veçanërisht për NVM-të për të nxitur produktet dhe proceset e prodhimit, të cilat janë miqësorë ndaj mjedisit. Kriteret mjedisore janë përparësi për dy nga katër Fondet Strukturore: Fondi European për Zhvillimin Rajonal (ERDF) dhe Fondin Social European (FSE). Fondi i Kohezionit financon veprimtaritë për përmirësimin e mjedisit në lidhje me energjinë dhe transportin. Shembuj të projekteve të pranueshme për financim janë ato të cilat mbështesin eficientë e energjisë, energjinë e rigjenerueshme, transportin publik e hekurudhor.

Programi CIP

Programi i Konkurrueshmërisë dhe Novacionit (CIP) ka një theks të veçantë për NVM-të. Ky program kuadër është strukturuar rreth tre programeve operative: 1) programi për sipërmarrjen dhe novacionin, 2) programi për mbështetjen e politikave ICT në biznes, administratë dhe shërbime publike dhe 3) programi për energjinë inteligjente në Europë.

Programi për Sipërmarrjen dhe Novacionin mbështet novacionet në NVM-të në EU duke u fokusuar në komponentë të tillë si: a) lehtësimi në financim nëpërmjet instrumenteve financiare të CIP ku synohen NVM-të në fazat e ndryshme të tyre ciklit të zhvillimit dhe mbështet investimet në teknologji, novacion dhe ekonovacion, transferim teknologjie, dhe zgjerim të veprimtarive biznesore në zonat ndërkufitare, b) ofrim i shërbimeve biznesore nëpërmjet "Rrjetit të Ndërmarrjeve në Europë (EEN)" për ti bërë ato më konkurruese duke ofruar shërbime cilësore dhe falas, d) mbështetja e politikave në fushën e novacioneve dhe të ekonovacioneve të aktorëve dhe NVM-ve të interesuara dhe e) mbështetja e novacioneve nëpërmjet kontratave dhe granteve për projekte, studime e konferenca.

Programi për Mbështetjen e Politikave të ICT synon në stimulimin e veprimtarive biznesore të bazuara në teknologjinë e informacionit komunikimit dhe shfrytëzimin e teknologjive numerike për qytetaret, qeveritë dhe bizneset në Europë. Ndërmjet të tjerave ky program mbështet: a) ICT për shërbime të përmirësuara publike, b) ICT për eficientë e energjisë dhe c) internet shumëgjuhësh dhe evolucion informatik.

Programi Eco-Innovation (CIP)

Programi "Eko Novacion" është një nismë e EU për të ndryshuar modelet e konsumit dhe të prodhimit dhe zhvillimin e teknologjive, produkteve e shërbimeve për të pakësuar ndikimin tone në mjedis. Në këtë program lejohen të marrin pjesë institucione publike private dhe NVM edhe nga Shqipëria. Programi ka tre qëllime kryesore: (i) të mbështesë zbatimet e para dhe hyrjen në treg të teknologjive dhe praktikave novatore; (ii) të ndihmojë në krijimin e lidhjeve midis kërkimit-zhvillimit dhe biznesit dhe (iii) të ndihmojë në kapërcimin e pengesave të mbetura për hyrjen në treg të produkteve dhe shërbimeve ekonomike, veçanërisht të atyre që ndeshin NVM-të në EU. Fushat parësore në të cilat ka financuar ky program janë: a) riciklimi i materialeve, b) ndërtesat dhe materialet e ndërtimit, c) industrinë ushqimore dhe të pijeve, d) bizneset e blerjet e blerta.

Projektet në këtë program duhet të jenë novatore, dhe të paraqesin përfitime të qarta dhe thelbësore në mbështetje të politikave mjedisore të EU. Projektet duhet të tregojnë potencial për ripërsëritje, hyrje të gjerë në treg dhe zbatime të shumanshme. Projektet duhet të tregojnë performancë të lartë teknike, ekonomike dhe mjedisore.

Programi Intelligent Energy (CIP)

Objektivi i programit "Energjia Inteligjente" është të nxisë përdorimin e energjisë në mënyrë efikente dhe të burimeve të reja e të rinovueshme të energjisë në të gjithë sektorët dhe në transport. Ai fokusohet në promovimin dhe përdorimin më të gjerë të burimeve të energjive të rinovueshme, alternative e të reja si edhe përmirësimin e efikasitetit të energjisë në pajtim me kuadrin rregullator europian të energjisë. Ky program synon arritjen e treguesve europiane në lidhje me ndryshimet klimatike, shkarkimet e CO₂ dhe energjinë e rinovueshme. Ky program mbështet veprimtari të tilla si: a) trainime për teknikat e reja në ndërtim, të cilat çojnë në kursim mbi 50 përqind të energjisë, b) përmirësimin e efektivitetit të skemave mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rigjenerueshme dhe c) asistencë për qytetet europiane për transport publik më të pastër dhe përdorim eficient të energjisë. NVM-të europiane mund të aplikojnë për të marrë pjesë në këtë program, ndërsa ato shqiptare ende nuk mund të marrin ende pjesë.

Programi Green Building

Programi "Ndërtesa e Blertë" është një nismë e EU që prej vitit 2004 dhe mbështetet nga programi i EU "Intelligent Energy". Ky program synon në përmirësimin e efikasitetit të energjisë, nxitjen e investimeve për efikasitetin e energjisë dhe për teknologjitë e energjive të rinovueshme dhe zgjerimin e integritetit të energjive të rinovueshme në ndërtesat jorezidenciale në mënyrë vullnetare. Sipas vlerësimeve, sektori i ndërtesave konsumon rreth 40 përqind të kërkesës së përgjithshme për energji në Europë kështu që përmirësimi i sistemeve të ngrohjes dhe ftohjes në ndërtesa përbën një nga potencialet më të mëdha për kursim të energjisë. Për të marrë pjesë në këtë program pronarët e ndërtesave jorezidenciale duhet të: (i) të kryejnë auditimin energjistik të ndërtesave, (ii) të hartojnë planin e veprimit; (iii) të zbatojnë planin e veprimit; (iv) të tregojnë angazhim për të raportuar periodikisht konsumin e energjisë.

Programi Green Light

Programi "Drita e Blertë" është një nismë tjetër e EU që prej vitit 2000 me objektiva kryesore: (i) të pakësojë konsumin e energjisë në sistemet e ndriçimit në ndërtesat tregtare duke kontribuar në pakësimin e shkarkimeve ndotëse dhe në kufizimin e ngrohjes globale dhe (ii) të përmirësojë cilësinë e kushteve të punës në mjediset e ndërmarrjeve. Në vendet e EU, 1/3 e elektricitetit përdoret në ndërtesat tregtare dhe potenciali për kursim është tepër i lartë nga 30 deri në 50 përqind të konsumit aktual. Për të marrë

pjesë dhe për të përfituar nga ky program çdo ndërmarrje në vendet e EU vullnetarisht duhet të plotësojë disa kritere dhe kushte në mënyrë që të mund të aplikojë për asistencë financiare.

Programi Motor Challenge Programme (MCP)

Programi i Sfidës së Motorëve është një program vullnetar i EU i nisur në 2003, nëpërmjet të cilit kompanitë industriale ndihmohen për të përmirësuar efikasitetin e energjisë në sistemet e motorëve të ndërmarrjes. Kompanitë që kërkojnë të bëhen partnere në këtë program do të përfitojnë: (i) ndihmë në formulimin dhe zbatimin e një plani veprimi për të reduktuar energjinë që lidhet me operacionet e ndërmarrjes si psh. sistemet e ajrit të presuar, sistemi i ventilatorëve, sistemi i pompave dhe motorë të tjerë, ndërsa mbajnë dhe përmirësojnë besueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve e produkteve; dhe (ii) mirënjohje publike për kontributin e tyre në arritjen e objektivave të EU për politikën e mjedisit dhe energjisë.

Programi Energy Star

Programi "Energy Star" është një program vullnetar për etiketimin e pajisjeve të zyrës. Logoja Energy Star ndihmon konsumatorët të identifikojnë pajisjet e zyrës, të cilat ju kursojnë atyre para dhe ndihmojnë në mbrojtjen e mjedisit duke kursyer energjinë. Ai nisi pas një marrëveshje midis USA dhe EU për të bashkërenduar etiketimin e konsumit të energjisë për pajisjet e zyrave. Të gjithë prodhuesit, eksportuesit, importuesit, dhe shitësit më shumicë e pakicë të pajisjeve të zyrave si psh: kompjuterë, monitorë, fotokopje, projektorë, printerë, skanerë, të cilët dëshirojnë të promovojnë produktet e tyre të cilat plotësojnë kërkesat e programit mund të aplikojnë për të fituar etiketën Energy Star. Nga ky program përfitojnë konsumatorët privatë, bizneset dhe institucionet publike.

Programi Ecolabel

Programi evropian për ekoetiketimin është një skemë vullnetare e krijuar që në vitin 1992 për të nxitur bizneset për të tregtuar produkte dhe shërbime, të cilat janë miqësore me mjedisin. Produktet dhe shërbimet, të cilat fitojnë etiketën Eko mbajnë një logo me lule gjë që u lejon konsumatorëve – duke përfshirë blerësit private e publike ti identifikojnë ato lehtësisht. Në EU, Ecolabel është një markë me rritje të shpejte. Natyra vullnetare e skemës nënkupton atë që kjo nuk krijon barriera në treg. Përkundrazi shumë prodhuese e vlerësojnë atë si një faktor që u jep avantazh konkurrues.

Programi EMAS

Skema për Ekomenaxhimin dhe Auditimin (EMAS) është një instrument menaxhimi për firmat dhe organizatat e tjera për të vlerësuar, raportuar dhe përmirësuar performancën e tyre mjedisore. Aktualisht skema është e hapur për të gjitha organizatat publike e private. Në vitin 2009, Rregullorja e EMAS-it u rishikua dhe modifikua sërish dhe ka hyrë në fuqi në fillim të 2010. Për të fituar regjistrim në EMAS, çdo NVM duhet të plotësojë hapat e mëposhtëm: 1) të adoptojë një politikë mjedisore, 2) të kryejë një ekodiagnostikim duke patur në konsideratë të gjitha aspektet mjedisore, 3) të ndërtojë një sistem të menaxhimit mjedisor për të arritur politikën mjedisore të firmës, 4) të kryejë një auditim mjedisor për të vlerësuar në veçanti sistemin e menaxhimit; 5) të miratojë një deklaratë të performancës mjedisore të firmës, e cila përcakton rezultatet e arritura ndaj objektivave mjedisore; 6) Diagnostikimi mjedisor, auditimi i EMS dhe deklarata mjedisore duhet të miratohen nga një verifikues i akredituar për EMAS-in. Aktualisht janë regjistruar 4,400 organizata në EMAS.

Programi FP7

Programet Kuadër janë instrumente financiare kryesore nëpërmjet, të cilëve EU mbështet veprimtaritë kërkimore dhe zhvillimore, të cilat mbulojnë gati të gjitha disiplinat shkencore. Programi Kuadër 7 do të vazhdojë deri në vitin 2013. Qëllimi kryesor i këtij programi është të ndërtojë Zonën Europiane të Kërkimit për të krijuar një ekonomi dhe shoqëri të dijes në Europë për të patur zhvillim të qëndrueshëm. Programi FP7 është i organizuar në katër komponentë/ programe kërkimi si vijon: 1) bashkëpunimi për veprimtari kërkimore të realizuar në nivel transkombëtar, këtu përfshihet edhe bashkëpunimi midis organizatave të EU dhe vendeve të treta. Veprimtaritë nxiten nga industritë dhe janë të organizuara në katër nënprograme: a) kërkime bashkëpunimi ndërmjet rrjeteve, shoqatave, institucioneve kërkimore, b) nisma të përbashkëta në fushën e teknologjisë; c) koordinimi i programeve kërkimore jashtë EU dhe d) bashkëpunimi ndërkombëtar; 2) bashkëpunimi për gjenerimin e ideve për të rritur dinamizmin, krijimtarinë, ekselencën e kërkimit europian në të gjitha fushat shkencore e teknologjike të inxhinierisë, sociologjisë ekonomisë dhe shkencave humane. 3) bashkëpunimi për forcimin sasior dhe cilësor të burimeve njerëzore në fushën e kërkimit dhe teknologjisë; 4) bashkëpunimi për të ndërtuar kapacitetet infrastrukturore të kërkimit për NVM-të dhe rajonet si edhe për të stimuluar realizimin e një potenciali të plotë kërkimor në Europë. Programi FP7 përfshin 10 tema kryesore midis të cilave mjedisin dhe energjinë. Shqipëria është pranuar të marrë pjesë në programet e FP7.

Programi SEE-TCP

Programi për Europën Juglindore për Bashkëpunimin Transkombëtar synon të zhvillojë partneritetin transkombëtar në çështje të rëndësishme strategjike për të përmirësuar procesin e integritit territorial, ekonomik dhe social dhe të kontribuojë në kohezionin, stabilitetin dhe konkureshmërinë e rajonit. Objektivat specifike të programit janë: (i) të lehtësojë novacionet, sipërmarrjen, ekonominë e dijes dhe shoqërinë e informacionit nëpërmjet veprimeve të bashkëpunimit konkret dhe rezultateve të dukshme; (ii) të përmirësojë aftësinë tërheqëse për investime të rajonit dhe qyteteve duke marrë në konsideratë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, aksesin fizik dhe të njohurive dhe cilësinë e mjedisit më anë të përfaqësive të integruara dhe bashkëpunimit konkret dhe rezultateve të dukshme dhe (iii) të nxisë integrimin duke mbështetur kapacitetet e balancuara për bashkëpunimin transkombëtar territorial në të gjitha nivelet. Në këtë program përfshihen katër akse prioritare: 1) Lehtësimi i novacioneve dhe sipërmarrjes, 2) mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit, 3) përmirësimi i aksesueshmërisë dhe 4) zhvillimi i sinergjive transkombëtare për zonat më rritje të qëndrueshme. Fushat e ndërhyrjes për Aksin Prioritar 2 janë si vijon: 2.1 përmirësimi i menaxhimit të integruar të ujit dhe parandalimi i rrezikut të përmytjeve; 2.2 përmirësimi i parandalimit të rreziqeve mjedisore; 2.3 promovimi i bashkëpunimit në menaxhimin e pasurive natyrore dhe zonave të mbrojtura; 2.4 promovimi i efikasitetit të energjisë dhe i burimeve. Në këtë program përfshihen 16 vende të Europës Juglindore duke përfshirë edhe Shqipërinë ku organizata publike, private dhe NVM mund të marrin pjesë.

IPA Adriatic CBC Programme

Ky program synon forcimin e kapaciteteve për zhvillimin e qëndrueshëm në rajonin e Adriatikut nëpërmjet strategjive të përbashkëta të partnereve dhe territoreve të përfshira. Në këtë program përfshihen rajonet lindore të Italisë dhe rajonet e shteteve perëndimore të Ballkanit. Nga Shqipëria janë përfshirë 6 qarqet perëndimore të vendit, ku organizata publike, private dhe NVM mund të marrin pjesë. Përparësitë e këtij programi janë: 1) forcimi i sistemeve të kërkimit dhe novacionit për të lehtësuar zhvillimin e zonës së Adriatikut nëpërmjet bashkëpunimit ekonomik, social dhe institucional, 2) promovimi, përmirësimi dhe mbrojtja e burimeve natyrore dhe kulturore nëpërmjet menaxhimit të përbashkët të rreziqeve teknologjike dhe natyrore dhe 3) forcimi dhe integrimi i rrjeteve

të infrastrukturës ekzistuese, promovimi dhe zhvillimi i transportit dhe i shërbimeve të informacionit dhe komunikimit. Programe të tjera, të cilat asistojnë NVM-të në fushën e mjedisit janë: CORNET, Eureka EUROSTARS, JEREMIE dhe skema të ndryshme financimi nga Banka Europiane e Investimeve (EIB) dhe Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD).

IX Rezultatet e anketimit për performancën mjedisore të NVM-ve

9.1 Metodologjia e anketimit

Përfaqja në realizimin e këtij studimi është një kombinim i anketimeve dhe studimeve të OECD²² dhe EC në të cilat është hulumtuar për të vlerësuar qëndrimet dhe sjelljet e ndërmarrjeve dhe qytetarëve ndaj mjedisit, motivet tregtare, procedurat në marrjen e vendimeve, strukturën organizative në dobi të çështjeve të mjedisit, efektiviteti i masave dhe stimujve të politikave mjedisore në adoptimin e mjeteve e sistemeve të menaxhimit të mjedisit. Pyetësi i punës u adoptua dhe u modifikua në përputhje me objektivat e studimit dhe nivelin e njohjes së problemeve mjedisore të përfaqësuesve të biznesit në Shqipëri. Pyetësi u konsultua gjithashtu me ekspertë të fushës së mjedisit dhe efijencës së energjisë, ndërsa disa testime paraprake u kryen për të vlerësuar ecurinë e intervistimit dhe anketimit duke përdorur pyetësin.

Projekti PEPSME është projektuar të mbulojë tre qarqe të vendit: Shkodrën, Fierin dhe Beratin. Për të arritur në një besueshmëri të mirë të rezultateve të anketimit u përzgjedh një kampion prej 300 ndërmarrjesh prodhuese duke i ndarë në mënyrë të barabartë nga 100 për çdo qark. Anketimi u krye nga persona të përzgjedhur dhe të instruktuar nga ekspertët e FBV si psh: nga ARM-të, Dhomat e Tregtisë dhe zyrat e Instituti i Statistikave në këto qarqe. Shkalla e vlershmërisë dhe e rikthimit të pyetësorëve rezultoi në 83 përqind, pra u pranuan të vlerëshëm rreth 250 pyetësorë të cilët do të përpunoheshin për më tej. Pyetësorët u shpërndanë gjatë muajit tetor 2009 dhe grumbullimi i tyre u realizua gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2009. Në Pasqyrën 1 poshtë po japim shkallën e përgjigjeve nga të tre qarqet e zbatimit të projektit.

Pasqyra 6: Përqindja e kthimit të pyetësorëve sipas qarqeve

Qarqet/Rrethet	Numri i pyetësorëve të shpërndarë	Numri i pyetësorëve të kthyer e plotësuar	Norma e kthimit/vlershmërisë
Shkodra (Shkodra, M. Madhe)	100	81	81 %
Fieri (Fieri, Ballshi, Lushnja)	100	88	88 %
Berati (Berati, Kucova, Skrapari)	100	72	72 %
Gjithsej	300	241	80 %

Pyetësi është i ndarë në 6 seksione dhe përmban gjithsej 31 pyetje. Në seksionin e parë në të cilin janë formuluar 5 pyetje kërkohet të njihet shkalla e ndërgjegjësimit të personave të pyetur, përfaqësues të bizneseve në lidhje me njohjen e çështjeve të mjedisit dhe si ata reagojnë ndaj këtyre çështjeve edhe në veprimtarinë e tyre të përditshme si qytetarë. Në seksionin e dytë kërkohet të dihet se cila është shkalla e adoptimit të praktikave fillestare drejt zbatimit të plotë të sistemeve të menaxhimit duke përfshirë edhe atë të mjedisit dhe të kuptohen motivet e zbatimit të këtyre praktikave dhe sistemeve. Në seksionin e tretë në të cilin janë përfshirë 6 pyetje kërkohet të dihet shkalla e njohjes së ndikimit në mjedis të veprimtarive biznesore dhe çfarë masash konkrete kanë marrë biznesmenët për të reduktuar këto ndikime si edhe pengesat që ndeshin bizneset shqiptare për të punuar konform kuadrit ligjor e rregullator. Në seksionin e katërt janë vetëm dy pyetje, të cilat lidhen me ndikimin e aktorëve të ndryshëm në

²² OECD Business and Environment 2007


nivel kombëtar e vendor në performancën mjedisore të ndërmarrjeve dhe motivimet kryesore për të ushtruar veprimtarinë në pajtim me standardet e normat mjedisore. Seksioni i pestë përmban gjashtë pyetje nëpërmjet të cilave kërkohet të merret informacion mbi shkallën e njohjes dhe ndikimit të politikave qeveritare mjedisore në veprimtarinë prodhuese e tregtare të ndërmarrjeve. Pyetje direkte bëhen në lidhje me kuadrin ligjor mjedisor për të kuptuar se sa ai ndihmon ose pengon bizneset në veprimtarinë e tyre të përditshme. Në seksionin e gjashtë përfshihen pyetje, të cilat lidhen me kërkimin e një informacioni të përgjithshëm të biznesit si klientët, tregjet, numrin e punonjësve, të ardhurat vjetore. Pyetja e fundit lidhet direkt me interesin e pronareve dhe menaxhereve të intervistuar për tu përfshirë në mënyre aktive në veprimtaritë e projektit PEPSME.

9.2 Analiza dhe vlerësimi i përgjigjeve të pyetësorit

Seksioni I Qëndrimi ndaj mjedisit


Pyetja 1 – Sa e rëndësishme është mbrojtja e mjedisit për ju?

Në këtë seksion të pyetësorit bëhen përpjekje për të vlerësuar paraprakisht nivelin e ndjeshmërisë qytetare dhe mendimin e përgjithshëm të personave të intervistuar për mjedisin, të cilët janë përfaqësues të biznesit në qarqet e përzgjedhura. Përgjigjet e dhëna nuk është se shprehin domosdoshmërisht qëndrimin aktiv në mbrojtje të mjedisit në jetën e përditshme dhe në veprimtarinë biznesore të të intervistuarve. Shumica dërmuese, rreth 97 përqind shprehen se për ta mbrojtja e mjedisit është shumë e rëndësishme (65 përqind) dhe e rëndësishme (32 përqind), Fig 1.




Pyetja 2 – Cilat janë çështjet kryesore mjedisore për të cilat ju jeni i shqetësuar?

Në këtë pyetje përfshihen nëntë çështjet mjedisore, të cilat mendohet se ndikojnë më shumë në jetën e përditshme të njerëzve. Vlerësimi dhe rëndësia e tyre varet shumë nga niveli i njohjes së këtyre çështjeve nga personat e intervistuar. Disa prej tyre janë të lidhura drejtpërdrejt me veprimtarinë e tyre biznesore si psh: ndotja, burimet energjetike dhe mbetjet. Sipas të intervistuarve, shqetësim më të madh paraqesin ndryshimet klimatike, humbja e biodiversitetit dhe dëmtimi i relievit dhe i panoramës (17 përqind), ndotjet mjedisore që i shkaktohen ujit, ajrit dhe tokës (17 përqind), dëmtimi shëndetit të njeriut (16 përqind) dhe shtimi i madh dhe i pamenaxhueshëm i mbetjeve urbane e industriale (16 përqind), Fig 2. Çështje të tjera me ndikim të konsiderueshëm, që vlerësohen të rëndësishme janë katastrofat dhe aksidentet e shkaktuara nga njeriu dhe problemet urbane si psh. trafiku dhe ndërtimet jashtë standardeve urbanistike.




Pyetja 3 – Sa i informuar jeni ju për çështjet mjedisore përgjithësisht?

Përfaqësuesit e biznesit në tre qarqet e përzgjedhur, Shkoder, Berat dhe Fier shprehen se në përgjithësi janë të informuar për çështjet mjedisore (59 përqind), ndërkohë, që vetëm 11 përqind janë të mirinformuar. Ka një masë kritike, rreth 1/3 që është pak ose aspak e informuar, Fig 3. Informacioni për çështjet mjedisore merret kryesisht nga media e shkruar dhe e folur, legjislacioni, ARM-të dhe institucione të tjera publike e private.




Pyetja 4 – Cila nga mënyrat e progresit në Shqipëri është më e mira?

Pyetja ka lidhje me konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm. Zhvillimi ekonomik duhet të jetë i lidhur ngushtë me çështjet e zhvillimit social dhe mbrojtjen e mjedisit. Integrimi i çështjeve mjedisore në politikat e zhvillimit kombëtar është jo vetëm një kërkesë e detyrim aktual por edhe një detyrim për brezat e ardhshëm. Shumica e përfaqësuesve të biznesit (92 përqind) mendojnë se vlerësimi i zhvillimit dhe progresit në Shqipëri duhet të bëhet në mënyre të integruar mbi bazën e treguesve ekonomike, sociale dhe mjedisore së bashku, Fig 4. Vetëm një numër shumë i vogël njerëzish mendojnë se vlerësimi i zhvillimit duhet të bazohet vetëm në treguesit ekonomikë. Vlerësimi i integruar i të tria çështjeve ende nuk është praktikë e institucioneve përgjegjëse në vend. PNUD-i realizon dhe publikon çdo vit treguesin e zhvillimit njerëzor për çdo vend, por që në këtë tregues nuk përfshihen treguesit e mbrojtjes së mjedisit.



Pyetja 5 – Çfarë veprimesh keni kryer ju si qytetar për arsye mjedisore kohët e fundit?

Nëpërmjet kësaj pyetje kërkohet informacion në lidhje me qëndrimin dhe sjelljen aktuale të të intervistuarit ndaj mjedisit, shkallën e njohjes së çështjeve mjedisore dhe ndikimit të tyre në jetën e përditshme. Pyetja kërkon të paktën tre përgjigje, të cilat i korrespondojnë tre veprimeve dhe të cilat tregojnë drejtpërdrejt angazhimin qytetar në mbrojtje të mjedisit. Janë përzgjedhur shtatë alternativa, por që i intervistuari nuk është i kufizuar vetëm në to. Në nivelet nga 15 deri në 17 përqind të veprimeve, të intervistuarit janë të angazhuar në zgjedhjen e mënyrave të udhëtimit që janë miqësore ndaj mjedisit, në marrjen e masave të thjeshta në kursimin e energjisë, në blerjen e produkteve të vendit dhe në pakësimin e ndarjen e mbetjeve. Shumë pak janë të informuar të intervistuarit për rëndësinë dhe ndikimin në mjedis të pajisjeve me etiketën e gjelbër si psh. të pajisjeve shtëpiake si edhe të bioprodukteve.




Seksioni II Sistemet e menaxhimit në kompanitë shqiptare

Pyetja 6 – A keni caktuar punonjës, përgjegjës për çështjet mjedisore dhe/ose për efikasitetin në përdorimin e energjisë?


Për shkak të implikimeve të rëndësishme ligjore, rregullatore dhe të kostove sot është e domosdoshme që pavarësisht nga madhësia e ndërmarrjes menaxheret e saj duhet të emërojnë të paktën një person përgjegjës për çështjet mjedisore dhe të menaxhimit të energjisë. Nga analizat dhe studimet e fundit që janë kryer në Europë ndikimi i veprimtarive biznesore në mjedis është pak i njohur e pak i vlerësuar nga NVM-të. Kjo gjendje nuk e përjashton edhe bashkësinë e ndërmarrjeve shqiptare. Hapi i parë për njohjen dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe për mënyrën e përdorimit të energjisë në ndërmarrje është caktimi i të paktën i një personi përgjegjës, ekspert për këto çështje. Nga përgjigjet e marra rezulton se në 38 përqind të ndërmarrjeve të intervistuar është

caktuar një person, i cili është ngarkuar të merret më çështjet e ndikimit në mjedis të operacioneve të ndërmarrjes dhe më përdorimin efiçent të energjisë, ndërkohë që në 19 përqind të NVM-ve kemi vetëm një person për çështjet mjedisore dhe në 28 përqind një person në rastin më të mirë inxhinier elektrik që merret më përdorimin e energjisë. Në 15 përqind të ndërmarrjeve nuk kemi asnjë person që merret më këto çështje të rëndësishme. Shkalla e njohjes së komponentëve të sistemeve të menaxhimit të mjedisit dhe të energjisë nga këta persona ndikon shumë në nivelin e performancës e të pajtueshmërisë ligjore e mjedisore të këtyre ndërmarrjeve.



Pyetja 7 – A merrni parasysh masat e mëposhtme mjedisore gjatë veprimtarisë biznesore që kanë lidhje me furnitorët dhe blerësit?


Një nga komponentët më të rëndësishëm të pakësimit të ndikimit në mjedis për ndërmarrjet është presioni i aktoreve në të gjithë zinxhirin e krijimit të vlerës duke përfshirë këtu furnitorët dhe blerësit. Shpesh herë, vetëdija dhe përkushtimi i lartë i aktorëve të ndryshëm ndaj çështjeve mjedisore ndikojnë efektivisht në përmirësimin e performancës mjedisore dhe të pajtueshmërisë ligjore. Nga njëra anë vetë ndërmarrjet duhet të ushtrojnë presion ndaj furnitorëve të tyre, ndërkohë që nga ana tjetër blerësit dhe konsumatorët duhet të ushtrojnë presion ndaj ndërmarrjes për të përmirësuar performancën e saj. Në këto aspekte nga anketimi rezulton se kërkesa e kompanive të intervistuar për furnitorët për respektim të çështjeve mjedisore dhe për informimin e blerëseve është e ulët rreth 40 përqind e tyre nuk kanë asnjë kërkesë, ndërkohë shifrat e tjera janë të ulta. Fig 7.



Pyetja 8 – Cilat praktika janë ngritur në ndërmarrjen tuaj për komponentë të ndryshëm të menaxhimit mjedisor ?


Në Shqipëri ende ka shumë pak ndërmarrje të cilat janë certifikuar në standardet ndërkombëtare të ISO-s dhe kryesisht ndërmarrjet janë certifikuar në ISO 9000 dhe ISO 22000. Në standardin ISO14001 ende nuk ka asnjë ndërmarrje, po kështu edhe në

standardin e ri të miratuar në 2009 nga CEN për efikasitetin e energjisë EN16001. Përfaqësuesve të ndërmarrjeve kryesisht të agropërpunimit ju kërkohet të informojnë për aspekte të ndryshme të sistemeve të menaxhimit mjedisor dhe energjetik, të cilat janë të përbashkëta për sistemet kryesore të standardeve ISO. Ndërmarrjet informojnë së vetëm 1/3 e tyre kanë politika të shkruara mjedisore në të cilat deklarohet angazhimi konkret i stafeve menaxhues të ndërmarrjeve në mbrojtje të mjedisit. Ndërkohë që për monitorimin e efikasitetit të energjisë (39 përqind) nuk ka detyrim ligjor për ndërmarrjet, për monitorimin e performancës mjedisore ndërmarrjet e kanë detyrim ligjor dhe vetëm 34 përqind e tyre raportojnë se e kryejnë atë, Fig 8. Për auditimet mjedisore dhe energjetike ende nuk ka njohuri dhe vlerësim, gjë që shprehet edhe në mungesën tregut për të tilla shërbime.




Pyetja 9 – Në çfarë shkallë do ti vlerësonit motivet e arsyet e përmendura nëse do të zbatonit një sistem të menaxhimit mjedisor (ISO14001, EMAS, etj)?

Përfaqësuesit e ndërmarrjeve të intervistuar në shumicë do ta vlerësonin pozitivisht zbatimin e sistemeve të menaxhimit mjedisor në ndërmarrjet e tyre. Një sërë të mirash dhe përfitimesh ata i vlerësojnë të rëndësishme për ndërmarrjet e tyre nga 70 deri në 90 përqind, ndërkohë që vlera e standardit si mjet konkurrence bie në shifrën 56 përqind, Fig 9.. Sidoqoftë ka një korrelacion të fortë midis këtyre faktorëve motivues si psh.: kostot, imazhi, mbetjet, marrëdhëniet, pajtueshmëria ligjore me gjasat për të patur të zbatuar një SMM. Në këtë rast mund të shikohet së SMM mund të vlejë më shumë si mjet informues se sa mjet për të patur përfitime financiare dhe konkurruese.



Pyetja 10 – Në çfarë shkalle veprimtaritë biznesore me ndikim në mjedis janë integruar në praktikat e mëposhtme të menaxhimit?

Aktualisht një nga faktorët e rëndësishëm konkurrues për ndërmarrjet në Europë është certifikimi për zbatimin e standardeve të menaxhimit si psh.: të cilësisë, mjedisit, sigurisë ushqimore dhe të sigurisë në punë. Komisioni Europian nëpërmjet programeve të ndryshme si CIP Eco-Innovation nxit pjesëmarrjen e grupeve të NVM-ve për tu certifikuar në EMAS. Në Shqipëri ende nuk ka programe qeveritare dhe stimuj motivues për ndërmarrjet që të fillojnë të zbatojnë sisteme të ndryshme të menaxhimit. Komponentë të standardeve ndërkombëtare rezultojnë të zbatohen në një diapazon nga rreth 53 përqind për sigurinë ushqimore; e cila është një shifër shumë e ulët kur bëhet fjalë që shumica e ndërmarrjeve të intervistuar i përkasin sektorit të agropërpunimit; nga 40 deri në 73 përqind për komponentë të standardeve të ndryshëm si ISO për cilësinë, mjedisin, të energjisë dhe të punës e kontabilitetit, Fig 10. Bazuar në të dhënat zyrtare të ISO në fund të 2008 në Shqipëri rezultojnë të certifikuar 47 NVM, nga këto 43 në ISO 9001 dhe 4 në ISO 22000. Këto shifra janë shumë të ulta në krahasim me vendet fqinje si psh: në Malin e Zi janë certifikuar 186 kompani dhe në Maqedoni janë certifikuar 316 kompani.




Seksioni III Masat mjedisore, novacionet dhe performanca


Pyetja 11 – Në çfarë shkalle i vlerësoni ndikimet aktuale ose potenciale në mjedis të proceseve/produkteve/mbetjeve të kompanisë tuaj?

Në Europë nga studimet e fundit²³ ka rezultuar se rreth 70 përqind e NVM-ve nuk i njohin ndikimet negative të veprimtarive të tyre në mjedis. Në Shqipëri nuk kemi aktualisht ndonjë vlerësim në lidhje me këtë çështje. Sot vlerësohet se edhe konsumatori i zakonshëm më zgjedhjet që ai bën në treg ka një ndikim të konsiderueshëm në çështjet mjedisore. Pra, edhe biznesi më i thjeshtë e i zakonshëm ka ndikimin e vet negativ në mjedis. Shkalla e njohjes së ndikimeve në mjedis për elementë të ndryshëm të mjedisit është e ulët. Për shembull, përfaqësuesit e biznesit në të tre qarqet mendojnë se gjatë përdorimit të burimeve natyrore si ujë, tokë, pyje, energji e burime të tjera nuk ushtrojnë asnjë ndikim në mjedis, rreth 68 përqind e tyre dhe një grup prej 28 përqind mendojnë se ndikimi i tyre në mjedis është i ulët, Fig 11. Veprimtaritë pa asnjë lloj ndikimi, sipas të intervistuarve luhaten nga 45 deri në 68 përqind, veprimtaritë më ndikim të ulët nga 15 deri në 31 përqind, ndërsa veprimtaritë më ndikim të lartë nga 2 deri në 19 përqind.

²³ IEEP "EU Environmental compliance assistance for the SMEs" 2006




Mesatarisht vlerësohet se 53 përqind e përfaqësuesve të bizneseve shprehen se veprimtaritë e tyre duke përfshirë proceset dhe produktet e tyre nuk ka asnjë ndikim në mjedis, 25 përqind shprehen se kanë ndikim të ulët dhe vetëm 13 përqind ndikim të lartë, Fig 11/1.




Pyetja 12 – A keni marrë masa për të pakësuar ndikimet mjedisore aktuale ose potenciale që lidhen më proceset e listuara?

Nga përgjigjet e përfaqësuesve të biznesit rezulton se niveli i masave që ata kanë marrë për pakësimin e ndikimit në mjedis të veprimtarive të tyre ekonomike është i konsiderueshëm nga 55 përqind për aksidentet e mundshme deri në 73 përqind për pakësimin e përdorimit të burimeve natyrore si ujë, energji, pyje, tokë, Fig 12. Nga krahasimi i përgjigjeve të marra për pyetjet 11 dhe 12 mund të arrihet në dy përfundime: së pari ndërmarrjet deklarojnë se veprimtaritë e tyre nuk kanë ndikime në mjedis sepse veprimtaria është përmasave të vogla dhe/ose ata kanë marrë masa për ti pakësuar ato dhe së dyti ata mendojnë se nuk kanë ndikime në mjedis sepse veprimtaritë e tyre janë miqësore e të pastra gjë që mund të konsiderohet në kontradiktë më masat e deklaruar në përgjigjet e Fig 12. Sidoqoftë këtu mund të gjykohet që edhe masat që janë marrë për të pakësuar ndikimin në mjedis ndofta shpesh here nuk janë aq efikente për tu deklaruar si të tilla.



Pyetja 13 – Çfarë masash teknike e teknologjike keni marrë për të pakësuar ndikimet në mjedis, të cilat janë të ngjashme me ndryshimet e listuara ?


Sot masat më të zakonshme që ndërmarrjet marrin për të pakësuar ndikimet negative në mjedis janë: 1) ndryshime teknologjike të integruara dmth. instalime të pajisjeve e makinerive gjatë linjës së procesit të prodhimit, të cilat parandalojnë ose pakësojnë shkarkimet ndotëse dhe/ose përdorimin e burimeve që përdoren si psh. lëndë të para e ndihmëse, energji elektrike ose energji të prodhuar nga burime të tjera, në këtë lloj ndërhyrjeje ose investimi 57 përqind e ndërmarrjeve raportojnë se kanë marrë masa të tilla, Fig 13; 2) ndryshime teknologjike fundore dmth. instalim të pajisjeve fundore, të cilat operojnë në fund të procesit të prodhimit për të parandaluar, pakësuar, trajtuar, rigjeneruar dhe ose ricikluar shkarkimet ndotëse; kështu vetëm 37 përqind e përfaqësuesve të ndërmarrjeve raportojnë se kanë marrë masa të tilla; 3) ndryshime teknologjike, të cilat përmirësojnë karakteristikat e produkteve që prodhohen, 11 përqind e NVM-ve, në të cilat përfshihen mënyra të reja projektimi, paketimi, përdorim të kimikateve e produkteve miqësore ose më pak ndotëse ndaj mjedisit, përdorimit të lëndëve të reja të para e ndihmese të cilat janë prodhuar nga burime të ripërtitshme e të pastra.



Pyetja 14 – Çfarë pengesash ndeshen nga ndërmarrjet për të ushtruar veprimtarinë e tyre në pajtim me legjislacionin mjedisor?


Për të kapërcyer një numër pengesash e vështirësish, EC ka projektuar dhe vënë në zbatim një numër programesh, të cilat kanë si qëllim kryesor përmirësimin e performances mjedisore dhe pajtueshmërie ligjore të NVM-ve. Programet përfshinë

mbështetjen financiare dhe teknike të NVM-ve. Në programin Eco-Innovation (CIP) mund të marrin pjesë edhe NVM-të shqiptare, të cilat dëshirojnë të bëjnë përmirësime teknologjike në proceset dhe produktet e tyre. Në rastin e NVM-ve shqiptare pengesat kryesore që ata shprehin janë mungesa e burimeve financiare në 54 përqind të NVM-ve të intervistuar, mungesë dijesh në përfitimet që vijnë nga zbatimi i standardeve për mjedisin ISO14001 dhe EMAS në 41 përqind të tyre dhe mungesa e informacionit mjedisor për bizneset në 32 përqind, Fig14. Çështje të tjera që shqetësojnë NVM-të janë mungesa e njohurive dhe e asistencës teknike për çështjet mjedisore në 29 përqind të tyre.




Pyetja 15 – Cilat burime energjetike përdoren në kompaninë tuaj?

Shqipëria ka një varësi të madhe që arrin deri në 95 përqind nga energjia elektrike e prodhuar nga burimet hidrike. Duke qenë një varësi e tillë edhe ndërmarrjet e vogla e të mesme do të përdorin më shumë këtë lloj energjie. Nga anketimi rezulton që shkalla e përdorimit të energjisë elektrike arrin deri në 80 përqind, energjia e prodhuar nga nafta e karburante të tjerë dhe gazi i lëngshëm është rreth 7 përqind. Si lëndë e rëndësishme energjetike është ende druri, i cili zë 4 përqind. Energjitë e tjera alternative si ajo diellore dhe e erës zënë ende një përqindje të ulët ndërmjet NVM-ve, Fig 15. Në lidhje me përgjigjen e dhënë kësaj pyetje mund të sqarojmë që shpesh herë përgjigjet janë dhënë pa patur parasysh konsumin dhe shpenzimet për lëndët djegëse si naftë, solar, gaz i lëngshëm për qëllimet e biznesit dhe ekuivalentimin e prodhimit të kësaj energjie (toe) në kWorë për të patur një pasqyrim më të saktë të ndarjes së burimeve dhe të konsumit të energjisë në përgjithësi.




Pyetja 16 – Për çfarë qëllimi e përdorni energjinë që konsumoni në ndërmarrjen tuaj?

Në varësi të llojit të ndërmarrjes ndryshon edhe konsumi i energjisë. Ndërmarrjet e intervistuar kryesisht janë ndërmarrje të agropërpunimit në të cilat kuptohet që konsumi më i madh do të jetë në sistemin e motorëve, kompresorëve e pompave. Pra, kryesisht energjia përdoret në sistemin e motorëve në 75 përqind, në sistemin e ndriçimit 12 përqind dhe në sistemin ngrohjes 9 përqind në autoklavat, pasterizatorët dhe furrat, Fig 16.



Pyetja 16/1 – Cilat janë pengesat kryesore që ndeshen për të përdorur në mënyre më efçente energjinë që konsumoni në ndërmarrjet tuaja?

Përfaqësuesit e ndërmarrjeve, rreth 22 përqind e tyre, raportojnë se problemet më të mëdha në përdorimin me efçencë dhe kursim të energjisë e kanë burimin në çmimet monopol në sektorin e energjisë si edhe të lëndëve djegëse si naftë, solar e gaz të lëngshëm, Fig 16/1. Problem paraqesin vështirësitë në financim dhe kreditim (18 përqind) për përmirësime të teknologjive të prodhimit, kuadri rregullator i papërshtatshëm për këtë çështje dhe mungesa e informacionit dhe e ekspertizës.




Seksioni IV Ndikimi i aktorëve të interesuar dhe motivimi mjedisor

Pyetja 17 – Sa të rëndësishme e konsideroni ju ndikimin e organizatave dhe grupeve të interesit në praktikat mjedisore të kompanisë suaj?


Rol shumë të rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e praktikave mjedisore të NVM-ve luajnë qeveria dhe inspektorati i mbrojtjes së mjedisit. Ndërkohë sipas të intervistuarve të NVM-ve, rol më ndikim të konsiderueshme luajnë konsumatorët dhe furnitorët e

ndërmarrjeve. Nga anketimi rezulton që ndikimi i organizatave të mjedisit, shoqatave dhe organizatave të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare është më i dobët së e aktoreve të tjerë në përqindje zbret deri në 60 përqind, Fig. 17.



Pyetja 18 – Sa të rëndësishme janë motivet e mëposhtme, të cilat ndikojnë në praktikat mjedisore të kompanisë tuaj?


Përfaqësuesit e shoqërive tregtare shqiptare të intervistuar vlerësojnë të rëndësishme motivet kryesore siç tregohet në Grafikon 18 poshtë. Mbi 90 përqind e tyre shprehen se në praktikat e tyre të prodhimit e tregtimit janë të rëndësishme imazhi i kompanisë, parandalimi i aksidenteve, pajtueshmëria rregullatore, ulja e kostove dhe zhvillimi i teknologjive të reja. Motivët, të cilat nisen nga praktikat e kompanive të ngjashme bien deri në 68 përqind.



Seksioni V Politikat publike mjedisore


Pyetja 19 – Si i vlerësoni politikat dhe mekanizmat mjedisore në veprimtarinë e kompanisë suaj?

Për kompanitë shqiptare standardet e bazuar në performancë dhe norma janë të rëndësishme gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre të prodhimit, të shërbimit ose të tregtisë. Shumica e kompanive i vlerëson këto dy tregues mbi 90 përqind, Fig. 19 poshtë. Peshë të rëndësishme luajnë politikat rregullatore dhe shtrënguese si taksat dhe gjobot, dhe lejet. Në Shqipëri ende kompanitë janë larg arritjes së marrëveshjeve dypalëshe e shumëpalëshe në lidhje me veprimtaritë biznesore të cilat kanë ndikim në mjedis.



Pyetja 20 – Tregoni se çfarë politikash/mekanzmash/programesh zbatohen nga autoritetet rregullatore (qeveria/agjencitë shtetërore) për të nxitur aplikimin standardeve ndërkombëtare të menaxhimit mjedisor (ISO14001, EMAS)?


Përfaqësuesit e kompanive shqiptare të intervistuar shprehen pozitivisht në lidhje me përparësitë që do të ofronte certifikimi i kompanive të tyre në ISO 14001 ose EMAS sidomos në drejtim të përshejtitimit të lejes mjedisore, lehtësim të rregullave mjedisore dhe pakësimit të inspektimeve mjedisore. Ndërkohë institucionet qeveritare kanë ende mundësi të kufizuara për asistencë teknike dhe mbështetje financiare për kompanitë shqiptare dhe sipas të të intervistuarve kjo mbështetje shkon vetëm për 35 përqind të ndërmarrjeve të marra në anketim. Po kështu avantazhi që mund të siguronte certifikimi në ISO në prokurimet publike mbështet deri në masën 38 përqind e totalit të ndërmarrjeve të anketuara.



Sipas vrojtimit të ISO-s në fund të vitit 2008 asnjë kompani shqiptare nuk ishte certifikuar në ISO14001. Kryesisht kompanitë shqiptare janë të certifikuara në ISO9001 dhe ISO22000, por numri i tyre është shumë i vogël në krahasim me vendet e rajonit.


Pyetja 21 – Tregoni se cilat ligje nga fusha mbrojtjes së mjedisit ose e energjisë i konsideroni favorizues/lehtësues për biznesin tuaj?

Shkalla e njohjes së legjislacionit mjedisor nga NVM-të është e ulët, sidomos ai që lidhet direkt me veprimtarinë specifike të ndërmarrjes. Shumica e NVM-ve ose 2/3 nuk përmendin asnjë ligj nga fusha e mjedisit, ndërkohë që 1/3 përmend vetëm ligjin kuadër për mbrojtjen e mjedisit, Fig 21.




Pyetja 22 – Tregoni se cilat ligje nga fusha mbrojtjes së mjedisit ose e energjisë i konsideroni pengues/burokratik për biznesin tuaj?

Shumica e kompanive shprehen se legjislacioni mjedisor nuk luan aspak rol në veprimtarinë e tyre prodhuese e tregtare, 86 përqind e tyre. Mqs. një pjesë e kompanive janë të detyruar të pajisjen me leje mjedisore shprehen se ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedisi ushtron një lloj kufizimi, në 13 përqind të tyre.




Pyetja 23 – Si do ta përshkruanit regjimin dmth. shkallën e ashpërsisë të ligjeve mjedisore në të cilët përfshihet edhe kompania juaj ?

Shumica e kompanive shqiptare, rreth 60 përqind e tyre besojnë se regjimi dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore në lidhje me mjedisin janë të buta dhe NVM-të i plotësojnë ato më lehtësi relative, Fig 23. Pak më shumë së një treta e tyre mendojnë se regjimi ligjor mjedisor është i fortë dhe për të qënë në pajtim me të duhen përmirësime teknike e teknologjike dhe ndërhyrje menaxheriale.



Pyetja 24 – Sa herë kompania juaj është inspektuar nga autoritetet publike/ inspektorati i mjedisit gjatë tre viteve të fundit ?

Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të intervistuar rezultojnë se 45 përqind e tyre janë inspektuar më shumë se katër herë në tre vitet fundit. Ndërkohë rregullisht një herë në vit janë inspektuar vetëm 13 përqind e ndërmarrjeve dhe 17 përqind e tyre asnjëherë. Inspektimet mjedisore varen shumë nga lloji i veprimtarive të ndërmarrjeve. Në fakt nga Ministria e Mjedisit nuk ka ndonjë rregullore të përcaktuar së sa here në vit ose disa vjet ndërmarrjet duhen inspektuar.




Seksioni VI Karakteristikat e kompanive

Shumica e ndërmarrjeve të intervistuar rreth 85 përqind e tyre i përkasin kategorisë C të NACE-s, dmth industrisë ushqimore. Ndërmarrjet tjera i përkasin kategorive të tjera si prodhimi i materialeve të ndërtimit, përpunimi i drurit, prodhimi i veshjeve.


Pyetja 25 – Cilët janë klientët kryesorë të kompanisë suaj?

Klientët kryesorë të ndërmarrjeve të intervistuar janë tregtarë në 70 përqind të rasteve, ndërsa kompani të tjera prodhuese përbejnë më pak së një e katërta e numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve, Fig 25.




Pyetja 26 – Cila është shtrirja e tregut tuaj?

Klientët kryesorë janë ndërmarrjet tregtare vendore të qytetit ose të qarkut në Berat, Shkoder dhe Fier. Vetëm 30 përqind e ndërmarrjeve i shesin produktet e tyre jashtë qarkut dmth. kanë një treg më të madh i cili mund të konsiderohet kombëtar. Vetëm 12 përqind e ndërmarrjeve kanë mundësi të eksportojnë në vendet fqinje ose edhe në vendet e Bashkimit Europian, Fig 26.




Pyetja 27 – Si do ti vlerësonit faktorët konkurrues të mëposhtëm për produktin kryesor të kompanisë suaj në tre vitet e fundit?

Përfaqësuesit e kompanive të intervistuar i vlerësojnë shumë lart faktorët konkurrues si psh.: çmimin dhe cilësinë e produktit, imazhin e kompanisë dhe marrëdhëniet me blerësit. Këta faktorë në mbi 95 përqind të ndërmarrjeve vlerësohen të rëndësishëm dhe shumë të rëndësishëm, Fig 27.



Pyetja 28 – Mesatarisht sa punonjës ka patur kompania juaj në vitin e fundit ?

Duke u mbështetur në përkufizimin european, shumica e ndërmarrjeve në anketim janë shumë të vogla (me deri në 9 punonjës) 61 përqind e tyre dhe të vogla vetëm një e treta e tyre (më të punësuar deri në 49 punonjës). Fig 28.




Pyetja 29 – Afërsisht sa ka qënë xhiroja vjetore ne EURO e kompanisë suaj në vitin e fundit ?

Duke u mbështetur në përgjigjet e marra rezulton se 65 përqind e ndërmarrjeve të anketuara kanë një xhiro vjetore deri në €100,000 EUR, ndërkohë që 29 përqind e ndërmarrjeve kanë një xhiro nga €100,000 deri në €5,00,000 EUR. Vetëm 6 përqind e ndërmarrjeve kanë një xhiro vjetor mbi €500,000 EUR, Fig 29.




Pyetja 30 – Cilat janë dhe sa produkte prodhohen në ndërmarrjen tuaj ?

Kompanitë shqiptare në përgjithësi janë të përqendruar në një numër të kufizuar produktesh, të cilët në përgjithësi janë tradicionale nëse i referohemi industrisë ushqimore. Vetëm 37 përqind e tyre prodhojnë nga tre e më shumë produkte. Kjo lidhet gjithashtu me nivelin e prapambetur teknologjik të kompanive dhe tregun e parafinuar shqiptar në përgjithësi.



Pyetja 31 – A do të ishit i interesuar që përfaqësues të kompanisë tuaj të merrnin pjesë në ndonjë program të asistencës teknike?

Për shumicën e kompanive shqiptare koncepti i auditimit nuk njihet, pavarësisht se ka një shumicë ndërmarrjesh që dëshirojnë të marrin pjesë në ekodiagnostikim dhe auditime, 61 përqind e tyre, Fig 31. Siç kemi përmendur edhe më sipër vetëm shumë pak kompani shqiptare janë të certifikuara në ISO, gjë që kërkon pastaj auditimin e sistemeve.



X Gjetjet dhe përfundimet kryesore

Për kryerjen e këtij studimi u përdoren dy burime kryesore informacioni: hulumtimi i studimeve e raporteve të vendit dhe të huaja dhe i legjislacionit shqiptar dhe europian në lidhje me sjelljen dhe qëndrimin e NVM-ve ndaj mjedisit dhe analiza e anketimit të rreth 250 NVM-ve në qarqet e përzgjedhura të Beratit, Fierit dhe Shkodrës. Në këtë seksion të studimi do të paraqesim gjetjet dhe konkluzionet kryesore nga studimi në zyrë dhe në terren.

10.1 Gjetjet kryesore nga studimi i informacionit aktual për çështjet mjedisore të NVM-ve

- Në vitet e fundit është krijuar një kuadër ligjor i përshtatshëm për ushtrimin e veprimtarisë biznesore të NVM-ve shqiptare në përputhje me detyrimet mjedisore të tyre. Promocioni i informacionit mjedisor për NVM-të, përfshirë këtu edhe promocionin i legjislacionit mjedisor është i pakët dhe njohuritë dhe dijet mjedisore dhe ndikimi mjedisor për pasojë janë pak të njohura për NVM-të.
- Përveç disa programeve specifike për mbështetjen financiare të NVM-ve, nga qeveria shqiptare dhe donatorët nuk ka patur deri tani ndonjë program të veçantë për mbështetjen e NVM-ve për të rritur performancën mjedisore dhe pajtueshmërinë ligjore të tyre. Deri në fund të vitit 2008 nuk ka asnjë NVM shqiptare të certifikuar në ISO14000 gjë që tregon për pavëmendje dhe përgjegjshmëri të ulët të menaxhereve të NVM-ve në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe mungesën e programeve qeveritare e të donatoreve në këtë fushë.
- Realisht ndërmjet Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit nuk ka ndonjë dallim në kompetenca dhe përgjegjësi në qarqe, pavarësisht se në dispozitat ligjore përkatëse ka dallime të dukshme. Në Agjencitë Rajonale të Mjedisit duhet bërë një ndarje e qartë e kompetencave dhe e detyrave ndërmjet ekspertit të mjedisit dhe inspektorit të mjedisit. Ndofta duhet ndjekur shembulli tipik i ndarjes së punëve psh. midis Agjencive Rajonale të Punësimit dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës.
- Një numër i konsiderueshëm i NVM-ve nuk i njohin ndikimet e tyre aktuale dhe potenciale në mjedis të veprimtarive të tyre prodhuese e tregtare. Kjo gjendje vjen edhe si pasojë e politikave të mosshtrëngimit për aplikim për leje mjedisore në organet përkatëse. Personeli i ARM-ve dhe IMM duhet të jetë shumë aktiv në nxitjen e NVM-ve për tu pajisur me leje mjedisore dhe për tu angazhuar kështu në përmirësimin e performancës së tyre ndaj mjedisit.
- Edhe në rastet kur NVM-të janë të pajisura me leje mjedisore, kushtet dhe kriteret në lejen mjedisore përmbushen pjesërisht, për më shumë monitorimi i shkarkimeve të tyre në ajër, ujë dhe tokë dhe menaxhimi i përshtatshëm i mbetjeve industriale nuk është efektiv dhe real. Për një shumicë të NVM-të, kostoja e kryerjes së analizave të monitorimit të shkarkimeve është e lartë.
- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave nuk ka aktualisht programe specifike për rritjen e kapaciteteve profesionale të personelit të ARM-ve dhe të IMM. Një numër zyrash të ARM/IMM në qarqe nuk janë të papërshtatshme dhe nuk janë të pajisura me mjete dhe pajisje zyre. Mbështetja teknike dhe financiare për inspektimet në biznese është e pamjaftueshme, duke renditur mungesën e

automjeteve, mjeteve dhe uniformave të mbrojtjes në punë dhe të kompensimeve për inspektorët e mjedisit.

- Megjithë vlerësimet pozitive në lidhje me disa nga treguesit e Kartës për Bizneset e Vogla nga ana e OECD për Qeverinë Shqiptare, ende nuk ka programe të qarta në lidhje me zbatimin e parimeve të Aktit për Biznesin e Vogël nga Qeveria shqiptare të trupëzuara në politikat për mbështetjen e NVM-ve. Një nga parimet e rëndësishme në mbështetje të NVM-ve është shndërrimi i sfidave mjedisore në mundësi biznesi për NVM-të gjë që kërkon asistencë të kualifikuar e të shumëanshme.
- Politikat shtetërore në lidhje me taksat mjedisore janë të pamjaftueshme. Përdorimi i politikave fiskale për të përmirësuar dhe zbatuar kuadrin ligjor rregullator dhe për rrjedhojë përmirësimin e performancës mjedisore të NVM-ve ende mungon. Mungojnë stimujt e fuqishëm fiskale në përdorimin e gazit të lëngshëm për industrinë, për biokarburantet, për produktet dhe lëndët e para ekologjike, për materialet paketuese ekologjike.
- Qeveria shqiptare së bashku me institucionet përgjegjëse nuk kanë hartuar ndonjë program/projekt për të mbështetur rrjetet rajonale të NVM-ve për të lehtësuar regjistrimin në ISO ose EMAS. Vlera e regjistrimit në ISO ose EMAS si një mjet marketingu e konkurrence duhet të rritet e fuqizohet nëpërmjet fushatave për të rritur ndërgjegjësimin publik dhe të NVM-ve në lidhje me mbrojtjen e mjedisit.
- NVM-të shqiptare në përgjithësi përdorin makineri dhe pajisje të cilat janë të brezave të vjetër dhe të përdorura që do të thotë se ato nuk kanë të integruar në linjat teknologjike pajisje për pakësimin e ndotjeve në ajër, në ujë dhe tokë dhe për riciklimin e mbetjeve të tyre. Po kështu, shumë pak NVM kanë të instaluar pajisje fundore për pakësimin e ndotjeve. Në shumë NVM, përdorimi i lëndëve djegëse të rënda si mazut, solar dhe naftë dhe i automjeteve të vjetër për transport është problematik për mjedisin.
- Pjesëmarrja e NVM-ve shqiptare në programet europiane në fushën e mjedisit është tepër e ulët si psh: në programet Eco-Innovation, FP7, SEE-TCP dhe IPA Adriatic. Kjo për shkak të mungesës së programeve mbështetëse dhe kapacitetit të pamjaftueshme të NVM-ve për t'ju përgjigjur kërkesave dhe kriterëve të pjesëmarrjes në këto programe. Në programe të tjera të EU që kanë përparësi çështjet mjedisore dhe të energjisë institucionet dhe NVM-të shqiptare nuk mund të marrin pjesë për shkak të mosplotësimit të kushteve të pjesëmarrjes nga Qeveria Shqiptare si psh në Intelligent Energy, LIFE+, Green Building, Green Light.

10.2 Gjetjet kryesore nga anketimi i NVM-ve për çështjet mjedisore

Siç kemi përmendur anketimi u përqendrua në tre qarqet Berat, Fier dhe Shkodër dhe rreth 250 përfaqësues të NVM-ve u intervistuan dhe iu përgjigjen pyetjeve të pyetësorit të përgatitur nga ekspertët e SBF. Rezultatet kryesore nga ky anketim i kemi përmbledhur si më poshtë.

- Shumica absolute e përfaqësuesve të NVM-ve të intervistuar, 97 përqind, e vlerësojnë shumë të rëndësishëm dhe të rëndësishëm mbrojtjen e mjedisit dhe sipas tyre shqetësim i madh për ta është ndotja e ujit, ajrit dhe tokës (17 përqind e të anketuarve), dëmtimi i relievit/peisazhit dhe humbja e biodiversitetit (17 përqind), dëmtimi shëndetit të njeriut (16 përqind) dhe menaxhimi i mangët i mbetjeve urbane e industriale (16 përqind).

- Megjithëse shumica e të anketuarve, 70 përqind e tyre, pohojnë se janë shumë të informuar dhe të informuar për çështjet e mbrojtjes së mjedisit, përsëri ka një masë kritike të përfaqësuesve të biznesit rreth 30 përqind, të cilët shprehen se janë pak të informuar në përgjithësi për çështje të mjedisit, për ndikimet e veprimtarive të tyre biznesore në mjedis si edhe për çështje, të cilat lidhen më mbrojtjen e mjedisit.
- Për vite të tëra çështjet dhe problemet mjedisore nuk merreshin fare në konsideratë gjatë zbatimit të politikave të zhvillimit të vendit. Pas viteve 1990, filloi një rritje ndërgjegjës qytetare për të reaguar pozitivisht ndaj problemeve mjedisore. Megjithëse, ka zhvillime pozitive në drejtim të sjelljes dhe qëndrimit qytetar ndaj mjedisit përsëri shtetasit shqiptarë janë ende larg standardeve të sjelljes europiane ndaj mjedisit. Të pyetur për qëndrimin dhe sjelljen e përditshme ndaj mjedisit rreth 19 përqind e tyre shprehen se zgjedhin mënyra miqësore ndaj mjedisit për udhëtim, 17 përqind pohojnë se kanë marrë masa për kursimin dhe pakësimin e konsumit të energjisë elektrike, 16 përqind pohojnë se fokusohen në blerjen e produkteve vendore dhe 15 përqind shmangin produktet që prodhojnë shumë mbetje.
- Rreth 94 përqind e bizneseve të anketuar konsiderohen ndërmarrje të vogla më deri në 49 punonjës, por në shumicën e tyre 61 përqind janë shumë të vogla më deri 9 punonjës. Për këtë shkak është shumë vështirë që një ndërmarrje e vogël të përballojë financiarisht punësimin e një eksperti të mjedisit dhe/ose të energjisë. Rreth 38 përqind e ndërmarrjeve pohojnë se kanë caktuar një person përgjegjës si për mjedisin ashtu edhe për energjinë, ndërsa 19 përqind e tyre vetëm një person përgjegjës për çështjet mjedisore dhe 28 përqind vetëm për çështjet e energjisë. Rreth 15 përqind e NVM-ve nuk kanë të punësuar asnjë person përgjegjës për çështjet mjedisore dhe/ose të energjisë. Në një anketim të zhvilluar në Europë²⁴ në 2009, rreth 40 përqind e ndërmarrjeve shumë të vogla dhe 60 përqind e ndërmarrjeve të vogla kishin një person përgjegjës për energjinë, i cili ishte person specifik ose bënte pjesë në stafin menaxhues të ndërmarrjes.
- Në krijimin e vetëdijes dhe përgjegjshmërisë publike mjedisore kontribuon jo vetëm krijimi i vetëdijes personale por edhe ndikimi e presioni i aktoreve të tjerë për këtë çështje. Në rastin e këtij anketimi 41 përqind NVM-ve nuk kanë asnjë pretendim ose nuk ushtrojnë asnjë ndikim tek furnitorët dhe tek blerësit, vetëm 16 përqind e NVM-ve ushtrojnë një lloj presioni ose ndikimi ndaj furnitorëve për çështjet mjedisore, ndërkohë që vetëm 8 përqind e NVM-ve informojnë blerësit për ndikimin në mjedis të produkteve të tyre.
- Megjithëse deri në fund të 2008 nuk kishte asnjë ndërmarrje shqiptare të certifikuar në ISO14000, komponentë dhe praktika, të cilat janë pjesë përbërëse e standardit kanë filluar të zbatohen nga NVM-të. Kështu përfaqësuesit e NVM-ve pohojnë se marrin pjesë në seminare e konferenca, të cilat kanë lidhje më çështjet mjedisore, rreth 43 përqind e të anketuarve, 39 përqind pohojnë se kryejnë monitorime të konsumit të energjisë, 36 përqind e NVM-ve raportojnë se punonjësit e tyre kanë ndjekur trainime specifike për mjedisin dhe 34 përqind monitorojnë performancën mjedisore. Rreth 33 përqind e ndërmarrjeve pretendojnë se kanë politika të shkruara mjedisore, e cila është një nga kërkesat kryesore të ISO 14000 dhe EMAS. Në lidhje më diagnostikimet dhe auditimet energjike e mjedisore asnjë ndërmarrje nuk ka kryer të tilla. Në Europë në vende si Austria, Gjermania dhe Belgjika ku kompanitë

²⁴ Eurochambers: Change Project "Energy Efficiency in SMEs" 2008-2010

përfitojnë fonde publike për kryerjen e auditimeve nëpërmjet shoqërive të konsulencës ESCO, përqindja e kompanive që kryejnë auditime të brendshme energjetike arrin nga 40 deri në 50 përqind.

- Përfaqësuesit e NVM-ve mendojnë se motivet që do ti nxisnin ata të zbatonin një nga standardet për mjedisin ISO14000 ose EMAS do të ishin parandalimi dhe kontrolli i mbetjeve (90 përqind), përmirësimi i imazhit të kompanisë (85 përqind), përmirësimi i pajtueshmërisë ligjore (83 përqind). Motivet e tjera si përmirësimi i marrëdhënieve me inspektoratet, ulja e kostove të menaxhimit të mbetjeve dhe pakësimi i konsumit të energjisë janë në diapazonin nga 77 deri në 79 përqind të NVM-ve.
- Në Shqipëri ende nuk ka programe qeveritare dhe stimuj motivues për ndërmarrjet që të fillojnë të zbatojnë sisteme të ndryshme të menaxhimit. Komponentë të standardeve ndërkombëtare rezultojnë të zbatohen në një diapazon rreth 50 përqind për sigurinë ushqimore; gjë është një shifër shumë e ulët kur bëhet fjalë që shumica e ndërmarrjeve të intervistuarra i përkasin sektorit të agropërpunimit; nga 40 deri në 70 përqind për komponentë të standardeve të ndryshëm si ISO për mjedisin (63 përqind), për cilësinë (63 përqind), të energjisë (75 përqind) dhe të standardeve të ILO-s për punësimin (61 përqind) dhe të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit (41 përqind).
- Shkalla e njohjes së ndikimeve në mjedis për elemente të ndryshëm të mjedisit është e ulët. Përfaqësuesit e biznesit në të tre qarqet mendojnë se gjatë përdorimit të burimeve natyrore si ujë, tokë, pyje, energji nuk ushtrojnë asnjë ndikim në mjedis mesatarisht rreth 53 përqind e tyre dhe një grup prej 25 përqind mendojnë se ndikimi i tyre në mjedis është i ulët dhe vetëm 13 përqind i lartë.
- Përfaqësuesit e NVM-ve pohojnë e pretendojnë se niveli i masave që ata kanë marrë për pakësimin e ndikimit në mjedis të veprimtarive të tyre ekonomike është i konsiderueshëm dhe mesatarisht vlerësohet se 60 përqind e tyre kanë marrë masa në mbrojtje të mjedisit si psh: për pakësimin e ndotjes së tokës dhe ujërave nëntokësore, për shmangien e dëmtimit të peizazhit, për pakësimin e ndotjes së ajrit, të shkarkimeve të mbetjeve të ngurta e të lëngëta dhe të përdorimit të burimeve natyrore.
- Të pyetur për aspektet teknike e teknologjike të investimeve të tyre në mbrojtje të mjedisit dhe për përmirësimin e performancës së tyre mjedisore, 57 përqind e NVM-ve pretendojnë se kanë marrë masa që kanë çuar në përmirësime teknologjike të integruara, 37 përqind kanë marrë masa për përmirësime teknologjike fundore për mbrojtjen e mjedisit përreth objektit të veprimtarisë biznesore dhe 11 përqind kanë ndërhyrë në përmirësime mjedisore të produktit si në projektim, paketim, përdorim të materialeve ndihmese e paketuese e lëndëve të para më pak të dëmshme për mjedisin. Vetëm 7 përqind e NVM-ve pohojnë se nuk kanë marrë asnjë masë.
- Pengesat kryesore që NVM-ve shqiptare ndeshin për të punuar në pajtim me legjislacionin mjedisor kombëtar janë mungesa e burimeve financiare në 54 përqind të NVM-ve të intervistuarra, mungesë dijesh në lidhje me përfitimet që vijnë nga zbatimi i standardeve për mjedisin ISO14001 dhe EMAS në 41 përqind të tyre dhe mungesa e informacionit mjedisor për bizneset në 32 përqind. Çështje të tjera që shqetësojnë NVM-të janë mungesa e njohurive dhe e asistencës teknike për çështjet mjedisore në 29 përqind të tyre.

- Përfaqësuesit e ndërmarrjeve, rreth 22 përqind e tyre, raportojnë se problemet më të mëdha në përdorimin me efikasitet dhe kursim të energjisë e kanë burimin në çmimet monopol në sektorin e energjisë elektrike si edhe të lëndëve djegëse si naftë, solar e gaz të lëngshëm. Problem paraqesin vështirësitë në financim dhe kreditim për 18 përqind të NVM-ve për përmirësime të teknologjive të prodhimit, kuadri rregullator i papërshtatshëm për këtë çështje për 17 përqind dhe mungesa e informacionit për 14 përqind dhe e ekspertizës për 10 përqind të NVM-ve.
- Rol shumë të rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e praktikave mjedisore sipas pronareve dhe menaxhereve të NVM-ve luajnë qeveria (98 përqind) dhe inspektoratet (97 përqind), duke përfshirë këtu edhe inspektoratin e mjedisit. Ndërkohë sipas të intervistuarve të NVM-ve, ndikim të konsiderueshëm luajnë konsumatorët dhe furnitorët e ndërmarrjeve (80 përqind). Institucionet donatore dhe bankat ndikojnë në masën rreth 70 përqind në grupin e NVM-ve të intervistuar. Nga anketimi rezulton që ndikimi i organizatave të mjedisit, shoqatave dhe organizatave të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare është më i dobët se i aktoreve të tjerë, në përqindje zbritet deri në 60 përqind.
- Përfaqësuesit e kompanive shqiptare të intervistuar shprehën pozitivisht në lidhje me përparësitë që do të ofronte certifikimi i kompanive të tyre në ISO 14001 ose EMAS, sidomos në drejtim të përshpejtitimit të marrjes së lejes mjedisore (66 përqind), lehtësimit të rregullave mjedisore (58 përqind) dhe pakësimit të inspektimeve mjedisore (52 përqind). Ndërkohë institucionet qeveritare kanë ende mundësi të kufizuara për asistencë teknike dhe mbështetje financiare për kompanitë shqiptare dhe sipas të të intervistuarve kjo mbështetje shkon vetëm për 35 përqind të ndërmarrjeve të marra në anketim. Po kështu avantazhi që mund të siguronte certifikimi në ISO/EMAS në prokurimet publike mbështet deri në masën 38 përqind e totalit të ndërmarrjeve të anketuara.
- Shkalla e njohjes së legjislacionit mjedisor nga NVM-të është e ulët, sidomos ai që lidhet direkt me veprimtarinë specifike të ndërmarrjes. Shumica e NVM-ve ose 2/3 e tyre nuk përmendin asnjë ligj nga fusha e mjedisit, ndërkohë që 1/3 përmend vetëm ligjin kuadër për mbrojtjen e mjedisit duke e konsideruar atë favorizues. Shumica e NVM-ve (86 përqind) shprehën se legjislacioni mjedisor nuk luan aspak rol pengues në veprimtarinë e tyre prodhuese e tregtare. Mqs. një pjesë e kompanive janë të detyruar të pajisjen me leje mjedisore, përfaqësuesit e NVM-ve shprehën se ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis ushtron një farë kufizimi në 13 përqind të tyre.
- Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të intervistuar rezulton se 45 përqind e tyre janë inspektuar më shumë se katër herë në tre vitet fundit. Ndërkohë rregullisht një herë në vit janë inspektuar vetëm 13 përqind e ndërmarrjeve dhe 17 përqind e tyre asnjëherë. Inspektimet mjedisore varen edhe nga lloji i veprimtarive të ndërmarrjeve, përkushtimi i inspektorateve rajonale dhe burimet e mundësitë teknike, financiare e njerëzore të inspektoratit të mbrojtjes së mjedisit.
- Për kompanitë shqiptare koncepti i ekodiagnostikimit dhe auditimit njihet pak, pavarësisht se ka një shumicë ndërmarrjesh që dëshirojnë të marrin pjesë në diagnostikime dhe seminare mjedisore e energjetike pohuar prej rreth 60 përqind të NVM-ve. Ndërsa 25 përqind kërkojnë të marrin pjesë vetëm në seminare. Siç kemi përmendur edhe më sipër vetëm shumë pak kompani shqiptare janë të certifikuar në ISO, gjë që do të kërkonte rregullisht e periodikisht auditimin e këtyre sistemeve.

- Sipas përkufizimit europian, shumica e ndërmarrjeve në anketim janë shumë të vogla 61 përqind e tyre (me deri në 9 punonjës), dhe të vogla vetëm një e treta e tyre (të punësuar deri në 49 punonjës). Vetëm 4 përqind e NVM-ve mund të konsiderohen të mesme mqs. kanë një numër të punësuarish nga 50 deri në 249 punonjësish.
- Duke u mbështetur në përgjigjet e marra rezulton se 65 përqind e ndërmarrjeve të anketuara kanë një qarkullim vjetor deri në €100,000 EUR, ndërkohë që 29 përqind e ndërmarrjeve e kanë nga €100,000 deri në €5,00,000 EUR. Vetëm 6 përqind e ndërmarrjeve kanë një xhiro vjetore mbi €500,000 EUR.
- NVM-të anketuara i përkasin industrive të agropërpunimit dhe ushqimore në rreth 90 përqind të tyre, ndërsa të tjerat janë të sektorit të ndërtimit, të fermave bujqësore e blegtorale dhe të shërbimeve të ndryshme.

X Rekomandimet për përmirësimin e performancës mjedisore dhe të pajtueshmërisë ligjore të NVM-ve

10.1 Krijimi i kuadrit ligjor të përshtatshëm për ushtrimin e veprimtarisë biznesore të NVM-ve shqiptare në përputhje me detyrimet mjedisore të tyre është një arritje e vlerësueshme për qeverinë dhe institucionet përkatëse. Vazhdimi i transpozimit të legjislacionit europian mjedisor, i ratifikimit të konventave ndërkombëtare për mjedisin dhe përmirësimi i promocionit të informacionit mjedisor dhe i legjislacionit mjedisor nëpërmjet fushatave informuese e edukuese për NVM-të duhet të jetë përparësi e vazhdueshme për Ministrinë e Mjedisit dhe institucionet e saj ekzekutive.

10.2 Hartimi dhe financimi i programeve specifike nga qeveria shqiptare dhe donatorët për mbështetjen teknike e financiare të NVM-ve për të rritur performancën mjedisore dhe pajtueshmërinë ligjore të tyre duhet të jetë një përparësi tjetër e rëndësishme për institucionet e vendit. Këto programe duhet të përfshinë gjithashtu nxitjen dhe mbështetjen e NVM-ve shqiptare për certifikimin në standardet ndërkombëtare për mjedisin si psh.: ISO14000 dhe EMAS.

10.3 Në vend operojnë një numër i konsiderueshëm inspektoratesh, të cilët në analizë të fundit janë barrë administrative shqetsuese për NVM-të. Integrimi dhe/ose bashkërendimi i procedurave të inspektimit të disa inspektorateve me mandat të krahasueshëm do të rriste shkallën e efektivitetit të tyre, lehtësonte barrën administrative e financiare të bizneseve, do të pakësonte shkeljet ligjore si dhe do të pakësonte dukurinë e korrupsionit. Integrimi i procedurave të inspektimeve të Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit, të Inspektoratit Shtetëror të Punës, Inspektoratit Shtetëror të Shëndetit dhe Inspektoratit të Sigurisë Ushqimore do të jepte rezultate të larta në mbrojtjen e shëndetit, mbrojtjen e mjedisit dhe respektimin e standardeve të punësimit, të sigurisë dhe të shëndetit në punë.

10.4 Një numër i konsiderueshëm i NVM-ve nuk i njohin plotësisht ndikimet aktuale dhe potenciale mjedisore të veprimtarive të tyre prodhuese, tregtare, të shërbimit e ndërtimit, ende nuk vlerësohen përfitimet nga sinergjia e çështjeve mjedisore më ato tregtare. Kjo gjendje vjen edhe si pasojë e mosnxitjes dhe mosaplikimit të NVM-ve për pëlqim, autorizim e leje mjedisore në organet përkatëse. Personeli i ARM/IMM duhet të promovojë domosdoshmërinë e pajisjes me leje mjedisore të NVM-ve dhe të kërkojë zbatimin e kushteve dhe kriterëve të lejes mjedisore për të përmirësuar kështu performancën e tyre ndaj mjedisit.

10.5 Një kontribut të rëndësishëm për përmirësimin e performancës mjedisore të NVM-ve duhet të japin ARM-të dhe IMM. Forcimi i vazhdueshëm institucional dhe rritja e kapaciteteve profesionale të personelit të tyre, krijimi i përvojës pozitive tek ky personel nëpërmjet ngritjes dhe ndjekjes së procedurave profesionale para, gjatë dhe pas inspektimit dhe e programeve e protokolleve të inspektimit, programimi vazhdueshëm i veprimtarive dhe i inspektimeve, mbështetja e vazhdueshme teknike për këto zyra me burime njerëzore, materiale e teknike si psh. eksperte ekologë e juriste, mjete zyre dhe mjete elektronike komunikimi, rritja e motivimit financiar për kryerjen efiçente të inspektimeve do të ndikonte direkt për rritjen e performancës mjedisore dhe të pajtueshmërisë ligjore të NVM. Plotësimi i kriteve minimale për inspektimet mjedisore duhet të realizohet sa më shpejt mbi bazën e Direktivës Europiane IPPC.

10.6 Pjesëmarrja e NVM-ve dhe OJF-ve në programet europiane dhe të donatoreve të tjerë është e ulët. Programet qeveritare dhe të donatoreve duhet të hartohen dhe të synojnë ofrimin e asistencës për rritjen e kapaciteteve të NVM-ve dhe të OJF për të marrë pjesë dhe aplikuar në programet europiane si psh: të bashkëpunimit kufitar më vendet fqinje, në programet SEE-TCP, Eco-Innovation, FP7, Intelligent Energy, EMAS, Eco-Label, Life+.

10.7 Qeveria duhet të fillojë hartimin dhe zbatimin e politikave, strategjive dhe programeve për të synuar modelet europiane të avancuara të konsumit dhe prodhimit të blertë. Adoptimi i politikave europiane në fushën e teknologjive mjedisore për mbrojtjen e mjedisit, në zbutjen e ndryshimeve klimatike, në pakësimin e shkarkimeve ndotëse, në menaxhimin modern të mbetjeve si psh: të prokurimit të blertë, të ndërtesave të blerta, të energjisë efiçente, të ndriçimit të blertë, të eko-projektimit duhet të fillojnë të aplikohen në legjislacionin dhe në praktikatat biznesore të NVM-ve shqiptare .

10.8 Në mënyrë periodike dhe sistematike duhen bërë vlerësime të efektivitetit të politikave publike mjedisore. Ngritja e një aparati statistikor për mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe studimin në lidhje me performancën mjedisore, treguesit mjedisore, masat dhe investimet për çështjet mjedisore do të ndihmojë për orientimin e drejtë të politikave mjedisore shtetërore. Ngritja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i një sistemi të besueshëm statistikor të mbledhjes e përpunimit të të dhënave, forcimi i institucioneve për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve, për cilësinë e mjedisit dhe për inspektimet, aplikimi i standardeve europiane për treguesit mjedisore (CSIs) duhet të jetë përparësi për institucionet përgjegjëse.

10.9 Për mbështetjen e teknologjive mjedisore dhe të eko-novacioneve duhet të hartohen programe dhe krijohen fonde të veçanta qeveritare për nxitjen dhe zhvillimin e tyre. Rritja e bashkëpunimit midis institucioneve kërkimore e studimore dhe NVM-ve është domosdoshmëri për transferimin e teknologjive mjedisore, shfrytëzimin e energjive të rinovueshme dhe rritjen e efiçencës së energjisë.

10.10 Rregullorja e re të EMAS 2009 kërkon dhe detyron qeveritë e vendeve anëtare të EU duke filluar nga 2010 për grumbullimin e informacionit dhe të të dhënave për performancën dhe treguesit mjedisore të ndërmarrjeve si psh: normativat në konsumin e lëndëve të para e ndihmese, materialeve, energjisë, prodhimin e trajtimin e mbetjeve për të vlerësuar kostot, konkurueshmërinë e produktivitetin e NVM-ve europiane. Nuk duhet të konsiderohet e parakohshme programimi dhe planifikimi për fillimin e grumbullimit të një informacioni të tillë edhe nga ndërmarrjet shqiptare.

10.11 Përmirësimi i legjislacionit aktual për efiçencën e energjisë është i domosdoshëm. Programet shtetërore për mbështetjen e NVM-ve për rritjen e efiçencës së energjisë dhe

adoptimi i masave, mjeteve, materialeve, lëndëve djegëse e karburanteve, të cilat janë efikente dhe pakësojnë ndotjen në mjedis duhet të jenë prioritet afatgjatë për institucionet shqiptare, duke përfshirë këtu edhe promovimin për prodhimin dhe përdorimin e energjive të rinovueshme si atë të diellit, të erës, të ujit dhe të biomasës.

10.12 Përmirësimi i kuadrit ligjor për çështjen e monitorimit të treguesve mjedisore në ndërmarrje është i domosdoshëm. Përcaktimi specifik i çdo treguesi për monitorim në çdo NVM duhet të jetë përgjegjësi e institucioneve të specializuara, të cilat njohin teknologjitë respektive të NVM-ve. Megjithatë në ligj theksohet se është përgjegjësi ligjore e ndërmarrjes për kryerjen e monitorimit të treguesve mjedisore të përcaktuar në lejen mjedisore, përsëri është e nevojshme ende asistencë institucionale për NVM-të për të kryer efektisht këto vetmonitorime periodike.

10.13 Mbështetja politike për krijimin e gjykatës administrative nuk duhet të vonohet. Zgjidhja e çështjeve ligjore mjedisore me NVM-të dhe zvarritjet për pagesat e gjobave mjedisore nga NVM-të që shkelin ligjet kërkojnë shumë kohë në sistemin e sotëm gjyqësor duke krijuar një barre të tepërt si për bizneset ashtu edhe për administratën publike.

10.14 Një pjesë e madhe e kompetencave edhe e autoritetit për mbrojtjen e mjedisit i kanë kaluar qeverisjes vendore dmth: bashkive, komunave dhe qarqeve. Është çështje e rëndësishme së pari: balancimi i kompetencave me mbështetjen financiare sepse perceptimi vendor është që kompetencat janë të mëdha ndërkohë që mbështetja financiare për realizimin e tyre është e pamjaftueshme dhe së dyti, kontrolli i shpenzimeve publike për çështjet mjedisore është joefektiv në nivel qendror dhe vendor. Buxheti vjetor për mbrojtjen e mjedisit është ende i ulët, po kështu granti qeveritar për bashkitë e komunat nuk është i mjaftueshëm dhe shpenzimet për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve janë joefikente ose shpërdorohen.

10.15 Suksesi i reformave në fushën e mbrojtjes së mjedisit varet shumë nga shkalla e bashkëpunimit midis institucioneve qendrore dhe aktoreve rajonale e vendore si psh: agjencive rajonale të mjedisit dhe drejtorive mjedisore të bashkive, komunave, qarqeve, përfaqësuesve të biznesit në qark si dhomave të tregtisë e industrisë dhe shoqatave të biznesit dhe OJF mjedisore. Përmirësimi i komunikimit dhe koordinimit midis këtyre institucioneve, rritja e pjesëmarrjes së tyre dhe e publikut në vendimmarrje për çështjet e mjedisit do të ndikojë shumë pozitivisht në zbatimin e legjislacionit mjedisor dhe përmirësimin e performance mjedisore të NVM-ve.

10.16 Në rivlerësimin dhe rishikimin e afërt të Strategjive Sektorale për Mjedisin 2007-2013 dhe të Strategjisë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2007-2013, të miratuara nga Qeveria Shqiptare, duhet të ketë politika të qarta për mbështetjen e përmirësimin të performancës mjedisore dhe pajtueshmërisë ligjore të NVM-ve dhe nxitjes për integrimin e këtyre çështjeve në strategjitë e zhvillimit të NVM-ve. Rritja e bashkëpunimit midis dy institucioneve respektive Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Ekonomisë për hartimin dhe zbatimin e programeve të përbashkëta në këtë fushë është e domosdoshme.

10.17 Hartimi i programeve dhe mbështetja financiare për kualifikimin e vazhdueshëm brenda dhe jashtë vendit, sigurimi i pjesëmarrjes në veprimtari për çështjet mjedisore dhe për zbatimin e legjislacionit mjedisor është i domosdoshëm për rritjen e performancës së stafeve të ARM/IMM dhe të atyre të institucioneve të tjera përgjegjëse. Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira në fushën e proceduarve dhe protokolleve për inspektimet mjedisore në rrjetin IMPEL, INECE, REPIN, ECENA dhe konsultimi i

vazhdueshëm për rritjen e efektivitetit të inspektoratit duhet të konsiderohet i rëndësishëm dhe i domosdoshëm.

10.18 Industritë e agropërpunimit në rastin tonë të përpunimit të qumështit, të mishit të frutave e perimeve janë konsumatore të mëdhenj të ujit dhe për pasojë prodhojnë sasi të konsiderueshme të ujit të ndotur. Marrja e masave për filtrimin e ujit në hyrje të impianteve të përpunimit dhe trajtimi paraprak i ujit të ndotur nëpërmjet trajtimeve mekanike, biologjike kimike duhet të merret seriozisht në konsideratë nga ky sektor industrial gjë që mund të përballohet financiarisht nga këto biznese. Zgjidhje të tjera për trajtimin e ujit të ndotur përfshinë impiantet e depurifikimit të ujit, trajtimin dytësor dhe tretësor të ujit të ndotur në mënyrë individuale ose kolektive për NVM-të.

10.19 Në lidhje me shkarkimet atmosferike gjendja rezulton jo e mirë sepse shumica e NVM-ve të sektorit të agrobiznesit përdorin për nevojat e prodhimit lëndë djegëse mazut, solar, më pak naftë dhe shumë më pak gaz të lëngshëm. Në Shqipëri kemi ndeshur me shembuj pozitive të pakësimit të ndotjes atmosferike si nëpërmjet vendosjes së filtrave të gazit në kaldajat e prodhimit të avullit ose modifikimit të tyre për të punuar më gaz të lëngshëm, i cili është shumë herë më pak ndotës se karburantet dhe ka aktualisht çmim të krahasueshëm më solarin.

10.20 Në lidhje me trajtimin e mbetjeve mund të pohohet që shumica e NVM-ve nuk bëjnë asnjë lloj trajtimi të tyre që mund të jetë pakësimi, ripërdorimi dhe riciklimi (3R), dhe trajtimi i fundit duhet të jetë depozitimi në vendgroposjen e përcaktuar publike. Mbetjet organike të industrisë së agropërpunimit mund të përdoren për ushqim për kafshët e shpendët ose pleh organik si psh. hirra, kockat, bërsitë, mbetjet e pastrimit dhe seleksionimit të fruta e perimeve. Mbetjet e paketimit (letër, karton, plastmas, metalik, qelq) përsëri mund të shiten në ndërmarrjet e riciklimit të tyre.

10.21 NVM-të shqiptare kanë një intensitet të lartë të energjisë për njësi prodhimi, dhe kostot e energjisë zënë deri në 20 përqind të kostos së prodhimit. Paraprakisht, ato mund të marrin masa fillestare, të cilat shpesh herë janë pa kosto, ndërkohë që marrja e masave për optimizmin e përdorimit të makinerive, pajisjeve, dhomave frigoriferike, automjeteve të transportit mund të pakësojë konsumin e energjisë elektrike dhe të lëndëve djegëse e karburanteve. Në masat e tjera mund të përmenden zëvendësimi i motorëve të vjetër më ato të rinj të blerë në vendet europiane, të cilët konsumojnë deri 25 përqind më pak energji, remonti periodik i makinerive, pajisjeve, motorëve e ventilatorëve, kompresorëve, kaldajave, pompave, zëvendësimi i ndriçimit me llampa fluoeshente, përdorimi i stabilizatorëve të energjisë, përdorimi i gazit të lëngshëm në vend të solarit ose naftës në kaldaja, përdorimi i pajisjeve të zyrës të cilët janë të klasifikuar më logon Energy Star, blerja e pajisjeve industriale të koduara sipas shkallës së efikasitetit të energjisë, marrja e masave për termo dhe hidroizolimimin e ndërtesave, pajisjeve, makinerive, tubacioneve, dyerve, dritareve, mureve.

10.22 Një numër i konsiderueshëm ndërmarrjesh të vogla e të mesme operojnë të grupuara në zonat industriale në periferi të qyteteve kryesore dhe përdorin rrjete të përbashkëta të furnizimit më ujë, energji, të shkarkimeve të ujrave të ndotura dhe të trajtimit të mbetjeve të ngurta. Promovimi i bashkëpunimit të këtyre ndërmarrjeve dhe ofrimi i asistencës teknike e financiare për ngritjen e impianteve të përbashkëta për trajtimin e mbetjeve, ujrave të përdorur dhe shkarkimeve të tjera do të ulte kostot e trajtimit dhe do të përmirësonte dukshëm performancën mjedisore të këtij grupi ndërmarrjesh.

XI Aneksat

11.1 Shkurtime

ARM	Agjencia Rajonale e Mjedisit
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AMP	Agjencia e Mjedisit dhe e Pyjeve
ADA	Agjencia Austriake e Zhvillimit
BSH	Banka e Shqipërisë
BOD ₅	Kërkesa Biokimike Pesëditore për Oksigjen
CDM	Mekanizmi i Zhvillimit të Pastër
COD	Kërkesa Kimike për Oksigjen
CEN	Komiteti European i Standardizimit
CIP	Programi për Konkureshmërinë dhe Novacionet
CSI	Treguesit kryesore mjedisore të EEA
CFC	Gazet Klorflorkarbonet
EC	Komisioni European
EU	Bashkimi European
ETAP	Plani i Veprimit për Teknologjitë Mjedisore
ECAP	Programi i Asistencës për Pajtueshmërinë Mjedisore
ESCO	Kompanitë për Shërbimet e Energjisë
ECT	Traktati për Kartën e Energjisë
ECENA	Rrjeti për Pajtueshmërinë dhe Zbatimin e Legjislacionit Mjedisor
FDI	Investimet e Huaja Direkte
GHGs	Gazet me efekt sere
HCFC	Gazet Hidroklorflorkarbonet
IMM	Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit
IMPEL	Rrjeti European për Zbatimin e Ligjeve të Mjedisit
IMM	Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit
ICT	Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit
INECE	Rrejtja Ndërkombëtare për Pajtueshmërinë dhe Zbatimin e Ligjeve të Mjedisit
KfW	Banka Gjermane për Rindërtim
LDCs	Vendet më pak të zhvilluara
MEAs	Marrëveshjet Shumëpalëshe për Mjedisin
MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave
NVM	Ndërmarrje të Vogla e të Mesme
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
OJF	Organizata Jofitimprurëse
PM ₁₀	Grimca me madhësi deri në 10 mikron
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
POPs	Lëndë Organike të Qëndrueshme
PKZMSA	Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Asocim Stabilizimit
pH	Masa për matjen e aciditetit/alkalinitetit të një tretësire
REPIN	Rrejtja për Zbatimin e Programit Rregullator Mjedisor
SBA	Akti për Biznesin e Vogël
SAA	Marrëveshja për Stabilizim e Asocim
UNEP	Programi i OKB-së për Mjedisin
UNDP	Programi për Zhvillim i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
UNECE	Komisioni Ekonomik për Europën e OKB
TEC	Traktati për Komunitetin e Energjisë
toe	ton ekuivalent naftë
VOCs	Lëndë Organike të Avullueshme
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
WHO	Organizata Botërore e Shëndetsisë

11.2 Bibliografia

- 1) UNDP 2007, Environment Policy in South-Eastern Europe
- 2) UNECE 2002, Environmental Performance Review for Albania
- 3) QSH 2007, Strategjia Sektorale për Mjedisin 2007-2013
- 4) EU 2009, Albania Stabilization and Association Report 2009
- 5) EC Environmental Legislation. Web site: <http://europa.eu.int/eur-lex/index.html>
- 6) REC 2005, Progress in Environmental Law Drafting in SEE, www.rec.org/
- 7) Institute of Statistics, www.instat.gov.al
- 8) Website: Albanian MoEFWA www.moe.gov.al
- 9) EEA 2010, Environmental trends and perspectives in Western Balkans
- 10) Këshilli i Ministrave: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007
- 11) METE, Strategjia Sektorale e Energjisë 2007-2020, Draft
- 12) EU, Albania 2009 Progress Report
- 13) EEA, Environmental Management Tools for SMEs, 1998
- 14) INECE, Principles of Environmental Compliance and Enforcement 2009
- 15) PEEREA, Albania Regular Review of Energy Efficiency Policies, 2007
- 16) METE, Strategjia e Zhvillimit të Bizneseve dhe të Investimeve 2007-2013
- 17) KM, Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA 2007-2013
- 18) KM, Strategjia Ndërsektorale e Mjedisit 2007
- 19) AMP, Raport për gjendjen e mjedisit, 2008
- 20) WTO, Trade Policy Review, Albania 2010-09-25
- 21) OECD, Business and environment 2007
- 22) EEA, Environmental trends and perspectives in the Western Balkans, 2010
- 23) UNEP, Profiting from Cleaner Production, 2002
- 24) Lund University, Strategies for Cleaner Technology, 2003
- 25) UNDP, Environmental Policies in SEE, 2007

Adresat e faqeve të internetit:

<http://www.energy-community.org/>

<http://www.encharter.org/>

www.ec.europa.eu/ecoinnovation

www.ec.europa.eu/energy

www.eu-greenbuilding.org

www.eu.greenlight.org

<http://re.jrc.ec.europa.eu/energyefficiency/motorchallenge/>

www.eu-energystar.org

www.ec.europa.eu/environment/ecolabel/

www.ec.europa.eu/environment/emas/

www.southeast-europe.net

www.adriaticpacbc.org

Adresa:

Fondacioni i Biznesit të Vogël

Rruga Mehmet Brocaj 10/1, Tirana, Albania PoB 1401

Tel: 355 4 2230983, Mob: 355 (0) 692315268

Email: fbv@albmail.com, Web: www.sbfalbania.org



Fondacioni i Biznesit të Vogël
Rruga "Mehmet Brocaj" Nr. 10/1, KP 1401
Tirana, Albania
www.sbfalbania.org
e-mail: fbv@albmail.com